Ambasciata d'Italia
Tirana

AGENZIA ITALIANA
PER LA COOPERAZIONE
ALLO SVILUPPO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

UN WOMEN

Fuqizimi i Grave për Zhvillimin Rural në Shqipërinë Veriore

Analizë me Ndjeshmëri Gjinore e Zinxhirëve të Vlerës në Bashkinë Malësi e Madhe

UN Women është krijuar për të avancuar të drejtat e grave, barazinë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave. Si enti drejtues i Kombeve të Bashkuara për barazinë gjinore dhe sekretariat i Komisionit për Statusin e Grave, ne punojmë për të ndryshuar ligjet, institucionet, sjelljet shoqërore dhe shërbimet, me qëllim mbylljen e hendekut gjinor dhe ndërtimin e një bote të barabartë për të gjitha gratë dhe vajzat.Partneritetet tona me qeveritë, lëvizjet e grave dhe sektorin privat, së bashku me rolin tonë koordinues në kuadër të sistemit të Kombeve të Bashkuara, i kthejnë përparimet në ndryshime të qëndrueshme. Puna jonë për avancimin e të drejtave të grave dhe vajzave përqendrohet në katër fusha kyçe: lidershipi, fuqizimi ekonomik, mbrojtja nga dhuna, roli i grave në paqe dhe siguri, si dhe veprimi humanitar.

UN Women i vendos të drejtat e grave dhe vajzave në qendër të përparimit global—gjithmonë dhe kudo. Sepse barazia gjinore nuk është vetëm ajo që bëjmë. Barazia gjinore është ajo që jemi.

UN Women Zyra e Shqipërisë,
Rr. "Skenderbej", Ndërtesa 8, Ap. 29-31, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 450 2555/7575
E-mail: unwomen.albania@unwomen.org
Website: https://albania.unwomen.org

Kjo analizë me ndjeshmëri gjinore e zinxhirëve të vlerës u realizua në kuadër të projektit "Fuqizimi i grave për zhvillim rural në Shqipërinë e Veriut", i zbatuar nga UN Women dhe i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar e Italisë. Ky projekt zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UN Women, Kombeve të Bashkuara ose cilësdo prej organizatave të lidhura me to.

Për të shkarkuar këtë botim, ju lutemi shkoni në faqen: https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications

Autorë: Erald Lamja, Diamanta Vito, ekspertë të UN Women

Me kontribut teknik të: Rachele Megna, Besmira Kukaj, nga UN Women

Bashkia Malësi e Madhe

Përpunimi grafik: HL Branding

Ky botim është i disponueshëm me akses të lirë në përputhje me licencën Creative Commons të krijuar për organizatat ndërqeveritare, e disponueshme në: https://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/3.0/igo/.

Botuesit duhet të heqin logot e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, UN Women nga botimi i tyre dhe të krijojnë një kopertinë të re. Botuesit duhet të dërgojnë versionin e tyre në format elektronik në adresën: permissions@unwomen.org. Fotokopjimi dhe riprodhimi i pjesëve të veçanta lejohet, për sa kohë që jepet njohja e duhur.

Fuqizimi i Grave për Zhvillimin Rural në Shqipërinë Veriore

Analizë me Ndjeshmëri Gjinore e Zinxhirëve të Vlerës në Bashkinë Malësi e Madhe

Qershor 2025

Tabela e Përmbajtjes

Lista e shkurtesave 9

Përligjja e studimit 11

Përmbledhje e konstatimeve kryesore kontekstuale 12

PJESA 1: METODOLOGJIA 16

PJESA 2: ANALIZË E ZINXHIRIT TË VLERËS SË BMA-VE 24

1. Analizë me ndjeshmëri gjinore e zinxhirit të vlerës së BMA-ve 25

2. Diagram i zinxhirit të vlerës të bimëve mjekësore dhe aromatike 29

2.1 Aktorët në zinxhirin e vlerës 30

2.2 Shërbimet e mbështetjes dhe kontrollit 34

2.3 Konstatimet e studimit 38

2.4 Ndërhyrje të rekomanduara për zinxhirin e vlerës të BMA-ve 40

PJESA 3: ANALIZË E ZINXHIRIT TË VLERËS SË BLEGTORISË/PRODUKTEVE TË QUMËSHTIT 44

1. Analizë me ndjeshmëri gjinore e zinxhirit të vlerës së blegtorisë/produkteve të qumështit 45

1.1 Situata në zinxhirin e vlerës të produkteve të qumështit/bulmetit në Malësi të Madhe 46

2. Diagrami i zinxhirit të vlerës të qumështit në Malësi të Madhe 49

2.1 Aktorët në zinxhirin e vlerës 50

2.2 Kuadri ligjor 53

2.3 Shërbimet e mbështetjes dhe kontrollit 54

2.4 Konstatimet e studimit 62

2.5 Rekomandime për forcimin e zinxhirit të vlerës të qumështit 65

PJESA 4: SHTOJCAT 70

Shtojca 1. Bashkia Malësi e Madhe: Informacion i përgjithshëm 71

Demografia dhe popullsia 71

Konteksti social-ekonomik 74

Shërbimet sociale dhe ndihma ekonomike 74

Edukimi 76

Shëndetësia 79

Aktiviteti ekonomik 79

Tregu i punës, punësimi dhe papunësia në Malësi të Madhe 81

Infrastruktura: toka, ujërat, energjia elektrike dhe jeta sociale 81

Sistemet e integruara në Malësi të Madhe 82

Shërbimet komunale: furnizimi me ujë dhe energji elektrike 82

Infrastruktura publike dhe jeta sociale 83

Turizmi, trashëgimia kulturore dhe historike 83

Bujqësia dhe blegtoria 85

Shtojca 2: Konteksti kombëtar i barazisë gjinore 91

Shtojca 3. Bujqësia dhe zhvillimi rural: çështje gjinore kyçe në Shqipëri 94

Lista e Tabelave

Tabela 1. Klasifikimi dhe përzgjedhja e zinxhirëve të vlerës me përdorim të kritereve me ndjeshmëri gjinore 20

Tabela 2. Vlerësimi i fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore në ZV-në e BMA-ve 21

Tabela 3. Vlerësimi i fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore në ZV-në e prodhimeve të qumështit/bulmetit 22

Tabela 4. Analiza SWOT e zinxhirit të vlerës të BMA-ve 28

Tabela 5. Rekomandime për ZV-në e bimëve mjekësore dhe aromatike 41

Tabela 6. Analiza SWOT e zinxhirit të vlerës të qumështit 48

Tabela 7. Rekomandime për zinxhirin e vlerës të qumështit 67

Tabela 8. Popullsia sipas grupmoshës dhe gjinisë 72

Tabela 9. Gjendja civile, 2023 72

Tabela 10. Popullsia sipas gjendjes civile, 2023 73

Tabela 11. Numri dhe shpërndarja e anëtarëve të familjes, 2023 73

Tabela 12. Popullsia sipas NJA-ve, gjinisë dhe statusit të aftësisë së kufizuar, 2023 75

Tabela 13. Familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike 75

Tabela 14. Personat me aftësi të kufizuara sipas gjinisë 76

Tabela 15. Arritjet arsimore sipas gjinisë, 2023 77

Tabela 16. Numri i çerdheve dhe kopshteve 77

Tabela 17. Numri i shkollave 78

Tabela 18. Shkollat e mesme në njësitë administrative të Malësisë së Madhe 78

Tabela 19. Shërbimet shëndetësore 79

Tabela 20. Ndërmarrjet aktive sipas gjinisë 2023 79

Tabela 21. Ndërmarrjet aktive sipas aktivitetit ekonomik 80

Tabela 22. Ndërmarrjet aktive sipas numrit të të punësuarve 80

Tabela 23. Treguesit e tregut të punës, Qarku e Shkodrës, 2023 81

Tabela 24. Shpërndarja e sistemeve në Malësi të Madhe 81

Tabela 25. Njësitë e banesave dhe sistemet e furnizimit me ujë, 2023 82

Tabela 26. Monumente të natyrës në Malësi të Madhe 84

Tabela 27. Llojet e turizmit 85

Tabela 28. Shifrat e bagëtive 86

Tabela 29. Produktet blegtoral 87

Tabela 30. Bimët e arave 88

Tabela 31. Kultivimi i perimeve në Malësi të Madhe (2023) 88

Tabela 32. Prodhimi dhe rendimenti i perimeve të freskëta në Malësinë e Madhe (2023) 89

Tabela 33. Pemët frutore dhe prodhimi i tyre në Malësi të Madhe (2023) 89

Lista e Figurave

Figure 1. Qasja metodologjike 19

Figure 2. Diagram i zinxhirit të vlerës të BMA-ve 29

Figure 3. Diagram i zinxhirit të vlerës të qumështit 49

Figure 4. Gratë, burrat dhe bujqësia në Shqipëri 101

Lista e Shkurtesave

AICS	Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim
AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AKVMB	Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
AREB	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor
NJA	Njësi Administrative
FAO	Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e OKB-së
PMB	Praktikat e mira bujqësore
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
OMGJ	Organizma të modifikuar gjenetikisht
ANGJZV	Analizë me Ndjeshmëri Gjinore e Zinxhirit të Vlerës
HACCP	Analiza të Rrezikut dhe Pikave të Kontrollit Kritik
UNKN	Unioni Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës
INSTAT	Instituti i Statistikave i Shqipërisë
BMA	Bimë Mjekësore dhe Aromatike
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
DHKZ	Dhoma Kombëtare e Zejtarisë
QTTB	Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore
UN Women	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar
ZV	Zinxhir i Vlerës
FEG	Fuqizimi Ekonomik i Grave

Përligjja e Studimit

Dhuna me bazë gjinore mund të krijojë barriera që pengojnë mundësitë ekonomike dhe zhvillimin. Nga ana tjetër, fuqizimi ekonomik i grave (FEG) mund të shtojë besimin dhe pavarësinë dhe të zvogëlojë gjasat që ato të jetojnë në situata të dhunshme; po kështu, rritja e fuqizimit ekonomik të grave u kundërvihet edhe stereotipave gjinorë dhe normave shoqërore të rrënjosura thellë, të cilat mund të manifestohen me rritje të dhunës me bazë gjinore. **Ky dualitet nxjerr në pah ndërveprimin kompleks midis fuqizimit të grave dhe rezistencës ndaj ndryshimit, që thekson nevojën për një qasje gjithëpërfshirëse dhe të përshtatur me kontekstin ndaj barazisë gjinore.** Rrjedhimisht, fuqizimi ekonomik i grave shihet njëkohësisht edhe si mjet për t'i dhënë fund dhunës, në rastin e grave që i kanë mbijetuar dhunës, edhe si mënyrë për forcimin e pavarësisë ekonomike të grave dhe pjesëmarrjen e tyre në forcat e punës. Këto dinamika janë veçanërisht të dukshme në bashkitë e Bulqizës, Malësisë së Madhe, Shkodrës, dhe Dibrës, të cilat janë bashkitë e synuara në projektin "Fuqizimi i grave për zhvillim rural në Shqipërinë e Veriut,"[1] i zbatuar nga UN Women Shqipëri, me mbështetjen e Ministrisë Italiane të Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, përmes Agjencisë Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor (AICS Tiranë). Në këto zona mbizotërojnë stereotipet gjinore dhe ato karakterizohen nga mungesa sistematike të shërbimeve sociale, si transporti publik dhe kopshtet e fëmijëve; aksesi i kufizuar ose i paqartë i grave në të drejtat pronësore; si dhe një shkallë e lartë e punës së papaguar dhe informale të kryer nga gratë, që mund të kufizojë masën në të cilën ato mund të marrin pjesë në veprimtari ekonomike.[2] Për t'i trajtuar këto probleme, UN Women promovon qeverisjen e përgjigjshme gjinore, ku përfshihen elementë të forcimit të reagueshmërisë gjinore të kornizës së politikave bujqësore dhe të zhvillimit vendor në nivel kombëtar dhe lokal duke rritur ndërgjegjësimin për të drejtat e grave dhe duke adresuar stereotipet gjinore, ndër të tjera edhe në lidhje me të drejtat pronësore dhe dhënien fund të dhunës ndaj grave. Kjo qasje me ndjeshmëri gjinore ndaj zinxhirëve të vlerës është një strategji proaktive që jo vetëm promovon barazinë gjinore, por edhe forcon efikasitetin, qëndrueshmërinë, dhe karakterin përfshirës të ekonomive rurale. E bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, parimet e drejtësisë sociale dhe avantazhet ekonomike të përfshirjes gjinore për bizneset – si ato që janë shtjelluar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP)[3] – kjo qasje i njeh gratë si kontribuese aktive në produktivitetin ekonomik dhe në forcimin e aftësisë së komunitetit për të përballuar situata të vështira. Nisma synon të transformojë dinamikën ekzistuese të pushtetit dhe të zgjerojë rolet e grave si veprimtare ekonomike. **Garantimi i reagueshmërisë gjinore të ligjeve, politikave dhe shërbimeve do të krijojë një mjedis mundësues i cili mbështet jo vetëm të drejtat e grave, por edhe aftësinë konkurruese dhe qëndrueshmërinë ekonomike të tyre.** Nga ana e tij, promovimi i fuqizimit ekonomik të grave forcon autonominë e tyre dhe bën të mundur që ato të dalin nga cikli i dhunës, të kërkojnë dhe ushtrojnë të drejtat e tyre dhe të kontribuojnë në mënyrë më të plotë në familje dhe komunitet.

Përmes njohjes së rolit kyç të barazisë gjinore në arritjen e një zhvillimi rural përfshirës dhe të qëndrueshëm, ky projekt ndërmerr të kryejë **analiza me ndjeshmëri gjinore të zinxhirëve të vlerës, të përshtatura me veçoritë e zonave në secilën bashki partnere**. Këto analiza synojnë të evidentojnë sektorët kyç të ekonomisë dhe zinxhirët e vlerës që kanë potencial zhvillimor, të hartëzojnë rolet e diferencuara të grave dhe burrave në këta zinxhirë vlere, dhe të identifikojnë pengesat që kufizojnë pjesëmarrjen dhe rolin drejtues të grave. Mbi bazën e këtyre të dhënave po përgatiten ndërhyrje të posaçme për rritjen e aksesit të grave në mundësi ekonomike, si dhe për të promovuar një zhvillim të drejtë gjinor të zinxhirëve të vlerës. Studimi bën një analizë të Bashkisë së Malësisë së Madhe nga këndvështrimi gjinor dhe sugjeron qasje me ndjeshmëri gjinore për forcimin e barazisë gjinore në zinxhirët e vlerës ekonomike dhe përmes tyre, mbi bazën e ekspertizës së UN Women në këtë fushë.[4] Ai synon të identifikojë strategji konkrete dhe të realizueshme për forcimin e barazisë gjinore **në zinxhirët e vlerës dhe përmes tyre**, duke u mbështetur në ekspertizën globale të UN Women dhe partneritetet vendore. **Përmes promovimit të zinxhirëve të vlerës me përfshirje të gjerë, projekti synon të çlirojë potencialin e plotë ekonomik të grave dhe të forcojë rolet e tyre si faktorë të ndryshimit në zhvillim të qëndrueshëm rural.**

1. Projekt i financuar nga AICS – Agjencia Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor dhe i zbatuar nga UN Women Shqipëri (2024-2027).
2. *Empowering Women in the Rural Economy* (Fuqizimi i grave në ekonominë rurale). Shih: https://www.ilo.org/sites/default/files/wcmsp5/groups/public/%40ed_dialogue/%40sector/documents/publication/wcms_601071.pdf
3. *Guide to Gender-Sensitive Approaches to Value Chain Development* (Udhëzues për qasje me ndjeshmëri gjinore në zhvillimin e zinxhirit të vlerave). Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP). (2022). Shih: https://www.ilo.org/publications/guide-gender-sensitive-approaches-value-chain-development
4. https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2022/12/gender-sensitive-value-chain-analysis

Përmbledhje e Konstatimeve Kryesore Kontekstuale

Malësia e Madhe shtrihet në pjesën veriperëndimore të Shqipërisë dhe kufizohet në veri, veriperëndim dhe verilindje me Malin e Zi, në jugperëndim me Liqenin e Shkodrës, dhe në jug dhe juglindje me Bashkinë Shkodër. Territori i Bashkisë së Malësisë së Madhe ka një sipërfaqe prej 951 km^2 dhe ndahet në gjashtë njësi administrative: Kelmendi, Kastrati, Shkreli, Kopliku, Njësia Qendër, dhe Gruemira, me dy qyteza, Kopliku dhe Bajza, dhe 56 fshatra. Bashkia ka një popullsi prej 21.684 banorësh (10.879 meshkuj dhe 10,805 femra),5 me dendësinë më të madhe të popullsisë të përqendruar në zonat e ulëta të territorit të bashkisë.

Malësia e Madhe karakterizohet nga një strukturë ekonomike e shumëllojshme, ku rol të rëndësishëm luajnë bujqësia, sipërmarrjet e vogla dhe shërbimet. Ekonomia e zonës është kryesisht bujqësore, me një pjesë të mirë të popullsisë që merret me bujqësi. Ky sektor mbetet burim i rëndësishëm i të ardhurave dhe jetesës për komunitetin, dhe pasqyron mbështetjen e zonës në prodhimin bujqësor dhe blegtoral. Krahas bujqësisë, në zonë ka edhe një prani të konsiderueshme ndërmarrjesh të vogla e të mesme, me një numër në rritje të sipërmarrësve që kontribuojnë në aktivitetin ekonomik të zonës. Po kështu, vitet e fundit, në bashki vihet re rritje e numrit të bizneseve aktive, kryesisht ofrues të shërbimeve, sidomos në sektorët e tregtisë, ndërtimit dhe mikpritjes. Tregu i punës në Malësi të Madhe përballet me sfida të lidhura me shkallën e punësimit, ku përgjithësisht burrat kanë mundësi më të mëdha punësimi se gratë. Të dhënat e ndërmarrjeve tregojnë se ndonëse burrat vazhdojnë dominojnë në sektorin e sipërmarrjes, edhe numri i ndërmarrjeve aktive të grave ka shënuar një rritje modeste, që tregon për një tendencë pozitive në pjesëmarrjen e grave në biznes. Megjithatë, hendeku gjinor mbetet i dukshëm - numri i bizneseve me pronarë burra është shumë më i madh se sa i atyre të grave (394 burra kundrejt 132 gra pronare biznesesh).

Të dhënat e forcave të punës për rajonin e Shkodrës, ku përfshihet edhe Malësia e Madhe, për vitin 2023 tregojnë se shkalla totale e pjesëmarrjes në forcat e punës është 63,8%, me një dallim të ndjeshëm ndërmjet burrave (72%) dhe grave (56%).

Pjesëmarrja në forcën e punës është 63.8%, ku pjesëmarrja e grave është 56% dhe e burrave 72%.

Shkalla e përgjithshme e punësimit është 59,4%, me një përqindje më të lartë tek burrat (67,5%) krahasuar me gratë (51,7%). Shkalla e inaktivitetit – që tregon individët që nuk marrin pjesë në forcat e punës – është 36,2% në total, ku gratë kanë shkallë inaktiviteti më të lartë (44,0%) krahasuar me burrat (28,0%). Niveli i përgjithshëm i papunësisë është relativisht i ulët, 6,9%, me një përqindje pak më të ulët ndër burrat (6,2%) krahasuar me gratë (7,8%). Këto të dhëna ilustrojnë hendekun gjinor në punësim, ku burrat kanë shkallë më të lartë pjesëmarrjeje dhe punësimi, kurse tek gratë ka më shumë inaktivitet dhe papunësi më të lartë. Megjithatë, për Malësinë e Madhe nuk ka, ose ishte e vështirë të gjendeshin, të dhëna zyrtare për tregun e punës të ndara sipas gjinisë, që bëri të nevojshme mbështetjen në treguesit e nivelit rajonal. Sa i përket turizmit, Malësia e Madhe njihet për peizazhet e mahnitshme natyrore, trashëgiminë e pasur kulturore dhe mundësitë e shumëllojshme të turizmit. Me pozicionin e saj unik gjeografik, të karakterizuar nga terreni malor, liqene me ujë të kulluar, dhe lumenj piktoreskë, zona ofron një gamë të gjerë përvojash turistike gjatë gjithë vitit. Që nga sportet ujore në Liqenin

5. Censusi i INSTAT-it.

e Shkodrës dhe lumin e Cemit, në ngjitjet e maleve të Alpeve të Shqipërisë dhe eksplorimin e monumenteve dhe vendeve me interes kulturor, Malësia e Madhe është një destinacion ideal për të apasionuarit pas ecjeve në natyrë, entuziastët e aventurave, dhe ata që kërkojnë të njohin më mirë traditat e pasura shqiptare. Në këtë drejtim dallohen njësitë administrative të Kelmendit dhe Shkrelit, si zona malore, që kanë edhe faqe interneti të dedikuar, www.kelmend-shkrel.org, ku jepet një listë e të gjitha vendeve dhe burimeve turistike të këtyre zonave. Bujqësia dhe blegtoria janë pjesë përbërëse të ekonomisë së Malësisë së Madhe, dhe ofrojnë mundësi të shumëllojshme për komunitetet vendore, sidomos në zonat rurale. Të dhënat zyrtare[6] tregojnë për diversitetin dhe shtrirjen e veprimtarisë bujqësore në zonë, me theks të veçantë mbi rolin e blegtorisë si një element i rëndësishëm i ekonomisë së zonës.

Ndër bagëtitë dominojnë ripërtypësit e vegjël, si dhentë (14.927) dhe dhitë (8.900), që dëshmon fokusin tradicional të zonës në këto bagëti, ndoshta për shkak të terrenit malor që plotëson nevojat e tyre të kullotjes. Numri i konsiderueshëm i dhive të rritura për qumësht (5.188) vë në pah më tej rëndësinë e prodhimit të qumështit në ekonominë e zonës. Numri i gjedhëve është gjithashtu i konsiderueshëm, me 3.552 krerë, nga të cilat 3.015 janë lopë, që tregon për fokusin e zonës në prodhimet e bulmetit dhe të mishit. Rritja e derrave, ndonëse në shkallë më të vogël, kontribuon në diversitetin blegtoral, me 3.175 derra dhe 238 dosa pjellëse. Në vitin 2023, sasia totale e qumështit të prodhuar në Malësi të Madhe ishte 8.177 ton, ku pjesa më e madhe ishte qumësht lope, me 5.724 ton. U prodhuan gjithashtu sasi të konsiderueshme qumështi delesh dhe dhish, me përkatësisht 1.209 dhe 1.244 ton. Kjo balancë sugjeron ekzistencën e një sektori të fuqishëm blegtoral dhe të nënprodukteve të qumështit, që plotëson kërkesa të shumëllojshme të tregut, sidomos për prodhime bulmetore tradicionale artizanale. Bimët foragjere, të kultivuara në pak më shumë se 3.000 hektarë, dëshmojnë rëndësinë që kanë bagëtitë për familjet rurale. Me mbi 5.200 hektarë të kultivuara, bimët mjekësore dhe aromatike janë aktiviteti bujqësor dhe industrial më kryesor në zonë. Malësia e Madhe mbetet kryesuese e padiskutueshme në prodhimin e BMA-ve, ku kultivohen më se dy të tretat e BMA-ve në Shqipëri. Klima e favorshme e zonës, tradita në kultivimin e BMA-ve, dhe rrjeti i fuqishëm i fermerëve dhe përpunuesve ka përforcuar rolin e saj si zona më e rëndësishme prodhuese e BMA-ve në vend. Eksportuesit dhe përpunuesit më të mëdhenj të BMA-ve, si Relikaj, Muçaj, dhe MEIA (e vetmja kompani e fokusuar ekskluzivisht në prodhimin e vajrave esenciale) janë të përqendruar në Malësi të Madhe. Përveç tyre, edhe kompani të tjera të mëdha në zona të ndryshme të Shqipërisë, si AlbKalustyan, Filipi, dhe Gjedra, marrin sasi të mëdha të lëndës së parë të sherbelës nga Malësia e Madhe. Nga BMA-të, sherbela është bima që rritet më shumë në Malësi të Madhe dhe shërben si burimi kryesor i të ardhurave për fermerët vendas, në sajë të kultivimit në shkallë të gjerë të saj. Rëndësia gjithnjë e më e madhe ekonomike e ekstrakteve të bimëve dhe vajrave esenciale ka çuar vitet e fundit në zgjerim të sipërfaqeve të mbjella në Malësi të Madhe me bimën e makthit (Helichrysum italicum), livando (Lavandula spp.), rozmarina (Rosmarinus officinalis), trumza (Satureja montana), dhe dafina (Laurus nobilis)

Bashkia Malësi e Madhe

Sipërfaqe
951 km²
(6 njësi administrative dhe 56 fshatra)

Popullsia
21,684
(10,805 femra dhe 10,879 meshkuj).



6. INSTAT

Konstatimet Kryesore

Konstatimi I Grupet e interesit konfirmuan potencialin e bimëve mjekësore, të blegtorisë dhe produkteve të qumështit, të artizanatit tradicional dhe agroturizmit si zinxhirë vlerash të rëndësishëm për rritje ekonomike dhe përfshirjen e grave në aktivitet ekonomik në bashki. Në takimin me përfaqësueset e OJQ-së VIS u nënvizuan barrierat dhe mundësitë konkrete: angazhimi i grave konsiston kryesisht në konservimin tradicional të ushqimeve, mbledhjen e gështenjave dhe BMA-të.

Konstatimi II Gratë janë të përfshira në fazat e mbledhjes dhe të përpunimit të bimëve, kurse marrja e vendimeve përgjithësisht vazhdon të jetë prerogativë e burrave. Komuniteti është i interesuar për zgjerimin e prodhimit të bimëve mjekësore, por përballet me vështirësi në aspektin e njohurive, teknikave të kultivimit, dhe aksesit në treg. Gratë punojnë në këtë sektor në mëngjes, ndërsa pasdite kultivojnë parcelat e tyre (me madhësi 0,2-0,4 ha). Pjesëmarrja e grave dhe të rinjve dhe të rejave në sektorët tradicionalë (bujqësi) është e kufizuar. Pronari i Mediterranean Exports Imports Albania (MEIA) është i gatshëm të bashkëpunojë për futjen e bimëve të reja dhe me vlerë të lartë në treg, në bashkëpunim me gratë. Barrierat kryesore për këtë janë kostoja e fidanëve dhe ekspertiza. Ekziston mundësia që kompania të lidhë me gratë kontrata afatgjata B2F. Gjatë intervistave, si gratë, ashtu edhe kompania theksuan interesimin e tyre për bimët me një vjelje (si trumza), që do t'u mundësonte grave të ofronin shërbimet e tyre në këtë industri dhe në të njëjtën kohë të kultivonin parcelat e tyre për të ardhura shtesë.

Konstatimi III Bizneset e lidhura me turizmin (bujtinat/hotelet, restorantet, artizanati) ofrojnë mundësi punësimi për gratë,[7] megjithëse ka edhe ka barriera për hyrjen në këtë sektor, si aksesi i kufizuar në financim, marketing dhe në platforma të shitjes. Disa gra në Tamarë merren me mbledhjen e frutave të egra dhe përpunimin e reçeleve, prevedeve, lëngjeve të frutave dhe produkteve të tjera të zonës; ndonëse të pakta në numër, për promovimin dhe shitjen e produkteve të tyre ato mbështeten në një sipërmarrjen informale, e drejtuar nga një burrë. Krahas përpunimit agroushqimor, ato ndonjëherë merren edhe me punime artizanale, si qëndistaria. Djathi i Mishavinës prodhohet në zonën e Kelmendit. Ky djathë ka marrë certifikimin e produktit me tregues gjeografik të mbrojtur. Megjithatë, për shkak të teknologjisë tradicionale dhe kërkesës së tregut, ky djathë rrallëherë gjen treg jashtë zonës. Me gjithë ekzistencën e potencialit për prodhim në Tamarë, nuk ka një treg të dedikuar për ekspozimin dhe shitjen e produkteve për turistët. Bujtinat e zonës kanë filluar të prodhojnë produktet e tyre, duke e kufizuar tregun për prodhuesit e zonës. Krijimi i një pike të përbashkët shitjeje (tregu i zonës) do të ishte një mundësi e mirë tregtimi "0 km" për gratë e zonës dhe do të forconte prodhimin në shkallë të vogël. Shifrat e larta të migracionit kufizojnë potencialin ekonomik të zonës.

Konstatimi IV Qepja e një xhublete kërkon rreth gjashtë muaj dhe për të duhet: vegjë, lesh, mjetet për procesin e tjerrjes, punëtore të kualifikuara, si dhe një vegël tradicionale (vajancë). Çmimi për një xhubletë origjinale varion nga 10.000 deri në 15.000 euro. Megjithatë, disa nga proceset janë të vështira për t'u kompletuar. Në mungesë të prodhimit të xhubletës origjinale, disa artizanë po prodhojnë replika të tyre, që kërkohen në treg dhe shiten me çmim më të lirë, nga 350 deri në 500 euro. Bashkia po zbaton një projekt të financuar nga Ministria e Turizmit, për të ngritur një qendër aftësimi për prodhimin e xhubletës në Koplik dhe trajnimin e rreth 30 grave dhe të rejave me qëllimin përfundimtar prodhimin e një xhublete.

7. Analizë e sistemit të tregut: Sektori i turizmit në Shqipëri dhe pengesat e bizneseve për rritje. Risi Albania. Shih: https://www.risialbania.al/media/668e6468a03ce.pdf

Konstatimi V Bletaria (Bajzë): Janë rreth dhjetë sipërmarrje familjare të bletarisë. Duket se të dhënat e AZHBR-së për numrin e bletërritësve janë disi të ekzagjeruara dhe nuk pasqyrojnë plotësisht realitetin në terren. Shoqata vendore e bletërritësve nuk është aktive; mungon bashkëpunimi mes bletërritësve; nuk bëhen analiza laboratorike të bletëve ose të produktit përfundimtar; mjalti tregtohet kryesisht në shishe plastike; nuk ka shërbime ekstensioni për bletët; mungon trajtimi i duhur për bletët; dhe ka mungesë të enëve cilësore për ruajtjen e mjaltit (kontejnerë çeliku inoksidabël, centrifugat për vjeljen e mjaltit, etj.).

Konstatimi VI Produktet e qumështit/bulmeti (Hot – Ferma e Veleçikut): Rreth 60-70 familje fermere furnizojnë me qumësht baxhon e Veleçikut. Gratë merren kryesisht me kujdesin për bagëtinë dhe mjeljen. Gratë fermere që jetojnë afër baxhos e çojnë qumështin vetë në baxho. Një litër qumësht blihet për 60 lekë, por luhatjet e çmimeve dhe konkurrenca e padrejtë ndikon në biznesin e produkteve të qumështit. Ka mungesë forcash pune për shkak të emigracionit. Baxhoja mund ta shtojë prodhimin po të sigurojë më shumë qumësht, sepse tregu ka vend për sasi më të madhe produkti. Ka plane për zgjerimin e biznesit. Problemet kryesore lidhen me përdorimin e bidonëve plastikë për mbledhjen dhe transportimin e qumështit; nevojitet një njësi e vogël laboratorike për kontrollin e cilësisë dhe të gjurmueshmërisë së qumështit; po kështu, pjesa më e madhe e blegtorëve duhet të zbatojnë praktikat më të mira në prodhimin e bulmetit. Baxhoja e Reçit, në fshatin Reç, bashkëpunon me 25 blegtorë. Konstatimet dhe mangësitë në zinxhirin e vlerës janë të njëjta si ato për baxhon e Veleçikut.

Konstatimi VII Një pyll gështenjash me sipërfaqe 500 ha mban me punë një numër familjesh për rreth një muaj gjatë kohës së vjeljes së gështenjave në zonën e Reçit. Rreth 15 gra janë të angazhuara aktivisht si punëtore në kompaninë dhe qendrën e grumbullimit Agro Reçi, me pagë 3.000 lekë në ditë gjatë periudhave të pikut për grumbullimin dhe eksportimin e BMA-ve dhe gështenjave. Vjelja e gështenjave ofron punësim sezonal për rreth 220 familje në zonë, ku gratë kanë më shumë rol në procesin e mbledhjes manuale të tyre. Kooperativa Agro Reçi, e regjistruar si shoqëri e bashkëpunimit bujqësor (SHBB), ka 220 anëtarë, shumica e të cilëve janë kryefamiljarë meshkuj. Gështenjat eksportohen në Itali, Gjermani dhe Zvicër (150 ton në vitin 2024). Çmimi për një produkt të cilësisë së lartë është 5 euro/kg. Ndërsa rreth 10-15% e gështenjave me cilësi të ulët (kokërrvogël) mezi shiten për një të pestën e atij çmimi. Gjatë takimit, përfaqësuesit e kooperativës theksuan nevojën për një pajisje të vogël për bluarjen e gështenjave, për shtimin e vlerës së produktit me cilësi të ulët përmes përpunimit të gështenjave në miell gështenjash. Emigracioni ka pakësuar disponueshmërinë e forcës punëtore. Gratë në Reç kultivojnë edhe sherbelë dhe livando në parcela të vogla, dhe disa marrin edhe tokë shtesë me qira. Rëniet e kohëve të fundit në çmimin e sherbelës dhe problemet me cilësinë e bimës kanë pasur ndikim negativ të theksuar. Të dhënat nga intervistat treguan se fidanët kushtojnë 10-15 lekë për njësi dhe shitja e sherbelës së tharë me 50 lekë/kg nuk justifikon kostot vjetore të kultivimit të saj. Mungesa e kontratave me këtë industri ka kufizuar kultivimin prej tyre të bimëve të tjera, si bima e makthit (immortelle). Disa kanë filluar të bëjnë paketim (informal) në shkallë të vogël të BMA-ve, me etiketa të thjeshta, për panaire tregtare dhe shitje të drejtpërdrejta klientëve që vijnë në qendrën e tyre. Përfaqësuesi i kooperativës është shumë i gatshëm t'i mbështesë gratë në qoftë se krijohet mundësia për krijimin e një pike të vogël përpunimi brenda qendrës.

Sfida dhe zgjidhje Këto diskutime produktive me grupet e interesit theksuan frymën e bashkëpunimit për adresimin e sfidave të identifikuara dhe gjetjen e zgjidhjeve sa më të mira:

- Fuqia e kufizuar vendimmarrëse e grave dhe njohuritë e kufizuara të tyre, pavarësisht rolit të tyre aktiv në prodhim.
- Mungesa e aksesit në tregje të strukturuara dhe në panaire për të ekspozuar dhe shitur prodhimet vendore.
- Infrastrukturë e pamjaftueshme dhe akses i pamjaftueshëm në trajnime dhe në mbështetje financiare për bizneset e drejtuara nga gratë.
- Perspektivat e kufizuara për punësim në Malësi të Madhe i shtyjnë njerëzit drejt emigracionit (sidomos brezin e ri).

Pjesa 1
Metodologjia

Kjo analizë u krye nga UN Women Shqipëri, në kuadër të projektit "Fuqizimi i grave për zhvillim rural në Shqipërinë e Veriut", i financuar nga Ministria Italiane e Punëve të Jashtme dhe e Bashkëpunimit Ndërkombëtar, përmes Agjencisë Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor (AICS Tirana). Me mbështetjen e personelit të bashkisë dhe bashkëpunimin e grupeve të rëndësishme të interesit nga zinxhirët e vlerave, ky studim synoi të evidentonte sektorët ekonomikë me potencial për rritje dhe fuqizimin e grave në bashkinë e Malësisë së Madhe. Në veçanti, ai vlerësoi pjesëmarrjen e grave në këta sektorë, pengesat dhe vështirësitë me të cilat përballen, si dhe disa zinxhirë vlerash me potencial të lartë për zhvillim. Krahas kësaj, ai ofron rekomandime reaguese gjinore për forcimin e roleve të grave dhe eliminimin e paragjykimeve gjinore në sistemin e tregut. Gjatë gjithë analizës u zbatua një qasje me ndjeshmëri gjinore për të siguruar përfshirjen e plotë të mendimeve të grave, të sfidave dhe mundësive të tyre, në vlerësimin e zinxhirit të vlerës.

Kjo qasje me ndjeshmëri gjinore ndaj zinxhirëve të vlerës bazohet kryesisht në metodologjinë e shtjelluar në *Making the Strongest Links: A Practical Guide to Mainstreaming Gender analysis in Value Chain Development* (Krijimi i hallkave më të forta – udhëzues praktik për përfshirjen e analizës gjinore në zhvillimin e zinxhirit të vlerës) nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP) botuar në vitin 2007; udhëzuesi plotësues *Gender-Sensitive Approaches to Value Chain Development: A Complementary Guide* (Qasje me ndjeshmëri gjinore në zhvillimin e zinxhirit të vlerës: Udhëzues plotësues), po ashtu botim i ONP-së në vitin 2022; dhe *Guide for Practitioners dhe Interested Stakeholders* (Udhëzues për profesionistët dhe grupet e interesit) përgatitur nga USAID në vitin 2019 dhe ribotuar nga UN Women Shqipëri në vitin 2021.

Në analizë u përdor metodologjia e kërkimit sasior, me përfshirje të burimeve dytësore dhe parësore të të dhënave, për të siguruar një të kuptuar gjithëpërfshirës të dinamikave ekonomike dhe gjinore në bashkinë e Malësisë së Madhe. Për të përfshirë këndvështrimet e grupeve kryesore të interesit u përdor një qasje me pjesëmarrje, e cila siguroi që konstatimet të pasqyronin përvojat reale të njerëzve në terren. Ndër burimet dytësore që u përdorën ishin raporte dhe statistika të Institutit të Statistikave të Shqipërisë (INSTAT), të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, dhe studime dhe projekte të mëparshme lidhur me zhvillimin ekonomik me ndjeshmëri gjinore. Krahas këtyre, raportet bashkiake, si Plani Operacional i Zhvillimit Vendor – Bashkia Malësi e Madhe, Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Malësi e Madhe (2017),[8] Plani Social i Zonës (2020-2023),[9] dhe Plani Buxhetor Afatmesëm (2024-2026),[10] si dhe buxhete vjetore, ofruan informacion të vlefshëm në strukturën ekonomike dhe prioritetet zhvillimore të zonës. Për plotësimin e të dhënave dytësore, u krye edhe punë kërkimore në terren, përmes angazhimit të palëve të interesit, vizitave në terren, dhe konsultimeve me pjesëmarrje. Mbledhja e të dhënave u krye në dy faza.

Faza e parë përfshiu një vlerësim paraprak të sektorëve ekonomikë potencialë dhe zinxhirëve të vlerës, i kryer përmes konsultimeve me përfaqësues të bashkisë dhe të organizatave mbështetëse. Diskutime të rëndësishme u kryen me zëvendëskryetaren e bashkisë, Brunilda Isufaj, sekretaren e përgjithshme Emanuela Smakaj, dhe përfaqësues nga VIS Albania (zyra e Koplikut), që u fokusuan në kufizimet kryesore, mundësitë ekonomike, dhe barrierat e lidhura me gjininë në zinxhirë të ndryshëm vlere. Kjo faze ndihmoi në identifikimin e sektorëve me potencial të lartë për fuqizimin ekonomik të grave dhe përcaktimin e fushave prioritare për hulumtim të mëtejshëm.
Gjatë punës në terren dhe vlerësimeve të zinxhirëve të vlerës të kryera në bashkinë e Malësisë së Madhe, u angazhuan drejtpërdrejt 62 individë përmes intervistave, vizitave në terren dhe takimeve, nga të cilët 54 gra dhe 8 burra. Mbledhja e të dhënave parësore u nda në dy faza:

Vlerësimi paraprak: U mbajtën diskutime dhe takime me përfaqësues të bashkisë, prodhues, anëtarë të ekipit të projektit dhe organizata mbështetëse për të parë mundësitë e zinxhirëve të vlerës. Seancat në grupe fokusi me përfaqësues të bashkisë ndihmuan në identifikimin e kufizimeve, pengesave specifike gjinore, dhe mundësive që lidhen me zinxhirët ekzistues apo të krijuar rishtas të vlerës.

8. Shih: https://planifikimi.gov.al/index.php?id=732
9. Shih: https://bashkiamalesiemadhe.gov.al/wp-content/uploads/2020/10/Vendim-Nr-15-30.04.2020.pdf
10. Shih: https://bashkiamalesiemadhe.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/06.pdf

Bazuar në këtë punë paraprake në terren, u identifikuan disa sektorë kyç për analizë të mëtejshme, në sajë të potencialit të tyre për zhvillim ekonomik dhe pjesëmarrje përfshirëse të grave në fushat përkatëse. Ndër to ishin **produktet e qumështit, bimët mjekësore dhe aromatike (BMA), bletaria, dhe zejtaria tradicionale.** Këtyre sektorëve iu dha përparësi për shkak të aksesit të grave në to, potencialit për krijimin e vendeve të punës, njohurive ekzistuese në zonë dhe relevancës kulturore.

Në përputhje me Agjendën e ONP-së për Punë të Denjë, përzgjedhja e këtyre sektorëve thekson objektiva si:

- **Promovimi i punësimit produktiv** përmes sektorëve me mundësi zhvillimi dhe me intensitet të lartë pune në nivel vendor;
- **Zgjerimi i aksesit në mundësi të drejta** për fitim të ardhurash nga gratë dhe grupet e margjinalizuara;
- **Përmirësimi i kushteve të punës dhe mbrojtjes sociale,** sidomos në bujqësi dhe aktivitetet informale;
- **Forcimi i zërit dhe pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje** në të gjithë zinxhirët e vlerës.

Faza e dytë përfshiu përzgjedhjen e zinxhirëve të vlerës dhe angazhimin e grupeve të interesit. U kryen vizita në terren në sektorë ekonomikë të rëndësishëm për zonën, bazuar në potencialin ekonomik, diversitetin sektorial, dhe ekzistencën e nismave të drejtuara nga gratë. Këto vizita përfshinë intervista të gjysmëstrukturuara, konsultime në grup, dhe vrojtime në terren me gra sipërmarrëse, fermere, anëtare kooperative, dhe pronare biznesesh për të kuptuar përvojat, sfidat dhe mundësitë e tyre. Ndër takimet dhe vizitat më kryesore në terren ishin:

5 shkurt 2025:
- Takim me përfaqësuesen e zyrës së OJQ-së VIS Albania në Malësi të Madhe, Anna Carboni dhe ekipin e saj (pesë gra).
- Takime në grupe dhe intervista me 33 gra nga sektori i bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA) në Koplik (Kalldrun, Kamicë Flak, dhe Pjetroshan).
- Intervistë me Emiland Skorën, pronar i Mediterranean Exports Imports Albania (MEIA) – eksportues i vajrave esenciale të BMA-ve.
- Vizitë në Tamarë, NJA Kelmend, bisedë me artizanet e xhubletës dhe prodhueset e produkteve agroushqimore Drita Bujaj, Rrok Bujaj, dhe Dila Vacaj.

5 mars 2025:
- Vizitë në terren dhe intervista në firmën Veleçik Milk në Hot (NJA Kastrat), takim me pronarin Prelë Hasanaj dhe tri punëtore.
- Vizitë në terren në kooperativën/shoqatën bujqësore "Reçi Prodhimtar" (NJA Shkrel) dhe biseda me një përfaqësues të kooperativës dhe katër gra anëtare të kooperativës.
- Vizitë në biznesin e bletarisë të familjes Skaqaj në (NJA Kastrat), ku u intervistuan burra dhe gra sipërmarrëse.

Për të siguruar saktësinë dhe besueshmërinë e konstatimeve, u përdor metoda e trekëndëzimit, përmes krahasimit të të dhënave parësore (punës kërkimore në terren) me të dhënat dytësore (raporte dhe statistika zyrtare). Kjo forcoi vlefshmërinë e studimit dhe mundësoi kryerjen e një analize të gjithanshme të përmasave të zinxhirëve të zgjedhur të vlerës. Konstatimet vënë në pah mundësi të konsiderueshme për fuqizimin ekonomik të grave në Bashkinë Malësi e Madhe, dhe theksojnë nevojën për politika reaguese gjinore dhe ndërhyrje të fokusuara për eliminimin e barrierave në treg dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në veprimtari ekonomike.

Për vlerësimin e zinxhirëve potencialë të vlerës u përdorën këto kritere:
- A ka kërkesa në rritje për produktin?
- A janë të përfshira gratë në hallkat e zinxhirit të vlerës?
- A janë shumica e hallkave në zinxhirin e vlerës me bazë në bashki?
- A ka nisma të tanishme apo të kohëve të fundit që mund të shërbejnë si bazë për zinxhirin e vlerës?
- A krijohen mundësi nga zhvillimi i zinxhirit të vlerës?
- A ka lidhje midis asaj që bëjnë gratë dhe perspektivave për zhvillim/diversifikim në zinxhirin e vlerës?

Grupet e interesit të përfshira kontribuan aktivisht për identifikimin e të gjithë përbërësve kryesorë të sistemit të

tregut të zinxhirit të vlerës, duke diskutuar si për kufizimet, ashtu edhe rolin e grave në faza të ndryshme të proceseve. Përmes vizitave në terren, vrojtimit të drejtpërdrejtë aktiviteteve të punës dhe intervistave të gjysmëstrukturuara me pyetësorë të posaçëm për pjesëmarrës të ndryshëm në zinxhirin e vlerës, u krye vlerësim lidhur me fuqizimin e grave dhe barazinë gjinore në dy zinxhirë vlerash të rëndësishëm: BMA-të dhe produktet e qumështit/bulmeti.

Në përgjithësi, në proces u ndoqën këta hapa:

1. **Përcaktimi i objektivave dhe i grupit të synuar:** Caktimi i objektivave bazuar në synimet kombëtare dhe bashkiake (konkretisht, përmirësimi i jetesës dhe promovimi i barazisë gjinore) dhe përcaktimi i grupit të synuar dhe i kritereve të përzgjedhjes:

2. **Grupi i synuar:** gratë dhe burrat në zonat rurale veriore;

3. **Kriteret:** rëndësia e zinxhirit të vlerës në krijimin e mundësive për fuqizimin ekonomik ët grave.

4. **Vlerësimi i situatës në bashki:** Vlerësimi fillestar i situatës në bashki dhe studimi i planeve, strategjive, studimeve të mëparshme, etj.;

5. **Sektorët kryesorë:** Identifikimi i sektorëve kryesorë përmes vlerësimit të raporteve, të dhënave dhe botimeve të ndryshme;

6. **Vlerësimi i ZV-ve:** Vlerësimi i zinxhirëve kryesorë të vlerës në sektorët e përzgjedhur përmes marrjes së mendimeve, diskutimeve, dhe grupeve të fokusit;

7. **Përzgjedhja e ZV-ve:** Përzgjedhja e një deri në dy zinxhirëve të vlerës dhe vlerësimi i mundësive, kufizimeve dhe fushave të ndërhyrjes përmes punës kërkimore në terren;

8. **Rekomandime:** Rekomandime për bashkinë lidhur me përmirësimin e zinxhirit të vlerës dhe rekomandime për projektin në lidhje me mundësitë e ndërhyrjes.

Figura 1. Qasja metodologjike



Tabela 1. Klasifikimi dhe përzgjedhja e zinxhirëve të vlerës me përdorim të kritereve me ndjeshmëri gjinore

Kriteret	BMA-të	Produktet e qumështit/bulmetit
A ka lidhje midis asaj që bëjnë gratë dhe perspektivave për rritje/diversifikim në zinxhirin e vlerës?	Gratë janë të përfshira në pjesën më të madhe të fazave të zinxhirit të vlerës, si kultivimi, vjelja dhe tharja fillestare e bimëve. Një numër i vogël i tyre kanë filluar të bëjnë paketim të BMA-ve me etiketa të thjeshta (informale) për panaire tregtare dhe për klientët që vijnë në qendrën e tyre, që përfaqësojnë mundësi për rritje dhe diversifikim të mëtejshëm.	Gratë japin kontribut të rëndësishëm në kujdesin për kafshët, ushqyerjen e tyre, pastrimin e stallave, mjelje, dhe disa prej tyre punojnë edhe në baxho. Përfshirja e tyre në këto veprimtari të rëndësishme krijon mundësi për rritje të biznesit, sidomos përmes shtimit të prodhimit duke zbatuar praktikat e mira bujqësore.
A kanë (ose a mund të fitojnë) gratë aftësitë e nevojshme për shtimin e vlerës përmes përpunimit ose diversifikimit të produktit?	Nevojiten më shumë njohuri, sidomos për zbatimin e standardeve, certifikim, dhe zbatimin e praktikave më të mira në të gjitha proceset e kultivimit dhe të pasvjeljes, si dhe në përpunim, paketim dhe krijimin e brandit për konsumatorët përfundimtarë.	Gratë nuk kanë kontroll mbi asetet, atyre u mungojnë njohuritë për praktikat e mira bujqësore, dhe sidomos veglat dhe pajisjet për uljen e ngarkesës së punës dhe rritjen e produktivitetit. Ato mund të rrisin aftësitë e tyre duke marrë trajnim për praktikat më të mira, si trajnime për praktikat e mira blegtorale, standardet e higjienës, dhe menaxhimin e fermave.
A ofron zinxhiri i vlerës mundësi të reja për gratë?	Po. Në shkallë të gjerë, duke u angazhuar me sektorin në kultivimin me kontratë të bimëve të caktuara, dhe potencialisht në përpunim në shkallë të vogël (Reç).	Mesatar. Duke i pajisur gratë me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për praktikat më të mira, sidomos për sa i përket praktikave të mira blegtorale, ato mund të shtojnë produktivitetin dhe cilësinë, si dhe të ulin ngarkesën e tyre të punës.
A mund t'i përmirësojë zinxhiri i vlerës kushtet e jetesës për gratë/familjet e tyre?	Veprimtaritë e lidhura me BMA-të janë burimi kryesor i të ardhurave për shumë familje në zonë. Kultivimi i qëndrueshëm, përmes zbatimit të PMB-ve), krahas shërbimeve për industrinë, do të shtonte të ardhurat dhe do të forconte qëndrueshmërinë e ZV-së.	Po. Qumështi, sidomos nga ripërtypësit e vegjël, është produkt mjaft i kërkuar nga baxhot e zonës dhe mund të gjenerojë të ardhura të konsiderueshme, të rrisë prodhimin dhe madhësinë e tufave, pa e rritur ngarkesën e punës së grave – si rrjedhojë e njohurive dhe pajisjeve të marra prej tyre - mund të përmirësojë kushtet e jetesës dhe të shtojë të ardhurat.
A ka një organizatë të motivuar në zinxhirin e vlerës që mund të mbështesë/përfaqësojë pjesëmarrësit në zinxhirin e vlerës, e cila mund të çojë përpara zhvillimin?	Ka konsolidues vendorë që janë të interesuar të mbështesin ZV-në, dhe gratë në Reç mund të organizohen për të pasur përfaqësim më të mirë.	Po. Baxhot e zonës Veleçiku dhe Agro Reçi janë shumë të motivuara dhe interesuara për të mbështetur më tej aktorët në ZV. Përveç kësaj, grupimi i grave të zonës që merren me blegtori mund të forcojë më tej rolin e tyre.
A ka mundësi të bëhen ndryshime me investime të vogla?	Po, duke i mbështetur gratë me materiale dhe pajisje, ofrimin e trajnimeve dhe të seancave për ndërtimin e kapaciteteve dhe duke mbështetur promovimin në treg.	Po. Investime të vogla për pajisjet e nevojshme për mjelje, vegla dhe bidonë të standardizuar për mjelje dhe transportim; ndoshta një laborator i vogël analizash për gjurmueshmërinë, për të garantuar cilësinë dhe sigurinë ushqimore.

Tabela 2. Vlerësimi i fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore në ZV-në e BMA-ve

Pyetjet	Pikët*	Pesha**	Gjithsej	Përshkrimi
A është numri i grave të punësuara në zinxhirin e vlerës relativisht i lartë?	4	2	8	Një pjesë e konsiderueshme (të paktën 70%) e personave të angazhuar në zinxhirin e vlerës të BMA-ve janë gra.
A ka shumë gra sipërmarrëse në zinxhirin e vlerës?	2	2	4	Gratë marrin pjesë në shumicën e fazave të zinxhirit të vlerës, si kultivimi, vjelja dhe tharja fillestare e bimëve. Një numër i vogël i tyre kanë filluar të bëjnë paketim të BMA-ve me etiketa të thjeshta (informale) për panaire tregtare dhe për klientët që vijnë në qendrën e tyre, që ofrojnë mundësi për rritje dhe diversifikim të mëtejshëm. Ka edhe gra të tjera që kultivojnë parcelat e tyre ose kanë marrë më shumë tokë me qira.
A kanë gratë kontroll mbi pajisjet dhe asetet?	2	2	4	Mesatar. Pronësia mbi tokën mbetet problem që kufizon kontrollin mbi asetet. Pajisjet dhe veglat janë nën kontroll të përbashkët.
A kanë (apo a mund të fitojnë) gratë aftësitë e nevojshme për ndonjë shtim interesant të vlerës përmes përpunimit ose diversifikimit të produktit?	4	1	4	Gratë mund të shtojnë aftësitë e tyre duke zbatuar praktikat më të mira në kultivim dhe duke bërë përpunim në shkallë të vogël për konsumatorët përfundimtarë në treg.
A kanë kontroll gratë mbi të ardhurat nga shitjet dhe mbi sipërmarrjen?	2	2	4	Mesatar. Gjatë intervistave me gratë, disa prej tyre theksuan se i menaxhojnë të ardhurat vetë, ndërsa të tjera thanë se i menaxhojnë bashkërisht me kryefamiljarin (burrë).
A mund të kryhet puna afër shtëpisë?	3	1	3	Po.
A janë të ulëta barrierat në këtë ZV për hyrjen e sipërmarrëseve të varfra (prodhim i vogël, kosto e ulët për fillim biznesi, nuk kërkon investime kapitale madhore, me përdorim aftësish teknologjike të ulëta)?	4	1	4	Po. Sidomos nëse kultivojnë bimë të përhershme. Kostot kryesore lidhen me përgatitjen e tokës, fidanët (që përbëjnë pjesën më të madhe të kostove) dhe forcat e punës.
A janë të ulëta barrierat në këtë ZV për përfshirjen e grave në të (koha dhe aftësia për të lëvizur, aksesi në teknologji dhe asete, kufizimet kulturore)?	3	2	6	Po. Gratë merren edhe tani me kultivim, si edhe punojnë për industrinë. Megjithatë, ende ka pengesa në lidhje me aksesin në informacion, në shërbimet e ekstensionit, pajisje dhe kredi.
A ofron ky ZV mundësi të reja për gratë?	2	4	8	Mesatar, përveç në rastin kur gratë synojnë tregun përfundimtar (lokal).
A është aktiviteti në ZV në përputhje me kushtet e jetesës (të ardhurat gjatë vitit, përdorimi i punës së familjarëve, kthim i shpejtë i investimit, ruajtja e paprekur e mjedisit)?	4	2	8	I lartë. Përmes kalimit në kultivim, futjes së bimëve të përhershme me një vjelje për uljen e kostove të mbjelljes dhe të forcës së punës, si dhe zbatimit të praktikave të mira bujqësore.
A ka lidhje midis asaj që bëjnë gratë dhe perspektivave për rritje/ diversifikim në zinxhirin e vlerës?	4	1	4	I lartë. Njësoj si më lart.

(Vazhdon në faqen tjetër)

Pyetjet	Pikët*	Pesha**	Gjithsej	Përshkrimi
A ka norma gjinore (për shembull, ngecje në 'punët e grave') që i pengojnë gratë të përfitojnë plotësisht nga mundësitë e zinxhirit të vlerës?	3	2	6	Industria është nën kontrollin e burrave. Megjithatë, nuk ka norma shtesë që t'i pengojnë gratë të shfrytëzojnë mundësitë e zinxhirit të vlerës, sidomos në përpunimin në shkallë të vogël për konsumatorët përfundimtarë në treg (lokal).
Totali i përgjithshëm i potencialit gjinor			**63/102**	

* Pikëzimi: 0 (shumë i ulët, jo, aspak) deri në 5 (shumë i lartë, po, shumë i rëndësishëm).

** Pesha nga 1 në 4, sipas rëndësisë dhe impaktit që ka secila prej pikave të mësipërme në arritjen e objektivave të përcaktuara[11]

Tabela 3. Vlerësimi i fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore në ZV-në e prodhimeve të qumështit/bulmetit

Pyetjet	Pikët*	Pesha**	Gjithsej	Përshkrimi
A është numri i grave të punësuara në zinxhirin e vlerës relativisht i lartë?	3	2	6	Po. Gjatë vizitës në terren u theksua se gratë luajnë një rol kyç në punët që lidhen me blegtorinë.
A ka shumë gra sipërmarrëse në zinxhirin e vlerës?	2	2	4	Të paktën 90 gra merren me blegtori dhe furnizojnë me qumësht dy baxho të zonës.
A kanë gratë kontroll mbi pajisjet dhe asetet?	2	2	4	Mesatar. Duke pasur parasysh se pronarët e fermave janë më së shumti meshkuj, gratë nuk kanë të drejta pronësore. Megjithatë, ato janë kontroll mbi pajisjet që përdoren në fazat ku janë të përfshira.
A kanë (apo a mund të fitojnë) gratë aftësitë e nevojshme për ndonjë shtim interesant të vlerës përmes përpunimit ose diversifikimit të produktit?	3	1	3	Gratë zotërojnë aftësitë bazë në praktikat bujqësore, por me trajnim të nevojshëm ato mund t'i zhvillojnë më tej aftësitë drejt praktikave të mira blegtorale, sidomos në kujdesin për kafshët, higjienën në mjelje, sigurinë dhe gjurmueshmërinë ushqimore, mjedis, dhe menaxhim social-ekonomik.
A kanë kontroll gratë mbi të ardhurat nga shitjet dhe mbi sipërmarrjen?	2	2	4	Mesatar. Kontrolli mbi të ardhurat varion midis menaxhimit të pavarur dhe vendimmarrjes së përbashkët.
A mund të kryhet puna afër shtëpisë?	3	1	3	Ka edhe familje që i menaxhojnë bagëtitë në një sistem ushqimi në stallë, por ndonjëherë tufat e bagëtive të imta gjenden larg shtëpisë.
A janë të ulëta barrierat në këtë ZV për hyrjen e sipërmarrëseve të varfra (prodhim i vogël, kosto e ulët për fillim biznesi, nuk kërkon investime kapitale madhore, me përdorim aftësish teknologjike të ulëta)?	2	1	2	Krijimi i një tufe nga fillimi ka kosto shumë të lartë për sipërmarrësit e varfër. Për shembull, një dhi me prodhimtari të lartë qumështi mund të kushtojë deri në 35.000 lekë.

11. Përcaktimi i zinxhirëve prioritarë të vlerës mbi bazën e mundësive që ofrojnë për promovimin e barazisë gjinore si një mënyrë efektive për të vënë në pah faktorët që kanë ndikim pozitiv në punësimin dhe të ardhurat e grave dhe të vajzave. Për këtë qëllim është përdorur një sistem klasifikimi nga 1 në 4 (ku 1 është 'i ulët', 2 'mesatar', 3 'mirë', dhe 4 'shumë mirë'). Bazuar në: Women's Inclusion and Value Chain Improvement in Albania – A Guide for Practitioners and Stakeholders (Përfshirja e grave dhe përmirësimi i zinxhirit të vlerës në Shqipëri – Udhëzues për punonjësit dhe palët e interesit). USAID 2019 dhe UN Women 2021.

Pyetjet	Pikët*	Pesha**	Gjithsej	Përshkrimi
A janë të ulëta barrierat në këtë ZV për përfshirjen e grave në të (koha dhe aftësia për të lëvizur, aksesi në teknologji dhe asete, kufizimet kulturore)?	4	2	8	Varet nga madhësia e tufës, por ende konsiderohet veprimtari familjare. Aksesi në teknologji është mesatar dhe nuk ka pengesa kulturore/zakonore të dukshme.
A ofron ky ZV mundësi të reja për gratë?	3	4	12	Mesatar. Gratë mund të shtojnë aftësitë e tyre përmes trajnimeve për praktikat e mira blegtorale dhe të shtojnë të ardhurat përmes përmirësimit të tufave dhe shtimit të prodhimit të qumështit.
A është aktiviteti në ZV në përputhje me kushtet e jetesës (të ardhurat gjatë vitit, përdorimi i punës së familjarëve, kthim i shpejtë i investimit, ruajtja e paprekur e mjedisit)?	4	2	8	Po. Blegtoria siguron të ardhura të qëndrueshme gjatë gjithë vitit, sidomos kur përdoret sistemi i ushqyerjes në stallë.
A ka lidhje midis asaj që bëjnë gratë dhe perspektivave për rritje/ diversifikim në zinxhirin e vlerës?	4	1	4	Po. Futja e praktikave të mira blegtorale për sigurimin e mirëqenies së bagëtive, praktikave të mjeljes dhe teknologjive të reja për të garantuar sigurinë ushqimore dhe për të ulur sasinë e kohës dhe ngarkesën e punës së grave; si dhe mbajtja e dokumentacionit për menaxhim efektiv të tufës.
A ka norma gjinore (për shembull, ngecje në 'punët e grave') që i pengojnë gratë të përfitojnë plotësisht nga mundësitë e zinxhirit të vlerës?	4	2	8	Jo. Gratë edhe tani merren aktivisht me blegtori dhe prodhimin e qumështit, pa ndonjë pengesë të madhe kulturore/zakonore.
Totali i përgjithshëm i potencialit gjinor			**66/102**	

* Pikëzimi: 0 (shumë i ulët, jo, aspak) deri në 5 (shumë i lartë, po, shumë i rëndësishëm).

** Pesha nga 1 në 4, sipas rëndësisë dhe impaktit që ka secila prej pikave të mësipërme në arritjen e objektivave të përcaktuara[12]

12. Përcaktimi i zinxhirëve prioritarë të vlerës mbi bazën e mundësive që ofrojnë për promovimin e barazisë gjinore si një mënyrë efektive për të vënë në pah faktorët që kanë ndikim pozitiv në punësimin dhe të ardhurat e grave dhe të vajzave. Për këtë qëllim është përdorur një sistem klasifikimi nga 1 në 4 (ku 1 është 'i ulët', 2 'mesatar', 3 'mirë', dhe 4 'shumë mirë'). Bazuar në: Women's Inclusion and Value Chain Improvement in Albania – A Guide for Practitioners and Stakeholders (Përfshirja e grave dhe përmirësimi i zinxhirit të vlerës në Shqipëri – Udhëzues për punonjësit dhe palët e interesit). USAID 2019 dhe UN Women 2021.

Pjesa 2

Analiza e Zinxhirit të Vlerës së Bimëve Mjekësore dhe Aromatike

1. Analizë me Ndjeshmëri Gjinore e Zinxhirit të Vlerës së BMA-ve

Shqipëria ka traditë të gjatë në prodhimin dhe eksportin e BMA-ve. Shtytësi kryesor i zhvillimit në sektorin e furnizimit është bollëku dhe shumëllojshmëria e BMA-ve të egra. Rreth 15% e 3.250 llojeve të bimëve shqiptare kanë vlera mjekësore, aromatike, si erëza dhe tanina. Ky sektor ka një traditë të gjatë, më se 60 vjeçare. Aktualisht, mbledhja, kultivimi, përpunimi dhe tregtimi i BMA-ve është një biznes i rëndësishëm agropyjor në Shqipëri.[13]

Sipas Agjencisë Shqiptare të zhvillimit të Investimeve (AIDA), mbi 85.000 persona (kryesisht nga zonat rurale) janë të përfshirë në të gjithë zinxhirin e vlerës, që nga mbledhja e bimëve të egra, kultivimi, deri tek eksporti. Numri total i grave të përfshira drejtpërdrejt i kalon 60.000 (AGT-DSA, 2021).[14] Rreth një e pesta e familjeve në zonat rurale malore merren me aktivitete që sjellin të ardhura nga bimët mjekësore dhe aromatike: vjelje e kultivim, ose në punë të tjera në zinxhirin e vlerës të BMA-ve. Afërsisht 400 lloje të BMA-ve janë identifikuar si bimë mjekësore dhe aromatike të florës shqiptare dhe mbi 200 lloje mblidhen dhe eksportohen. Rreth 90% e prodhimit të bimëve mjekësore dhe aromatike eksportohet, që përfaqëson gati 20% të totalit të eksporteve bujqësore të Shqipërisë. Në vitin 2022, prodhimi vendor i BMA-ve ishte 16.430 ton. Gjithashtu, në vitin 2022, eksportet totale të bimëve mjekësore dhe aromatike arritën vlerën 63 milion euro, me një rritje prej 6,7% nga viti i mëparshëm (59 milion euro).[15]

Sipërfaqja e kultivuar me BMA arriti në 7.200 hektarë në vitin 2023,me një prodhim prej 17.800 ton. Kultivimi i BMA-ve është përqendruar në Malësinë e Madhe (5.200 ha), por po përhapet me ritme të shpejta edhe në rajone të tjera të vendit (në Belsh 478 ha, Cërrik 188 ha, Gramsh 135 ha, etj.).[16]

Mbi 60,000 gra janë të përfshira drejtpërdrejt në zinxhirin e vlerës së bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA-ve), nga mbledhja deri te eksporti.

Edhe pse kërkesa për BMA në tregun e brendshëm është e kufizuar, një gamë e gjerë BMA-sh me nivel më të ulët përpunimi shiten në tregjet e frutave dhe perimeve të freskëta dhe në dyqane. Ndër produktet kryesore që shiten në tregjet e brendshme janë çajet bimore dhe erëzat që përdoren për gatim. Aktualisht, çaji dhe salepi paketohen nga kompani shqiptare dhe shiten në dyqane, si edhe në supermarkete dhe restorante. Po kështu në tregjet e frutave dhe perimeve të freskëta shiten edhe barishte dhe erëza të tjera, të paketuara në qese të thjeshta - zakonisht me peshë 20-100 gram.[17]

Gjatë periudhës së ekonomisë së centralizuar, rreth 110.000 persona në zonat rurale punonin në qendra grumbullimi, ndërmarrje pyjore, dhe magazina e fabrika përpunimi, të cilat funksionin në kuadër të një rrjeti të përpunimit dhe eksportit të BMA-ve (Skënderi, 1991).[18] Rrjeti i furnizimit ishte i mirorganizuar nëpërmjet një ndërmarrjeje të vetme shtetërore dhe një eksportuesi të

13. Studim për sektorin e bimëve mjekësore dhe aromatike. MBZHR dhe GIZ, 2021. Shih: https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/04-MAP-Sector-Study_FINAL.pdf
14. *The Role of Women in Assuring Quality - Empowering Women in the Medicinal and Aromatic Plants (MAPs) Sector* (Roli i grave në sigurimin e cilësisë – fuqizimi i grave në sektorin e bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA).) DSA 2024. Shih: https://hub.unido.org/sites/default/files/publications/Gender%20Report%20brochure%20WEB.pdf
15. Biofach 2024. AIDA. Shih: https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/BIOFACH-24-broshure-1.pdf
16. INSTAT – Vjetari statistikor i bujqësisë, 2023.
17. Studim për sektorin e bimëve mjekësore dhe aromatike. AASF, 2023. Shih: https://aatsf.com.al/wp-content/uploads/2020/04/4Mapcover-EN.pdf
18. Bimë mjekësore nga Shqipëria). ALIMPEKS, Tiranë, Shqipëri. Skënderi, G., 1991.

vetëm nën kontrollin e shtetit, Albanian Import Export (ALIMPEKS), që lidhte Shqipërinë me tregjet globale për shitjen e BMA-ve. Deri në vitet 1990, eksportoheshin rreth 5.000 - 7.000 ton BMA, duke e bërë Shqipërinë nja nga eksportueset më të mëdha të BMA-ve drejt Evropës, me vlerë eksporti vjetor deri në rreth 70 milion USD (Skënderi, 1991). Eksportet e BMA-ve konsistonin në rreth 176 lloje, bimë tanifere, vajra esenciale, dhe rreth 300 barna mjekësore, si nga BMA-të e egra ashtu edhe ato të kultivuara, si dafina, rozmarina, trumza, livando, kamomili gjerman, dhe mërsina, të cilat kultivohen gjerësisht nga disa kooperativa. Kultivimi i BMA-ve bëhej në rreth 3.000 hektarë në zona të specializuara në të gjithë vendin, veçanërisht në Durrës, Lushnjë, Gramsh, dhe Belsh. Vetëm trumza edhe kultivohej, edhe mblidhej si bimë e egër, ndërsa të gjitha speciet e tjera mblidheshin të egra. Gjatë periudhës 1990-91, e gjithë ekonomia shqiptare, përfshirë sektorin agroushqimor, pësoi kolaps gjatë tranzicionit nga ekonomia e centralizuar në ekonomi tregu, që çoi në mbylljen e plotë të ndërmarrjeve shtetërore. Si rezultat, kultivimi i e BMA-ve gati ndaloi plotësisht dhe infrastruktura pothuaj u shkatërrua. Eksporti i BMA-ve ra në mënyrë drastike, që ndikoi negativisht në cilësinë dhe qëndrueshmërinë e furnizimeve të rregullta në tregjet që i kërkonin këto produkte.[19]

Këto vështirësi me të cilat përballej sektori, krijuan mundësi për sipërmarrës privatë që të bëheshin eksportues të mëdhenj të BMA-ve, që çoi në lindjen e sektorit privat të BMA-ve. Gjatë kësaj periudhe u ngritën distileri me kapacitete të konsiderueshme, veçanërisht në Vlorë dhe Shkodër, të cilat kontribuan në rritjen e këtij sektori. Gjatë dekadës së parë të tranzicionit në ekonomi tregu (1990-2000), kompania AlbDucros doli në treg me pothuaj monopol të plotë në eksportet e BMA-ve, duke mbajtur një farë kontrolli mbi zinxhirin e vlerës dhe një pozitë më të fortë në tregun e eksportit. Megjithatë, pas vitit 2000, në tregun e BMA-ve u shfaqën më shumë se dy duzina kompani eksportuese të madhësive të ndryshme. Dalja e tyre në skenë çoi në konkurrencë të ashpër për BMA të egra të papërpunuara, mungesë koordinimi dhe të zbatimit të standardeve. Kërkesa në rritje për BMA, e shoqëruar me një rënie në sasinë e BMA-ve të egra të mbledhura, i shtyu këta eksportues të nxisnin kultivimin e BMA-ve. Gradualisht, sektori i BMA-ve filloi ta marrë veten, që çoi në hapat e parë drejt industrializimit të plotë, i përqendruar kryesisht në mbledhjen e

Me rritjen e kultivimit të bimëve mjekësore dhe aromatike roli i grave është zgjeruar në bujqësi dhe përpunim, veçanërisht në rajoninin e Malësisë së Madhe.

BMA-ve të egra dhe përpunimin e tyre, dhe me miliona euro investime në teknologji dhe ndërtime të reja, veçanërisht pas vitit 2014.[20] Gjatë fazës së hershme të tranzicionit në ekonominë e tregut, eksportet dominoheshin nga BMA-të e mbledhura si bimë të egra, për shkak të (i) numrit të madh të popullsisë që ende jetonte në zonat rurale, që e kishin atë burim i rëndësishëm të ardhurash duke pasur parasysh mungesën e mundësive alternative të punësimit, dhe (ii) kërkesave në rritje. Rreth 200 BMA të ndryshme, ku mbizotëronin tetë specie kryesore, mblidheshin si bimë të egra, kryesisht në pyjet, livadhe dhe zonat me bimësi të egër, dhe shiteshin në tregun ndërkombëtar. Në periudhën nga viti 2015 deri në vitin 2022 në Shqipëri u përhap me shpejtësi kultivimi i bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA), i nxitur nga subvencionet shtetërore dhe rënia e sasive të bimëve të egra të mbledhura, shkaktuar nga emigrimi i banorëve nga zonat rurale në ato urbane. Me largimin e gjithnjë e më shumë banorëve nga vendet tradicionale të mbledhjes së bimëve në natyrë, kultivimi u bë metoda kryesore e prodhimit të BMA-ve, duke siguruar furnizim të qëndrueshëm për tregjet e brendshme dhe ato të eksportit. Ndër zonat ku pati rritje të ndjeshme, Elbasani dhe Korça ishin ato që i zgjeruan ndjeshëm sipërfaqet për kultivimin e BMA-ve, me rritje përkatësisht 294% dhe 177%. Megjithatë, zona e Shkodrës, veçanërisht Malësia e Madhe, mbeti kryesuesja e padiskutueshme në prodhimin e BMA-ve, me më shumë se dy të tretat

19. Studim për sektorin e bimëve mjekësore dhe aromatike. MBZHR dhe GIZ, 2021. Shih: https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/04-MAP-Sector-Study_FINAL.pdf

20. Imami, D., Ibraliu, A., Gruda, N.S., Skreli, E., Fasllia, N.,2015. Analiza e zinxhirit të vlerës së BMA-ve në Shqipëri. Gesunde Pflanzen. 67:155–164. Shih: https://www.academia.edu/80658249/Erratum_to_Analysis_of_the_Medicinal_and_Aromatic_Plants_Value_Chain_in_Albania

e totalit të BMA-ve të kultivuara në Shqipëri. Klima e favorshme, tradita në kultivimin e BMA-ve, dhe rrjeti i konsoliduar i fermerëve dhe përpunuesve, e kanë konsoliduar vendin e saj si zona më e rëndësishme e prodhimit të BMA-ve në vend.

Nuk është rastësi që eksportuesit dhe përpunuesit më të mëdhenj të BMA-ve, si Relikaj, Muçaj, dhe MEIA (e vetmja kompani që merret ekskluzivisht me prodhimin e vajrave esenciale), janë të përqendruar në Malësinë e Madhe. Përveç tyre, kompani të tjera të mëdha në rajone të ndryshme të Shqipërisë, si AlbKalustyan, Filipi, dhe Gjedra, marrin sasi të konsiderueshme lëndësh të para të sherbelës nga Malësia e Madhe.
Sherebela është BMA-ja më e mbjellë në Malësinë e Madhe dhe burimi kryesor i të ardhurave për fermerët lokalë, në sajë të kultivimit të saj në shkallë të gjerë. Rëndësia ekonomike në rritje e ekstrakteve bimore dhe vajrave esenciale ka çuar vitet e fundit në zgjerimin e sipërfaqeve të kultivuara në Malësinë e Madhe me bimën e makthit (Helichrysum italicum), livando (Lavandula spp.), rozmarinë (Rosmarinus officinalis), trumzë (Satureja montana), dhe dafinë (Laurus nobilis). Shtimi i sipërfaqes së kultivuar me BMA dhe i numrit të specieve të BMA-ve të kultivuara, ndoshta mund të kundërbalancojë efektet e kombinuara të rritjes së kërkesës për BMA dhe rënies së numrit të individëve apo familjeve që grumbullojnë BMA-ve të egra.[21]
Me rritjen e vazhdueshme të prodhimit dhe tregtimit të bimëve mjekësore dhe aromatike në Shqipëri, shtohen edhe sfidat për shkak të rregullave më të rrepta, veçanërisht në tregun e Bashkimit Evropian (BE). Rregullat e reja po rikonfigurojnë mënyrën se si veprojnë prodhuesit shqiptarë, duke i detyruar që t'u përshtaten standardeve më të larta të sigurisë, qëndrueshmërisë, dhe gjurmueshmërisë. Një nga pengesat më të mëdha për eksportimin e BMA-ve shqiptare ka qenë vendosja e rregullave më të rrepta të sigurisë ushqimore, veçanërisht në lidhje me alergjenët dhe lëndët toksike.[22] Në vitin 2022, BE-ja miratoi Rregulloren nr. 2020/2040, që kufizon praninë e Alkaloideve të Pirrolizidinës (PA) në ushqime të caktuara, si erëzat, barishtet e thata, çajet, dhe suplementet barishtore. Këta përbërës, që mund t'i kontaminojnë BMA-të përmes barërave të këqija natyrale, kanë krijuar sfida të rëndësishme për eksportet e prodhuesve shqiptarë. Shumë eksportues dhe specialistë të sektorit përmendin nivelet e larta të PA-ve si një nga pengesat më kryesore për akses në tregjet e BE-së. Po kështu, masa të reja të sigurisë mikrobiologjike kërkojnë trajtim të detyrueshëm me nxehtësi, për eliminimin e patogjenëve ushqimorë, që zëvendëson metodat tradicionale me përdorim kimikatesh. Ky ndryshim u përgjigjet kërkesave në rritje të konsumatorëve për produkte më të pastra, më natyrore, por ai përbën njëkohësisht edhe një sfidë të konsiderueshme financiare për bizneset shqiptare. Teknologjitë e trajtimit me nxehtësi kërkojnë investime të konsiderueshme, që ua bën të vështirë prodhuesve më të vegjël që të përmbushin standardet e BE-së pa mbështetje të jashtme.
Përtej kritereve të sigurisë, kërkesa për BMA organike dhe të rritura me metoda të qëndrueshme mjedisore, nuk ka qenë asnjëherë më e lartë se sot.[23] Konsumatorët në të gjithë Evropën gjithnjë e më shumë kërkojnë produkte organike të certifikuara, të shtyrë nga shqetësimet për shëndetin dhe ndërgjegjësimi mjedisor. Eksportuesit konfirmojnë se blerësit sot presin që produktet të kenë prova për praktika të rritjes së qëndrueshme të bimëve dhe certifikim organik, që kërkon nga fermerët shqiptarë të rimendojnë metodat e kultivimit. Për ata që janë të aftë t'i përmbushin këto standarde po hapen mundësi të reja tregu, por për shumë prodhues të vegjël, tranzicioni drejt bujqësisë organike mbetet proces kompleks dhe i kushtueshëm.[24]
Një tjetër shqetësim në rritje është gjurmueshmëria dhe transparenca në hallkat e zinxhirit të furnizimit. Blerësit evropianë duan të dinë saktësisht ku dhe si rriten, mblidhen dhe përpunohen BMA-të. Megjithatë, aktiviteti bujqësor me kontratë – që është një mekanizëm kyç për garantimin e gjurmueshmërisë së zinxhirit të furnizimit – është ende pak i zhvilluar në Shqipëri. Pa marrëveshje të qarta midis fermerëve dhe blerësve, gjurmimi i produkteve nga fusha në destinacionin përfundimtar të eksportit bëhet e vështirë, që përbën një sfidë shtesë për këtë sektor.

21. Studim për sektorin e bimëve mjekësore dhe aromatike. MBZHR dhe GIZ, 2021. Shih: https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/04-MAP-Sector-Study_FINAL.pdf

22. CBI, 2023. *Which trends offer opportunities or pose threats on the European spices dhe herbs market?* (Cilat tendenca ofrojnë mundësi ose përbëjnë rrezik ndaj tregut Evropian të erëzave dhe barishteve?) Shih: https://www.cbi.eu/market-information/spices-herbs/trends

23. Shih: https://www.giz.de/en/downloads/giz-2021-en-practical-market-insights-into-the-product-group-of-medicinal-and-aromatic-plants.pdf; https://www.londondaily.news/global-organic-food-market-growth-trends-and-future-projections-2025-2034/; https://www.skaleurope.org/news/the-booming-economics-of-organic-food-in-europe/

24. Studim për sektorin e bimëve mjekësore dhe aromatike. MBZHR dhe GIZ, 2021. Shih: https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/04-MAP-Sector-Study_FINAL.pdf

Për prodhuesit dhe eksportuesit shqiptarë të BMA-ve, orientimi nëpër këto ndryshime rregullatore është shumë i rëndësishëm që ata të vazhdojnë të jenë konkurrues në tregun ndërkombëtar. Investimet [për kontrollin e cilësisë, teknologjitë moderne të përpunimit, certifikimi organik, dhe menaxhimi i një zinxhiri transparent furnizimi, do të jenë vendimtare për t'i kapërcyer këto pengesa dhe për të siguruar një të ardhme solide për sektorin e BMA-ve në Shqipëri.

Tabela 4. Analiza SWOT e zinxhirit të vlerës të BMA-ve

Pikat e forta	Pikat e dobëta
Biodiversiteti i pasur dhe klima e favorshme. Në vend rriten rreth 400 lloje bimësh mjekësore, që përfaqësojnë afërsisht 15% të florës totale, dhe mbi 200 prej tyre mblidhen dhe tregtohen.	**Mungesa e aksesit të fermerëve të vegjël** dhe të varfër, sidomos grave, në mundësi financimi.
Afërsia me tregjet evropiane.	**Përfshirja informale e grave** në sistemin e tregut.
Pjesa më e madhe e sektorit është e përqendruar në këtë zonë.	**Asimetri në marrjen e informacionit** për zhvillimet në treg.
Shembuj të mirë dhe zgjerim i shpejtë i sipërfaqeve të kultivuara dhe përvoja të mëparshme kultivimi në zonë.	**Rrezikimi nga kushtet klimatike** mund të ndikojë në prodhimin e BMA-ve.
BMA-të konsiderohen si një prej potencialeve kryesore të rinovueshme për zhvillimin social-ekonomik të zonave rurale.	**Puna e rëndë dhe kushtet e vështira të punës,** sidomos për gratë.
Gatishmëria e industrisë për të bashkëpunuar me fermerët e zonës.	**Mungesë e të rinjve të interesuar** në BMA-të.
Gatishmëria e grave dhe fshatarëve për të kultivuar kultura të përhershme për uljen e kostos dhe të krahut të punës.	**Mungesë aksesi në informacion të besueshëm** për çmimin e produktit; luhatjet sezonale të çmimeve, së bashku me perceptimin e 'mashtrimit' nga shitësit.
Angazhimi i aktorëve kryesorë të zinxhirit të vlerës për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së produktit për t'iu përgjigjur kërkesave dhe standardeve të tregut ndërkombëtar.	**Mungesë aksesi në materiale të certifikuara inputesh,** sidomos nga fermerët e varfër.
Përfshirja e grave në faza të ndryshme të zinxhirit të vlerës dhe ndërgjegjësimi më i madh i tyre për rolin kyç që luajnë dhe kontributin që japin.	**Çmimi i lartë i fidanëve** dhe kostot e mekanizimit ndikojnë angazhimin e fermerëve të varfër në kultivim.
Kërkesa në rritje të tregut për produkte me cilësi të lartë dhe të certifikuara për prodhim të qëndrueshëm dhe të favorshëm për mjedisin	

Mundësitë	Kërcënimet
Shumëllojshmëria e madhe e specieve të bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA) në zonë tregon potencial për kultivim.	**Speciet bimore të rrezikuara** (mbledhja e bimëve të egra);
Fokusi në kultivimin e bimëve të përhershme.	**Ndikim negativ në biodiversitet** dhe habitatin natyror – vjelja e tepruar e BMA-ve dhe degradimi i mjedisit mund të rrezikojnë jetëgjatësinë e prodhimit të BMA-ve të egra.
Mundësi e mirë për të sjellë ndryshim me investime të vogla, përfshirë trajnimet në zbatimin e praktikave të mira.	**Niveli i lartë i emigracionit** që ndikon në forcat e punës.
Zhvillimet e reja dhe përparimi i bërë në proceset pas vjeljes (tharje, trajtim dhe distilim i vajrave esenciale).	**Varësia nga kushtet klimatike:** ndryshimet klimatike përbëjnë kërcënim të konsiderueshëm sidomos sepse ndryshimet e motit mund të ndikojnë në rritjen dhe prodhimin e bimëve.
Kërkesë e lartë për BMA (në tregun e brendshëm dhe ndërkombëtar)	**Luhatjet në tendencat e tregut** (ndërkombëtar).
Përpunim në shkallë të ulët (nga gratë) në Reç për konsumatorët përfundimtarë të tregut lokal.	**Zbatimi i rregulloreve dhe standardeve** më të rrepta ndërkombëtare.

2. Diagrami i Zinxhirit të Vlerës të Bimëve Mjekësore dhe Aromatike

Në vijim paraqitet një diagram gjithëpërfshirës i hallkave të zinxhirit të vlerës, aktorëve, faktorëve mbështetës dhe çështjeve kryesore të identifikuara, bazuar në konstatimet nga intervistat me grupet e interesit dhe agjencitë mbështetëse vendore, puna kërkimore në terren, dhe konsultimet me specialistët. Diagrami paraqet grupet kryesore të interesit, fazat që nga inputet deri në tregun përfundimtar dhe ndihmon në identifikimin e vështirësive që dalin gjatë hallkave të prodhimit. Vlerat numerike sipër kutive përfaqësojnë kostot dhe vlerën e shtuar për çdo fazë.

Figura 2. Diagram i zinxhirit të vlerës të BMA-ve



2.1 AKTORËT NË ZINXHIRIN E VLERËS

Sikurse shihet në diagramin më lart, zinxhiri i vlerës i BMA-ve në Malësi të Madhe është organizuar në këto nivele kyçe, konkretisht:

- Inputet
- Kultivimi
- Mbledhja dhe vjelja e bimëve të egra
- Proceset pas vjeljes (tharja ose distilimi)
- Tregu

Më poshtë vijon një përshkrim i shkurtër i secilit aktor në zinxhirin e vlerës dhe i agjencive mbështetëse në sistemin e tregut, që nga inputet deri tek shpërndarja në treg.

Furnizuesit e inputeve luajnë rol të rëndësishëm në zinxhirin e vlerës të BMA-ve. Ata sigurojnë farat, fidanët dhe plehrat për fermerët dhe shpesh shërbejnë si burime kyçe informacioni dhe udhëzimesh teknike.

Salvia Nord, me bazë në Koplik, ka kryer punë kërkimore dhe zhvillimore mbi bimët mjekësore dhe aromatike në zonën e Malësisë së Madhe për afërsisht dyzet vjet. Toka e thatë, alkaline dhe e pasur në gur gëlqeror e zonës, megjithëse jo e përshtatshme për shumë kultura tradicionale, përbën një mjedis ideal për këto specie vendase që kanë lulëzuar aty për mijëra vjet. Salvia Nord ka identifikuar dhe kultivuar varietete me cilësi dhe prodhimtari të lartë, duke bashkëpunuar me mbi 1.000 shqiptarë. Ajo furnizon çdo vit me miliona fidanë bimësh indigjene, përfshirë varietetin "Salvia Nord" të sherbelës, bimë makthi (aku) (Helichrysum italicum), livando hibride, trumzë, rigon i bardhë, shtog, dhe rozmarinë. Krahas kësaj, kompanitë e mëdha që merren me eksportin e BMA-ve u ofrojnë (shesin) fidanë fermerëve bazuar në nevojat e tregut për bimë të veçanta dhe sasi të caktuara të tyre. Administratori i MEIA sh.p.k, Emiland Skora, theksoi se kompania u ofron (shet) fidanë (bimë makthi, dafinë, trumzë, etj.), fermerëve të kontraktuar, sipas nevojave të kompanisë.

Agro Line është një furnizues i njohur i plehrave organike dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB) në Shqipëri, duke iu përgjigjur kërkesave gjithnjë në rritje për produkte bimore mjekësore dhe aromatike. Për përmbushjen e standardeve të certifikimit organik, është me rëndësi thelbësore të sigurohet që inputet, si plehrat dhe PMB-të, të jenë të miratuara për përdorim në bujqësi organike. Ka edhe një numër kompanish të tjera shqiptare që ofrojnë inpute bujqësore organike. Për shembull, AgroBlend ofron pesticide, plehra, fara dhe sisteme ujitëse të cilësisë së lartë, të gjitha të certifikuara sipas standardeve shëndetësore evropiane për bujqësinë. Krahas kësaj, burime të tjera si Portali i Fermerit,[25] ofrojnë informacion mbi produktet e miratuara për mbrojtjen e bimëve, që mund t'i ndihmojnë fermerët të zgjedhin inpute të përshtatshme për prodhim organik. Bashkëpunimi me furnizues me reputacion dhe konsultimi i burimeve zyrtare mund të ndihmojë që të sigurohet përmbushja e standardeve organike në kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike.

Furnizuesit e teknologjisë furnizojnë vegla dhe pajisje të rëndësishme për fazat e ndryshme të zinxhirit të vlerës të BMA-ve, si vjelja, trajtimi pas vjeljes, ruajtja, tharja, përpunimi dhe paketimi. Roli i tyre është kritik për përmirësimin e efikasitetit, ruajtjen e cilësisë së produktit dhe sigurimin e përmbushjes së standardeve të tregut.

GULIT sh.p.k është një kompani shqiptare e specializuar në prodhimin e produkteve të ambalazhit prej letre dhe polipropileni. Gama e produkteve të kompanisë përfshin qese dhe thasë prej letre, si dhe qese polipropeni që përdoren, ndër të tjera, për paketimin e prodhimeve ushqimore, ushqimeve për kafshë, dhe mallrave bujqësore. Këto produkte prodhohen me makineri të cilësisë së lartë dhe në përputhje me standardet e BE-së.
Real A&B është një kompani e specializuar për prodhimin e qepenave, dyerve automatike dhe serrave me energji diellore që prej vitit 1994. Vitet e fundit, kompania ka qenë një prej furnizuesve më kryesorë të tuneleve tharës me energji diellore për BMA-të, duke prodhuar disa modele tharës të mëdhenj e të vegjël, për të gjithë vendin. Për më shumë informacion për furnizuesit me teknologji dhe pajisje mund të gjendet në: https://acp.al/company-listing/

25. Shih: https://agroalbania.al/en/prodhimi.php

Kultivuesit: Kërkesa në rritje nga tregtia komerciale për një shumëllojshmëri të madhe speciesh të egra si sherbela, rigoni, bima e makthit (aku), dëllinja, trumza, dhe gentiana, ka rritur edhe ndërgjegjësimin për shfrytëzimin e tepruar të disa specieve. Tashmë kanë filluar përpjekjet për kultivim, dhe sipas disa llogaritjeve, numri i fermerëve që merren me kultivim është rreth 6.000. Pjesa më e madhe e fermave që kultivojnë BMA-të janë me madhësi deri në 1 ha, ndërsa më pak se 200 ferma kanë më shumë se 2 ha (AGT-DSA, 2021). Pjesa më e madhe e përpunimit të BMA-ve nga këto ferma konsiston në tharjen dhe ruajtjen e tyre në shtëpi, para se t'ua shesin grumbulluesve apo përpunuesve. Fermerët që kultivojnë sherbelë dhe lule makthi (aku) kanë përdorur material gjenetik të përshtatur (fara dhe fidanë) nga gjenotipat lokalë, ose nga bimë nënë, të marra nga popullata bimore natyrore, me qëllim që të ruhet cilësia e tyre (Ibraliu, 2018). Në Malësi të Madhe, me kultivimin e BMA-ve merren si fermerë të vegjël, ashtu edhe sipërmarrës të mëdhenj. Shumica e fermerëve, burra dhe gra, jetojnë në zona rurale dhe punojnë parcelat e tyre ku kultivojnë BMA-të. Këta fermerë ua shesin produktet e tyre të freskëta distiluesve, ose të thara kompanive të mëdha të grumbullimit dhe përpunimit. Përveç këtyre operacioneve në shkallë të vogël, në zonë ka edhe sipërmarrës dhe kompani të mëdha. Këto biznese e kanë zgjeruar veprimtarinë e tyre përmes blerjes ose marrjes me qira të parcelave të tokës, që u mundëson të shtojnë kapacitetet kultivuese. Kjo qasje e dyfishtë – me kombinim të fermave të vogla familjare me operacione më të mëdha, të industrializuara – ndihmon që të plotësohen kërkesat në rritje për BMA-të dhe mbështet ekonominë e zonës në Malësi të Madhe.

Malësia e Madhe zë vendin e parë në vend për kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike, me mbi 5.200 hektarë, të dedikuar kryesisht për sherbelë, livando, bimë makthi, etj., duke e bërë atë zonën me sipërfaqen më të madhe të kultivuar me BMA në vend. Në zonë ka më se 4000 fermerë që merren me BMA-të, ku mbi 50% e tyre janë gra.[26] Këta fshatarë merren kryesisht me kultivim, por marrin pjesë edhe në fazat e tjera të zinxhirit të vlerës, si vjelje, tharje dhe përpunim fillestar. Malësia e Madhe ka pozitë dominuese në kultivimin e BMA-ve: jo vetëm që shumica e kultivuesve janë në këtë zonë, por këtu gjenden edhe pothuaj të gjitha fermat që kultivojnë BMA-të me sipërfaqe mbi 1ha.[27] Gratë janë të përfshira në fazat e kultivimit, vjeljes dhe pasvjeljes, ndërsa vendimmarrja mbetet kryesisht në duart e burrave (pothuaj të gjithë pronarët në këtë sektor janë burra). Pjesa më e madhe e grave punojnë për këtë industri në mëngjes dhe kultivojnë parcelat e tyre (me madhësi 0,2–0,4 ha) pasdite.

Kultivimi shton mundësitë e grave për të punuar dhe fituar të ardhura në kushte më të mira se sa vjelja e BMA-ve të egra. Kalimi nga vjelja e bimëve të egra në kultivim ka forcuar rolet e grave në prodhim. Përfshirja në kultivimin e BMA-ve u mundëson grave të menaxhojnë njëkohësisht edhe përgjegjësitë familjare, sepse pjesa më e madhe e punës bëhet në parcela afër shtëpisë (GIZ, 2021). Në ferma të vogla kultivuese, gratë kryejnë punë të rënda fizike, si shkulja e barërave të këqija, vjelja, dhe proceset pasvjeljes, më shumë se burrat. Në fermat e mëdha, rolet e tyre përqendrohen në punë që kërkojnë përkulje të trupit dhe përqendrim, si mbjellja, prashitja dhe vjelja, ndërsa burrat përgjithësisht merren me punë që kërkojnë forcë fizike, si heqja e gurëve, transplantimi, dhe transporti. Përveç kësaj, gratë shpesh mbikëqyrin dhe monitorojnë punën e grave të tjera në fermat e mëdha.

Në disa raste punësohen administratore gra për të menaxhuar punën me mëditje, që është e konsiderueshme. Grupe ose brigada punëtoresh shpesh menaxhohen nga palë të kontraktuara, që mbikëqyrin rekrutimin dhe transportin (GIZ, 2021). Duke marrë parasysh angazhimin e tyre, sidomos në fazat e pasvjeljes dhe të përpunimit ku përqendrohet një pjesë e mirë e punës me mëditje, shihet qartë që kontributi i grave në punën me mëditje është më i lartë. Mbjellja bëhet gjatë pranverës, ku pjesa më e madhe e materialit shumëzues të përbërë nga bimët e vetë fermerëve, dhe vetëm një pjesë e vogël bëhet me fidanë të blerë. Shumëzimi i bimëve kërkon përpjekje të përbashkëta: burrat zakonisht mbajnë fidanët, ndërsa gratë i mbjellin. Kërkohet punë si për mirëmbajtje ashtu edhe për vjelje, sepse prania e dendur e gurëve në sipërfaqen e tokës nuk lejon

26. Konstatime nga intervistat me aktorët e ZV-së, grupet e interesit dhe specialistët.

27. *"Banorët e Malësisë së Madhe nuk zbatuan ligjin 7501 dhe u kthyen në kufijtë e vjetër që kanë pasur të parët e tyre dikur dhe, si rrjedhim, toka u shpërnda mbi bazën e atyre pretendimeve. Vërehet se 97% e banorëve të Malësisë së Madhe morën toka në kufijtë e vjetër. Ndërkohë, vetëm 30% e banorëve morën tokë (sipas kufijve të vjetër) që ishte më pak se norma për frymë e përcaktuar për këtë zonë. Si rrjedhim, 70% e banorëve kanë marrë shumë më tepër tokë se norma e përcaktuar për frymë".* Çështje Gjinore të Pronësisë mbi Tokën në Zonën e Malësisë së Madhe. Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) dhe OXFAM Italia (OIT). Shih: https://www.qag-al.org/publikime/ceshtjet_gjinore_pronesise.pdf

përdorimin e mjeteve të mekanizuara, gjë që e bën procesin mjaft të rëndë fizikisht. Në nivel ferme, punët pas vjeljes menaxhohen nga gratë, të cilat pastrojnë bimët dhe i hapin për t'u tharë mbi mbulesa të thjeshta që i vënë në diell, në tarraca, veranda, ballkone, ose nën çati.

Gratë përfshihen mjaft edhe në përpunimin që kryhet në fermë ose nëpër depo. Në depo, gratë bëjnë tharjen e produktit që e nxjerrin nga thasët; pastrojnë produktin e tharë; pastrojnë produktin e grirë; dhe bëjnë paketimin në thasë letre, ose të patrajtuar kimikate. Burrat bartin thasët e rëndë dhe operojnë makineritë e transportit dhe të ngarkim-shkarkimit. Prerja dhe grirja drejtohet nga burrat, të cilët dinë të përdorin dhe të riparojnë pajisjet, ndërsa gratë ndihmojnë me menaxhimin e mbeturinave dhe përzgjedhjen e produktit. Paketimi dhe etiketimi bëhet nga gratë, dhe inventari shpesh menaxhohet bashkërisht me ekipin menaxhues.[28]

Mbledhësit (vjelësit) e bimëve të egra. Familjet dhe banorët (gra dhe burra) në zonat malore dhe komunitetet që jetojnë në zonat pyjore-baritore janë mbledhësit kryesorë të BMA-ve të egra, të cilëve u bashkohen edhe një numër i kufizuar familjesh nga zonat urbane, sidomos gjatë sezonit të vjeljes. Ato i thajnë dhe ruajnë bimët nëpër shtëpitë e tyre, deri sa ua shesin grumbulluesve ose përpunuesve të zonës. Përllogaritje të mëparshme kanë treguar se në këtë veprimtari marrin pjesë rreth 100.000 persona ose 20.000 familje fermere (Imami dhe të tjerë, 2015). Megjithatë, shifrat kanë rënë në mënyrë drastike për shkak të tendencave demografike, por nuk ka të dhëna të disponueshme të kohëve të fundit.

Në Malësi të Madhe, vjelësit e zonës mbledhin bimë mjekësore dhe aromatike të egra nga peizazhet e shumëllojshme malore në rajon. Këto bimë, ndër të cilat sherbela, trumza dhe rigoni i kuq, mblidhen në mënyrë sezonale dhe puna e vjelësve zakonisht kryhet në zona të thella. Vjelësit kryejnë punë sezonale dhe puna e tyre plotëson BMA-të e kultivuara nga fshatarët e zonës. Shumë prej këtyre bimëve të egra mblidhen

Në zonë ka më se 4000 fermerë që merren me BMAtë, ku mbi 50% e tyre janë gra.

gjatë periudhave të caktuara të vitit, kur janë edhe më të bollshme. Bimët e mbledhura pastaj i shiten grumbulluesve vendorë, tregtuesve, ose kompanive përpunuese, të cilat i shtojnë vlerë lëndës së parë përmes përpunimit të mëtejshëm ose distilimit. Në Malësi të Madhe, mbledhja e BMA-ve të egra u ofron gjithashtu komuniteteve rurale, veçanërisht grave dhe grupeve të tjera vulnerabël, mundësi shtesë për fitimin e të ardhurave. Metodat e qëndrueshme të janë shumë të rëndësishme që këto bimë të vlefshme të vazhdojnë të lulëzojnë në natyrë, duke kontribuar në ruajtjen e mjedisit dhe fitimin e jetesës nga vjelësit vendorë.

Konsoliduesit vendorë (150)[29] janë magazina ose kompani që veprojnë në zonë dhe që shërbejnë si ndërmjetës midis vjelësve dhe kultivuesve të bimëve të egra dhe përpunuesve në nivel rajoni. Ata luajnë një rol të rëndësishëm në zinxhirin e vlerës duke u dhënë vjelësve informacion për çmimet dhe shërbejnë si ndërmjetës kyçë midis kultivuesve dhe përpunuesve më të mëdhenj.

Konsoliduesit rajonalë (10)[30] janë të vendosur në rrethe të ndryshme dhe blejnë BMA-të nga grumbulluesit lokalë dhe/ose ambulantë. Këta grumbullues luajnë rol kyç në zinxhirin furnizues, duke shërbyer si urë lidhëse midis grumbulluesve vendorë dhe përpunuesve ose eksportuesve të mëdhenj.

Përpunuesit e vegjël tregtojnë mesatarisht 150 deri 500 ton BMA në vit. Ata zakonisht kryejnë aktivitete përpunimi dhe paketimi të thjeshtë, me fokus furnizimin

28. *The Role of Women In Assuring Quality - Empowering women in the Medicinal dhe Aromatic Plants (MAPs) Sector* (Roli i grave në sigurimin e cilësisë – Fuqizimi i grave në sektorin e bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA) DSA 2024. Shih: https://hub.unido.org/sites/default/files/publications/Gender%20Report%20brochure%20WEB.pdf.

29. Biofach 2024. AIDA. Shih: https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/BIOFACH-24-broshure-1.pdf

30. Po aty.

e tregut të brendshëm me produkte si çaji i malit dhe erëza të tjera për gatim. Në ndonjë rast, këto kompani arrijnë t'ua shesin produktet e tyre blerësve ndërkombëtarë.

Përpunuesit e mesëm kanë kapacitet midis 500 dhe 1.000 ton BMA në vit. Në këto kategori bëjnë pjesë rreth 31 kompani, që kanë krijuar lidhje të rregullta eksporti me blerësi ndërkombëtarë. Këto kompani konkurrojnë me njëra tjetrën për mbledhjen dhe marrjen e BMA-ve nga kultivuesit vendorë.[31]

Përpunuesit/eksportuesit e mëdhenj (15) përpunojnë mesatarisht 1.000 deri 1.800 ton bimë mjekësore dhe aromatike në vit. Kjo përbën një pjesë të konsiderueshme të eksporteve të BMA-ve nga Shqipëria. Ata i marrin produktet nga të gjitha nivelet e zinxhirit furnizues, përfshirë nga kultivues të mëdhenj, konsolidues, dhe nga përpunues të vegjël e të mesëm. Këta përpunues/eksportues janë të pajisur me linjat më të avancuara të përpunimit, që u bën të mundur të përmbushin standardet ndërkombëtare dhe t'u shërbejnë me efektivitet tregjeve botërore.[32]

Pjesa më e madhe e konsoliduesve, përpunuesve dhe eksportuesve ose janë të vendosur në Malësi të Madhe, ose kanë marrëdhënie të ngushta me fermerët e zonës. Eksportuesit dhe përpunuesit më të mëdhenj, si Relikaj, Muçaj, dhe MEIA (e vetmja kompani që fokusohet vetëm në prodhimin e vajrave esenciale) janë të përqendruara në Malësi të Madhe.
Përveç këtyre, edhe kompani të tjera të mëdha në zona të ndryshme të Shqipërisë, si AlbKalustyan, Filipi & Co, dhe Gjedra, marrin sasi të konsiderueshme lënde të parë të sherbelës nga Malësia e Madhe, ose drejtpërdrejt nga fermerët, ose përmes konsoliduesve vendorë.

Tregu me pakicë

Tregu është i orientuar nga eksporti – vetëm një pjesë e vogël shkon për furnizimin e supermarketeve të vendit, tregjeve të gjelbër dhe sektorit të mikpritjes dhe restaurimit. Një numër i vogël kompanish dhe disa grupe prodhuese shesin një gamë të gjerë erëzash të paketuara (p.sh. Natyral dhe ATC), infuzione çajesh (p.sh Craco) dhe një numër të kufizuar vajrash esenciale (kryesisht eksportuesit e mëdhenj, por edhe përpunuesit e vegjël). Ndonëse destinacioni kryesor për BMA-të janë tregjet e eksportit, kërkesat janë në rritje edhe në tregun e brendshëm. BMA-të e freskëta ose të përpunuara, që përdoren kryesisht për infuzione çajesh dhe si erëza, shihen edhe në dyqane të ndryshme shitjeje me pakicë.

Me konsolidimin e sektorit të shitjes me pakicë, këto produkte po shiten gjithnjë e më shumë nëpër supermarkete. Janë një numër supermarketesh që shesin BMA me të cilat furnizohen nga përpunuesit vendorë. Megjithatë, dyqanet e ushqimeve, farmacitë, restorantet dhe dyqanet e specializuara vazhdojnë të jenë pika shitjeje relevante për kompanitë e përpunimit ushqimor. Në këtë kontekst, vlen të përmenden Neranxi dhe Merja, që operojnë një varg pikash shitjeje me pakicë. Disa varietete të BMA-ve shiten në tregjet e frutave dhe perimeve të freskëta.[33]

Në njësinë administrative të Reçit, disa nga gratë anëtare të kooperativës Agro Reçi, kanë filluar të bëjnë paketim në shkallë të vogël të BMA-ve, me etiketa të thjeshta (informale), për panaire tregtare dhe për klientët që vijnë drejtpërdrejt në qendrën e tyre. Përfaqësuesi i kooperativës është i gatshëm t'i mbështesë gratë nëse paraqitet mundësia për krijimin e një njësie të vogël përpunimi brenda qendrës.

Salvia Nord, një biznes familjar në Koplik, i fokusuar kryesisht në furnizimin me fidanë, kohët e fundit ka filluar të bëjë paketim në shkallë të vogël të erëzave dhe vajrave esenciale. Biznesi operon kryesisht me kontakte direkte me klientët, përmes panaireve dhe pikave të shitjes.[34]

31. Të dhëna të konsoliduara nga Biofach 2024. AIDA. Shih: https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/BIOFACH-24-broshure-1.pdf, Studim për sektorin e bimëve mjekësore dhe aromatike. MBZHR dhe GIZ, 2021. Shih: https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/04-MAP-Sector-Study_FINAL.pdf, dhe MEDICINAL AND AROMATIC PLANTS SECTOR STUDY. AASF, 2023. Shih: https://aatsf.com.al/wp-content/uploads/2020/04/4Mapcover-EN.pdf

32. Po aty.

33. *Quality dhe standards for sustainable trade of Medicinal dhe Aromatic Plants* (Cilësia dhe standardet për tregti të qëndrueshme të bimëve mjekësore dhe aromatike). GQSP. UNIDO, 2023. Shih: https://hub.unido.org/sites/default/files/publications/UNIDO%20GQSP%20ALBANIA%20Medicinal%20Aromatic%20Plants%20Value%20Chain%20STUDY%202023.pdf

34. Shih: https://www.salvianord.com/

2.2 SHËRBIMET E MBËSHTETJES DHE KONTROLLIT

Janë katër Agjenci Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB),[35] me qendër në Shkodër, Lushnjë, Korçë, dhe Tiranë, të cilat operojnë nën Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 13.03.2018, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor." Këto agjenci rajonale synojnë të bëhen aktore kyçe në zhvillimin e një sektori konkurrues dhe të qëndrueshëm bujqësor në vend, duke punuar në partneritete afatgjata me përfituesit. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të tyre përfshijnë:

- të ofrojnë informacion dhe këshillim për zhvillimin teknik e teknologjik të fermave bujqësore, me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë në bujqësi;
- të ofrojnë informacion dhe të asistojnë fermerët për të përfituar nga skemat mbështetëse kombëtare, IPARD-i dhe projekte të tjera në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural;
- të nxisin dhe të ndihmojnë krijimin e funksionimin e formave të ndryshme të kooperimit të fermerëve;
- të organizojnë dhe të kryejnë trajnimin profesional të fermerëve në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural;
- të sigurojnë informacion për standardet lidhur me mjedisin, cilësinë, marketingun, bujqësinë organike, produktet me tregues gjeografikë;
- të informojnë dhe të këshillojnë fermerët për përzgjedhjen dhe përdorimin e makinerive e të pajisjeve bujqësore, duke ofruar asistencë teknike pa pagesë.

Zyra vendore e AREB-it në Malësi të Madhe përbëhet nga dhjetë punonjës të ekstensionit bujqësor (tri gra dhe shtatë burra).

Pesë Qendrat e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore (QTTB)[36] të vendosura në Fushë-Krujë, Shkodër, Vlorë, Lushnjë, dhe Korçë, u krijuan me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 515, datë 19.07.2006, «Për ristrukturimin e instituteve kërkimore-shkencore, në varësi të ministrisë së bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit.» Ndër to, QTTB Lushnjë është posaçërisht e fokusuar në perimet. Përgjegjësitë kryesore të QTTB-ve përfshijnë:

- identifikimin, testimin, përshtatjen dhe futjen, në praktikat bujqësore, të metodave dhe materialeve (inputeve) të reja;
- përgatitjen e paketave teknologjike për kulturat bujqësore kryesore dhe mbarështimin e bagëtive;
- kërkime dhe testime në ferma bujqësore për problemet e ngritura nga fermerët e rajoneve përkatëse;
- trajnime për specialistë të bujqësisë, fermerë, studentë të shkencave bujqësore dhe subjekte të tjera të interesuara;
- sigurimin e ekspertizës teknike për strukturat e shërbimit këshillimor dhe fermerët;
- demonstrimin e teknologjive të reja të kultivimit të kulturave bujqësore dhe mbarështimit të blegtorisë;
- përgatitjen dhe publikimin e materialeve informuese për specialistët e bujqësisë dhe fermerët;
- mbështetjen e hartimit të politikave nga Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural në fushën e bujqësisë, ushqimit, mbrojtjes së konsumatorit dhe zhvillimit rural.

Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB)[37] është përgjegjës për garantimin e shëndetit dhe sigurisë së kafshëve, bimëve dhe prodhimeve bujqësore në Shqipëri. Ai operon në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe luan

35. Shih: https://bujqesia.gov.al/drejtorite-e-bujqesise/, dhe https://www.bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/06/2.1-struktura-AREB-TIRANE.doc
36. Shih: https://bujqesia.gov.al/qendrat-e-transferimit-te-teknologjive-bujqesore-qttb/
37. Shih: https://akvmb.gov.al/

rol kyç në mbrojtjen e shëndetit të publikut, promovimin e qëndrueshmërisë bujqësore dhe lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare të prodhimeve bujqësore dhe ushqimore. Ndër përgjegjësitë kryesore të AKVMB-së përfshihen:

- **Shërbimet veterinare:** Monitorimi dhe kontrollimi i shëndetit të kafshëve, parandalimi i përhapjes së sëmundjeve ngjitëse, dhe garantimi i sigurisë ushqimore në produktet me prejardhje shtazore.
- **Mbrojtja e bimëve:** Zbatimi i masave fitosanitare për parandalimin dhe kontrollimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve që mund të dëmtojnë prodhimin bujqësor.
- **Roli rregullator për pesticidet dhe plehrat:** Mbikëqyrja e importit, shpërndarjes, dhe përdorimit të pesticideve dhe plehrave, duke siguruar përmbushjen e standardeve të sigurisë.
- **Siguria ushqimore dhe inspektimi:** Kryerja e inspektimeve të fermave, mjediseve të përpunimit ushqimor, dhe tregjeve, për të siguruar që produktet përmbushin standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë ushqimore.
- **Kontrolli kufitar dhe biosiguria:** Menaxhimi i inspektimeve kufitare veterinare dhe fitosanitare për parandalimin e hyrjes së dëmtuesve, sëmundjeve dhe produkteve të pasigurta ushqimore në vend.
- **Legjislacioni dhe zbatimi i ligjit:** Hartimi dhe zbatimi i ligjeve, politikave dhe rregulloreve që lidhen me shërbimet veterinare dhe mbrojtjen e bimëve.
- **Ndërtimi i kapaciteteve dhe trajnimet:** Ofrimi i trajnimeve dhe mbështetjes për fermerët, veterinerët dhe specialistët bujqësorë për përmirësimin e praktikave më të mira në menaxhimin e shëndetit të bimëve dhe të kafshëve.

AKVMB-ja e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe është organizuar në nivel qendror nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme dhe në nivel rajonal, nëpërmjet katër drejtorive rajonale të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve në Elbasan, Vlorë, Shkodër, dhe Tiranë. Drejtoritë rajonale veprojnë brenda fushave të tyre të përgjegjësisë dhe kryejnë këto detyra:

- vlerësojnë nevojat dhe problematikat që lidhen me shërbimet veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve, dhe i propozojnë zgjidhje Drejtorisë së Përgjithshme;
- planifikojnë nevojat për shërbime veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve dhe ia paraqesin ato Drejtorisë së Përgjithshme;
- koordinojnë dhe monitorojnë ofrimin e shërbimeve veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve në territorin e tyre;
- përgatisin raporte për marrjen e kampioneve, materialeve patologjike dhe rezultateve të analizave për sëmundje të dyshuara dhe konfirmuara;
- hartojnë raporte periodike për shkallën e infeksionit të bimëve dhe statusin e produkteve bimore;
- detajojnë dhe zbatojnë planet e punës të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- lëshojnë dokumente dhe certifikata sipas dispozitave ligjore, akteve nënligjore dhe autorizimeve të Drejtorisë së Përgjithshme;
- kryejnë detyra të tjera të ngarkuara sipas ligjit ose sipas urdhrave të Drejtorisë së Përgjithshme.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)[38] është një institucion shtetëror në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përgjegjës për inspektime dhe menaxhim në fushat e mbrojtjes së konsumatorit, mbrojtjes së bimëve dhe mbarështimit të kafshëve. AKU funksionon sipas Ligjit nr. 10433, datë 16.06 2011, «Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë», konkretisht neni 7, «Parimi i programit të inspektimeve». Koha e kryerjes së inspektimeve përcaktohet në programin vjetor të inspektimeve, por kryhen edhe inspektime rastësore kur kërkohet nga ligji. Neni 4 i të njëjtit ligj përcakton qëllimet e inspektimeve, ku përfshihen: i) vlerësimi i respektimit të kërkesave ligjore; ii) dokumentimi i praktikave të mira në respektimin e kërkesave ligjore; iii) këshillimi i subjektit të inspektuar për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore; iv) urdhërimi i korrigjimit të shkeljeve ligjore dhe eliminimit të pasojave të tyre; dhe, v) dhënia e dënimeve dhe marrja me masave administrative për shmangien

38. Shih: https://aku.gov.al/

e rreziqeve ndaj interesit publik. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) në Shqipëri është organi rregullator përgjegjës për garantimin e sigurisë dhe cilësisë ushqimore dhe respektimin e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare. AKU mbikëqyr të gjithë hallkat e furnizimit ushqimor, që nga prodhimi dhe përpunimi, deri tek shpërndarja dhe konsumi, dhe synon mbrojtjen e shëndetit publik dhe sigurisë së ushqimeve. Detyrat kryesore të tij përfshijnë:

- mbikëqyrjen dhe inspektimin e prodhimit, përpunimit të ushqimit dhe të mjediseve të shpërndarjes;
- garantimin e respektimit të rregulloreve dhe standardeve të sigurisë ushqimore;
- kryerjen e kontrolleve të cilësisë së ushqimeve dhe testimeve për të parandaluar kontaminimin dhe garantuar sigurinë e ushqimeve;
- zbatimin e ligjeve për sigurinë ushqimore dhe të rregulloreve të vendosura nga qeveria;
- koordinimin me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare për harmonizimin e praktikave të sigurisë ushqimore;
- udhëzimin dhe trajnimin e bizneseve dhe palëve të interesit në industrinë ushqimore në lidhje me praktikat më të mira;
- lëshimin e certifikatave dhe miratimeve për prodhime ushqimore, sipas ligjit.

Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (ESHFF),[39] me seli në Tiranë, është institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ai financohet nga buxheti i shtetit dhe ka si objekt të punës së tij zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 10416, datë 07.04.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor" si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij. Misioni i ESHFF-së përfshin:

- mbrojtjen e interesave të fermerëve;
- shtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;
- prezantimin e varieteteve të reja në treg;
- përmirësimin e treguesve të cilësisë të materialit mbjellës që tregtohet;
- sigurimi i një konkurrence të ndershme në treg.

Institucioni monitoron rrjetin zonal për prova krahasuese për testimin e varieteteve të reja të prodhuara në vend ose të importuara, për riprodhim, shumëzim e tregtim. Mbi bazën e rezultateve të këtyre provave krahasuese dhe metodave laboratorike, ESHFF-ja bën vlerësimin dhe regjistrimin e varieteteve në Katalogun Kombëtar.

Certifikimi Standardet bazë janë **Analiza e Rreziqeve dhe Pikat Kritike të Kontrollit (HACCP) dhe Certifikimi Organik. HACCP**[40] është një standard ndërkombëtar që bazohet në parimet e *FAO/WHO Codex Alimentarius Commission* (Komisioni *Codex Alimentarius* i FAO-s dhe OBSH-së), dhe përfshin një grup të plotë parimesh mbi higjienën dhe sigurinë ushqimore. Ai është një sistem parandalues për menaxhimin e sigurisë ushqimore, që është i detyrueshëm për të gjitha bizneset ushqimore, në përputhje me Rregulloret Evropiane (EC) 178/2002[41] dhe 852/2004,[42] si dhe me Udhëzimin Kombëtar nr. 20 20, datë 25.11.2010, të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.[43] Procesi i certifikimit HACCP zakonisht zgjat nga 14 deri 30 ditë, në varësi të kërkesave konkrete të biznesit përkatës, dhe përfshin:

- **Vizitë tek biznesi:** Biznesi vizitohet nga një kompani konsulente e specializuar për të vlerësuar proceset e punës dhe për të dhënë rekomandime për përmirësime dhe përshtatje për plotësimin e standardeve të HACCP-së.
- **Përgatitja e dokumentacionit:** Biznesi duhet të përgatisë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, ku përfshihen evidenca, procedura dhe plane që lidhen me sigurinë dhe higjienën ushqimore.
- **Krijimi i sistemeve për mbajtjen e dokumentacionit:** Duhet të ngrihet një sistem për mbajtjen e dokumentacionit dhe të dhënave, për të garantuar që procedurat e sigurisë ushqimore të jenë të dokumentuara siç duhet dhe të gjurmueshme.
- **Inspektimi nga organi certifikues:** Organi certifikues inspekton biznesin për të siguruar plotësimin e të gjitha kritereve të HACCP-së dhe kontrollon si dokumentacionin, ashtu edhe praktikat e ndjekura.
- **Lëshimi i certifikatës:** Pas inspektimit të suksesshëm, trupa certifikuese lëshon certifikatën HACCP, që konfirmon se biznesi përmbush standardet e sigurisë ushqimore.

39. Shih: http://www.eshff.gov.al/
40. Shih: https://aku.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Udhezim_Nr.20.pdf
41. Shih: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32002R0178
42. Shih: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32004R0852
43. Shih: https://faolex.fao.org/docs/pdf/alb144203.pdf

Certifikimi organik është një proces i gjatë, por me vlerë, sepse jep akses në tregjet globale dhe u mundëson bizneseve t'i marketojnë produktet e tyre si organike, me çmime më të larta dhe kërkesë më të madhe. Ky është një proces që siguron që produktet të prodhohen sipas standardeve specifike të bujqësisë organike, që fokusohet në qëndrueshmërinë dhe ruajtjen e mjedisit, dhe përjashtimin e kimikateve sintetike dhe organizmave të modifikuara gjenetikisht (OMGJ). Certifikimi kërkohet për bizneset që dëshirojnë t'i reklamojnë dhe shesin produktet e tyre si 'organike', sidomos në tregjet ndërkombëtare. Parlamenti i Shqipërisë ka miratuar kohët e fundit Ligjin nr. 104/2024 "Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre".[44] Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i parimeve dhe i rregullave për prodhimin organik, certifikimin dhe përdorimin e treguesve që i referohen prodhimit organik në etiketim dhe reklamim. Ai gjithashtu përcakton rregullat për kontrollin zyrtar, përveç sa parashikohet në legjislacionin në fuqi për kontrollet zyrtare. Fazat kyçe për certifikimin organik janë:

- **Aplikimi fillestar:** Biznesi dorëzon aplikimin në organin e akreditуar të certifikimit organik.
- **Inspektimi i fermës ose operatorit:** Kryhet një inspektim në terren nga trupa certifikuese për të siguruar respektimin e standardeve të bujqësisë organike dhe të përpunimit organik. Ky inspektim përfshin kontrollin e dokumenteve, metodave të prodhimit dhe praktikave mjedisore.
- **Mbajtja e dokumentacionit dhe e të dhënave:** Bizneset duhet të mbajnë dokumentacion të hollësishëm të praktikave të tyre bujqësore (plehrat, pesticidet, etj.) rotacionin e kulturave bujqësore, menaxhimin e tokës dhe praktika të tjera përkatëse. Ky dokumentacion ndihmon garantimin e transparencës dhe gjurmueshmërisë.
- **Rishikimi i praktikave dhe procedurave:** Trupa certifikuese shqyrton praktikat e biznesit dhe i krahason ato me standardet organike. Kjo përfshin garantimin e mospërdorimit të substancave të ndaluara (si kimikate sintetike apo OMGJ) dhe që metodat e prodhimit mbështesin ruajtjen afatgjatë të një mjedisi të shëndetshëm.
- **Vendimi i certifikimit:** Pas inspektimit dhe shqyrtimit, trupa certifikuese merr një vendim. Në qoftë se biznesi konstatohet se i përmbush standardet organike, ai merr certifikatën organike.
- **Inspektime në vijimësi:** Certifikimi organik kërkon inspektime dhe auditime të përvitshme për vazhdimin e certifikimit. Bizneset duhet të vazhdojnë t'u përmbahen standardeve dhe çdo ndryshim në praktika duhet të dokumentohet dhe miratohet.

Procesi i certifikimit zakonisht zgjat 2-3 vjet, sepse bizneset duhet të tregojnë se u janë përmbajtur praktikave organike për të paktën atë periudhë. Gjatë kësaj kohe, bizneseve u jepet statusi i ndërmjetëm "në proces certifikimi organik."Operatorët më të mëdhenj të eksportit të BMA-ve janë të certifikuar sipas Standardit Organik Evropian dhe Standardit Organik të SHBA-së (që përfaqësojnë tregjet kryesore për BMA-të shqiptare). Certifikimi organik kryhet nga disa organe certifikuese: Ecocert SA, ICEA, BCS, OkoGarantie GmbH, BioInspecta AG, CERES GmbH, Control Union Certifications B.V., IMO CH, IMC srl. Historikisht, i vetmi organ vendor i certifikimin në Shqipëri ka qenë Bio-inspecta (më parë Alb-inspect), që është akreditуar nga shërbimet akredituese zvicerane.[45]

Shoqatat Ka vetëm dy shoqata kryesore: Shoqata e Kultivuesve të Bimëve Mjekësore dhe e Prodhuesve të Esencave Eterovajore (EPCA) dhe Shoqata e Bimëve Mjekësore dhe Aromatike e Shqipërisë (ABMA). Nuk ka ndonjë shoqatë të prodhuesve të BMA-ve që të mbrojë interesat e tyre dhe të aktorëve të tjerë në zinxhirin e vlerës të BMA-ve në shkallë kombëtare. E vetmja organizatë në nivel kombëtar është KASH (Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar), që është një organizatë/federatë ombrellë që mbulon të gjithë sektorët kryesorë agroushqimorë në Shqipëri, ndër të cilët edhe BMA-të. Pjesa më e madhe e aktorëve (vjelësit/rritësit, grumbulluesit/konsoliduesit dhe përpunuesit/eksportuesit) nuk janë të angazhuar në ndonjë prej shoqatave (DSA, 2023). Mungesa e pjesëmarrjes së gjerë ka çuar në mundësi të humbura për promovimin e praktikave të mira bujqësore për kultivimin dhe mbledhjen e BMA-ve dhe për kontrollin e sigurisë ushqimore.

44. Ky ligj është pjesërisht i harmonizuar me Rregulloren e BE-së nr. 2018/848 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 30 maj 2018, mbi prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike, që shfuqizoi Rregulloren e Këshillit nr. 834/2007. Për më shumë shih: https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2024/09/ligj-nr.-104-dt.-19.9.2024-prodhimi-organik.docx

45. *Quality and standards for sustainable trade of Medicinal dhe Aromatic Plants* (Cilësia dhe standardet për tregti të qëndrueshme të bimëve mjekësore dhe aromatike). GQSP. UNIDO, 2023. Shih: https://hub.unido.org/sites/default/files/publications/UNIDO%20GQSP%20ALBANIA%20Medicinal%20Aromatic%20Plants%20Value%20Chain%20STUDY%202023.pdf

2.3 KONSTATIMET E STUDIMIT

Bazuar në punën në terren, vrojtimet, dhe intervistat e kryera me aktorë kyç në zinxhirin e vlerës (48 gra dhe 7 burra), ku përfshihen edhe prodhues dhe përpunues, si dhe specialistë të zinxhirit të vlerës të BMA-ve, u identifikuan të dhënat e mëposhtme:

Mundësitë:

- Rritja e kërkesës për BMA në të gjithë vendin. Ka pasur një rritje të ndjeshme të kërkesës për BMA në zonë dhe në të gjithë vendin, e nxitur nga kërkesa në treg. Kjo është e lidhur drejtpërdrejt edhe me shumëllojshmërinë e madhe të produkteve të disponueshme, si edhe me periudhën pas Kovid-19, si dhe me kërkesën në rritje nga tregjet ndërkombëtare.

- MEIA Sh.p.k., kompania më e madhe që merret me distilimin e vajrave esenciale, është shumë e gatshme të bashkëpunojë për futjen e bimëve të reja dhe me vlerë të lartë në treg, si trumza *(Satureja montana),* në bashkëpunim me gratë. Si gratë, ashtu edhe kompania janë të interesuar në këto bimë të përhershme dhe me një vjelje, që do t'u mundësonte grave të ofronin shërbimet e tyre në këtë industri dhe në të njëjtën kohë të kultivonin parcelat e tyre për të ardhura shtesë.

- Kultivimi në bazë të praktikave më të mira bujqësore shton sasitë e prodhimit dhe siguron cilësinë në përputhje me kërkesat e tregut ndërkombëtar.
  - Gratë mund t'i shtojnë të ardhurat dhe të përmirësojnë kushtet e punës. Kjo do të kërkonte investime, që nga farat/fidanët deri tek trajnimet për praktikat e mira bujqësore.

- Përmbushja e kritereve të standardeve dhe marrja e certifikatave të cilësisë do të kontribuonte drejtpërdrejt në përmirësimin e procesit dhe rritjen e vlerës së produkteve, që do të çojë në rritjen e kërkesës produkte të BMA-ve, në rritjen e çmimeve, dhe rritjen e të ardhurave për njësi.[46]
  - Gratë në këtë ZV sugjeruan nevojën për më shumë njohuri, sidomos për zbatimin e standardeve, certifikim dhe zbatimin e praktikave më të mira në të gjitha fazat e kultivimit.
  - Vëmendje duhet t'u kushtohet proceseve të tharjes dhe të përpunimit fillestar, ku, sipas konsoliduesve vendorë, është edhe mundësia më e madhe për kontaminim dhe humbje të cilësisë.

- Organizimi në grupe i fermerëve, sidomos i grave, ul kostot për sigurimin e inputeve, mundëson përdorimin e përbashkët të pajisjeve dhe ul kostot e tregut; unifikon dhe garanton cilësinë e produktit; mundëson rritjen e kapaciteteve të aktorëve në të gjithë hallkat e zinxhirit të vlerës dhe rrit rolin e tyre në zinxhirin e vlerës.

- Mundësitë për zgjerimin e përpunimit të vogël të BMA-ve në grupin e grave të Agro Reçit, me përdorues fundor tregun vendor.

- Mundësia e zbatimit të praktikave të mira bujqësore në kultivimin e BMA-ve:
  - Përmirësimi i kushteve të punës të grave të angazhuara në ZV të BMA-ve.
  - Të gjitha punëtoret duhet të trajnohen, sidomos për menaxhimin e kimikateve bujqësore/plehrave, higjienë dhe ndihmë të parë.
  - Pajisje mbrojtëse personale, mbi të gjitha gjatë përdorimit të kimikateve bujqësore.
  - PMB në kultivim (historia e parcelës; inspektimi; analiza e dheut; rreziku i kontaminimit; përgatitja e fushës; fara/fidanë të certifikuar; mbjellja dhe transplantimi; plehrat organike dhe kimike; ujitja; kujdesi për bimët dhe mbrojtja e bimëve; proceset e vjeljes dhe pasvjeljes (përpunimi fillestar dhe tharja); paketimi; magazinimi dhe transporti; etj.)

46. *"Megjithëse një pjesë e vëllimit të eksportuar është 'konvencional', që do të thotë se nuk i përmbahet standardeve të rrepta (p.sh. të certifikimit dhe gjurmueshmërisë), një pjesë gjithmonë e më e madhe e sasisë që shitet jashtë vendit është e certifikuar dhe e gjurmueshme. Të gjithë eksportuesit thonë se certifikimi: i) minimizon pengesat ndaj tregtimit, dhe ii) shton vlerë të shtuar (p.sh., disa produkte organike kanë çmim 30% deri në 100% më të lartë)".* Studim i sektorit të bimëve mjekësore dhe aromatike, MBZHR dhe GIZ, 2021. Shih: https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/04-MAP-Sector-Study_FINAL.pdf

Kufizimet:

- Shumica e aktiviteteve janë informale, që do të thotë se punëtorët dhe prodhuesit (sidomos gratë) shpesh nuk janë të regjistruar në zyrat ose autoritetet tatimore. Si rezultat, ato humbin të drejtën të përfitojnë nga skemat e subvencioneve, të sigurimeve shëndetësore, pensioneve dhe nga programe dhe projekte të ndryshme.

- Ka pasur disa raste mossuksesi, kur fermerët e vegjël kishin kultivuar bimë pa pasur marrëveshje paraprake me kompanitë, që çoi në çmime shitjeje aq të ulët sa që vjelja e bimëve të kultivuara nuk ishte më me interes. Në raste të tjera, përdorimi i fidanëve të prodhuar në zonë çoi në humbjen e bimëve në vitin e dytë dhe pamundësi financiare për rimbjelljen e bimëve.

- Sipas fermerëve, faza e inputeve ka koston më të lartë financiare.

- Përfshirja në këtë aktivitet është shpesh burimi parësor i të ardhurave për shumicën e familjeve. Për shkak të informalitetit ose mungesës të së drejtës së pronësisë mbi tokën, banorët, sidomos gratë fermere, përjashtohen nga skemat e subvencioneve dhe mundësitë financiare,.

- Cilësia e ulët, që çon në çmime të ulëta. Mungesa e aftësive profesionale dhe e certifikimit të cilësisë ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e produkteve, sidomos në rastin e grave. Ka raste certifikimi organik për grupe fermerësh, kryesisht të mundësuara nga projekte ose kompani, por kjo praktikë ende nuk është e përhapur për shkak të kostove përkatëse dhe mungesës së informacionit.

- Mungesa e interesit të të rinjve për të punuar në bujqësi, së bashku me shkallën e lartë të migracionit, kufizojnë numrin e forcave të punës.

Më poshtë vijon një listë e problemeve kryesore të identifikuara në kultivimin e BMA-ve në Malësi të Madhe. Më konkretisht, problemet (kufizimet) lidhen me:

Fazën e garantimit të inputeve:
- Certifikimi 'organik' dhe i fidanëve
- Analiza e tokës – e certifikuar
- Pronësia e tokës – aksesi në financim/regjistrim (ndihmë tjetër)

Fazën e kultivimit:
- Aftësitë e kultivimit dhe vjeljes, sidomos për bimët tradicionale (si, kur, pse, çfarë)
- Mjete dhe pajisje pune të përshtatshme për gratë
- Mungesa e ofruesve të shërbimeve për zbatimin e praktikave të mira bujqësore
- Infrastruktura (pajisjet) dhe kualifikimet për procesin pas vjeljes në fermat e vogla

Fazën e pasvjeljes dhe të tharjes:
- Mungesë e kontrollit të cilësisë
- Mungesë e mjediseve të përshtatshme dhe pajisje të pamjaftueshme për proceset pas vjeljes dhe përpunim në fermat e vogla
- Mungesë paketimi cilësor
- Njohuri të kufizuara për proceset e mësipërme

Fazën e tregtimit:
- Mungesë e brandit, etiketimit dhe paketimit sipas kërkesave ligjore (përpunim në shkallë të vogël për konsumatorët përfundimtarë në treg, me fokus grupin e grave të Reçit)
- Kapacitete të përshtatshme për ruajtjen e produktit final
- Lidhjet në treg
- Njohuri për zhvillimet në treg dhe kërkesat e tregut
- Promovimi

Në lidhje me Çështjet e Pabarazisë Gjinore dhe të Përfshirjes së Grave në zinxhirin e vlerës, informacioni i mbledhur nga takimet dhe intervistat tregon se gratë janë të përfshira në pjesën më të madhe të zinxhirit të vlerës me fokus kultivimin dhe pjesërisht në proceset pas vjeljes, kryesisht në shkallë të vogël (në fermat e tyre), ndërkohë që kontribuojnë edhe në punët e shtëpisë.

Ekzistojnë mundësi për kultivimin e bimëve, me shtim të kufizuar të ngarkesës për gratë, dhe ato mund të përfshihen, në bashkëpunim dhe marrëveshje me industrinë, edhe në përpunim dhe tregtim të përshtatshëm në shkallë të vogël të BMA-ve për tregun vendor, që mund të rezultojë në përmirësime të cilësisë, sasisë, dhe kontrollit të burimeve nga gratë, si edhe në të ardhura më të larta.

Në Lidhje me Mundësitë e Financimit, ky lloj aktiviteti është i vetmi burim për fitimin e të ardhurave për shumë familje. Zakonisht fitimet merren pasi sasia e mbledhur është çuar në qendrën e grumbullimit. Aktualisht, mundësitë e financimit janë shumë të ulëta, sidomos për gratë, të cilat në shumicën e rasteve nuk kanë kontroll mbi asetet dhe burimet.

2.4 NDËRHYRJE TË REKOMANDUARA PËR ZINXHIRIN E VLERËS TË BMA-VE

Më poshtë vijojnë disa rekomandime të përgjithshme lidhur me fuqizimin e grave dhe zhvillimin e zinxhirit të vlerës të BMA-ve në Bashkinë Malësi e Madhe, kategorizuar sipas impaktit të tyre:

1. Mbështetje në kultivim

Forcim i praktikave të mira bujqësore (PMB) në kultivimin e BMA-ve, me fokus mbi përmirësimin e teknikave të vjeljes dhe trajtimit pas vjeljes (tharje, ruajtje, transportim), me theks të veçantë mbi mbështetjen e grave fermere.

- Kryerja e vlerësimit të menaxhimit të parcelave (historia, inspektimi, analiza e tokës, vlerësimi i rrezikut të kontaminimit) me fokus fermat e drejtuara nga gratë.
- Sigurimi i mbështetjes së posaçme për gratë për zgjedhjen e varieteteve të bimëve të përshtatshme për kushtet agroteknike të zonës dhe kërkesat e tregut.
- Trajnimi i grave fermere në praktikat e kultivimit (përgatitja e arës, fara/fidanë të certifikuar, mbjellje, ujitje, plehërim, mbrojtje e bimëve dhe menaxhim i barërave të këqija për të siguruar përmbushje të standardeve të Rregullores së BE-së Nr. 2020/2040 mbi alkaloidët e pirrolizidinës (AP) dhe alkaloidët tropanë (AT).
- Përmirësimi i proceseve të vjeljes dhe pasvjeljes (efikasitet në vjelje, përpunim fillestar, tharje, paketim, ruajtje, transport) me pjesëmarrje të grave në vendimmarrje.
- Ofrimi i trajnimeve të specializuara për gratë për menaxhimin e agrokimikateve/plehrave, higjienën, dhe ndihmën e parë, për sigurimin e praktikave të sigurta dhe të qëndrueshme bujqësore.

Impakti: Pjesëmarrje më e madhe e grave në kultivimin e BMA-ve, përmirësim i aftësive bujqësore, dhe rritje e tregtueshmërisë së BMA-ve të prodhuara nga gratë.

2. Asistencë teknike

Ofrimi i mbështetjes teknike të posaçme për gratë prodhuese të BMA-ve për përmirësimin e efikasitetit të prodhimit dhe qëndrueshmërisë.

- Kryerja e analizës së tokës për t'i udhëzuar gratë fermere në marrjen e vendimeve për mbjelljet që janë të bazuara në informacion.
- Krijimi i parcelave demonstruese me bimë të caktuara për ndjekjen dhe zbatimin e praktikave më të mira, duke u dhënë prioritet nismave të drejtuara nga gratë.
- Mbështetja e aksesit të grave në material shumëzimi të certifikuar dhe mundësimi i replikimit në fermë të fidanëve për të siguruar qëndrueshmërinë e prodhimit.
- Mundësimi i granteve të vogla posaçërisht për gratë fermere, me qëllim përmirësimin e praktikave të vjeljes dhe pasvjeljes (pajisje për ruajtje, transport, tharje ekologjike, përpunim, brandin, dhe paketimin për tregjet lokale, me fokus mbi grupin e grave të Reçit dhe rajone të tjera).
- Sigurimi i pajisjeve personale mbrojtëse (PPM) për gratë fermere, që mundësojnë punë të sigurt me agrokimikatet dhe pajisjet bujqësore.

Impakti: Forcimi i kapaciteteve teknike të grave fermere, produktivitet më i madh, shtim i sigurisë dhe përmirësim i qëndrueshmërisë së punës bujqësore të drejtuar nga gratë.

3. Certifikim i cilësisë dhe standardet e sigurisë

Forcimi i proceseve të certifikimit dhe të përmbushjes së kritereve për të mundësuar akses në treg dhe çmime optimale për bizneset e BMA-ve të drejtuara nga gratë.

- Mbajtja e seancave të posaçme ndërgjegjësuese për gratë fermere në lidhje me rëndësinë e certifikimit dhe hapat e nevojshëm që duhen ndërmarrë për përmbushjen e kushteve.
- Dhënia e ndihmës së drejtpërdrejtë për gratë për marrjen e certifikatave të prodhimit organik dhe sigurimin e përmbushjes së standardeve të cilësisë.
- Ofrimi i programeve të këshillimit dhe mentorimit me fokus mbi gratë sipërmarrëse në sektorin e BMA-ve, për t'i ndihmuar ato të orientohen në procesin e certifikimit dhe në zhvillimin e biznesit.

Impakti: Shtim i numrit të certifikimeve në radhët e grave fermere, përmirësim i konkurrueshmërisë, dhe akses më i madh në tregje me vlerë të lartë.

4. Mbështetje për grupet e grave prodhuese

Forcimi i roleve të grave në zinxhirin e vlerës të BMA-ve përmes mbështetjes së grupeve prodhuese, forcimit të fuqisë negociuese kolektive, dhe promovimit të integrimit të tregut.

- Organizimi i grave në grupe prodhuese , për rritjen e përfaqësimit, rolit drejtues, dhe fuqisë vendimmarrëse të tyre.
- Realizimi i programeve me ndjeshmëri gjinore për ndërtimin e kapaciteteve në lidhje me planifikimin e biznesit, marketingun, njohuri financiare, dhe akses të grave fermere në financim.
- Krijimi i partneriteteve midis grupeve të grave prodhuese dhe palëve të interesit në këtë sektor për të mundësuar marrëveshje paraprake dhe marrëdhënie afatgjata biznesi.
- Mbështetja e sipërmarrjeve të drejtuara nga gratë për të aksesuar tregje të reja, me fokus në shitjet drejtpërdrejt tek konsumatori dhe nismat për krijimin e një brandi që thekson kontributet e grave.

Impakti: Fuqizim më i madh ekonomik i grave në sektorin e BMA-ve, përmirësim i mundësive për krijimin e rrjeteve dhe shtim i fitimeve të bizneseve të drejtuara nga gratë.

Këto rekomandime ofrojnë një qasje të strukturuar me në qendër gratë për forcimin e zinxhirit të vlerës të BMA-ve përmes ndërhyrjeve të posaçme në kultivim, asistencë teknike, certifikim dhe mbështetje të grupeve të prodhuesve, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së tyre, të aksesit të tyre në burime si dhe të mundësive të tregut për zinxhirin e vlerës të BMA-ve.

Tabela 5. Rekomandime për ZV-në e bimëve mjekësore dhe aromatike

Nr.	Veprimtaria	Impakti		
		Afatshkurtër	Afatmesëm	Afatgjatë
1	**Forcim i praktikave të mira bujqësore (pmb) në kultivimin e bma-ve me theks të veçantë mbi mbështetjen e grave fermere**			
	Pjesëmarrje më e madhe e grave në kultivimin e BMA-ve, përmirësim i aftësive bujqësore, dhe rritje e tregtueshmërisë së BMA-ve të prodhuara nga gratë.			
1.1	Sigurimi i mbështetjes së posaçme për gratë për zgjedhjen e varieteteve të bimëve të përshtatshme për kushtet agroteknike të zonës dhe kërkesat e tregut.	X	X	X
1.2	Kryerja e vlerësimit të menaxhimit të parcelave (historia, inspektimi, analiza e tokës, vlerësimi i rrezikut të kontaminimit) me fokus fermat e drejtuara nga gratë.	X	X	X
1.3	Trajnimi i grave fermere në praktikat e kultivimit (përgatitja e arës, fara/fidanë të certifikuar, mbjellje, ujitje, plehërim, mbrojtje e bimëve dhe menaxhim i barërave të këqija, për trajtimin e alkaloideve të pirrolizidinës (AP) dhe alkaloidëve tropanë (AT) sipas rregullores evropiane (n°2020/2040).	X	X	X
1.4	Përmirësimi i proceseve të vjeljes dhe pasvjeljes (efikasitet në vjelje, përpunim fillestar, tharje, paketim, ruajtje, transport) me pjesëmarrje të grave në vendimmarrje.	X	X	X
1.5	Ofrimi i trajnimeve të specializuara për gratë për menaxhimin e agrokimikateve/plehrave, higjienën, dhe ndihmën e parë, për sigurimin e praktikave të sigurta dhe të qëndrueshme bujqësore.	X	X	X

(Vazhdon në faqen tjetër)

Nr.	Veprimtaria	Impakti		
		Afatshkurtër	Afatmesëm	Afatgjatë
2	**Ofrimi I Mbështetjes Teknike Të Posaçme Për Gratë Prodhuese Të Bma-Ve Për Përmirësimin E Efikasitetit Të Prodhimit Dhe Të Qëndrueshmërisë**			
	Forcimi i kapaciteteve teknike të grave fermere, produktivitet më i madh, shtim i sigurisë dhe përmirësim i qëndrueshmërisë së punës bujqësore të drejtuar nga gratë.			
2.1	Kryerja e analizës së tokës për t'i udhëzuar gratë fermere në marrjen e vendimeve për mbjelljet që janë të bazuara në informacion.	X	X	X
2.2	Krijimi i parcelave demonstruese me bimë të caktuara për ndjekjen dhe zbatimin e praktikave më të mira, duke u dhënë prioritet nismave të drejtuara nga gratë.	X	X	X
2.3	Mbështetja e aksesit të grave në material shumëzimi të certifikuar dhe mundësimi i replikimit në fermë të fidanëve për të siguruar qëndrueshmërinë e prodhimit.	X	X	X
2.4	Mundësimi i granteve të vogla posaçërisht për gratë fermere, me qëllim përmirësimin e praktikave të vjeljes dhe pasvjeljes (pajisje për ruajtje, transport, tharje ekologjike, përpunim, brandin, dhe paketimin për tregjet lokale, me fokus mbi grupin e grave të Reçit dhe rajone të tjera).		X	X
2.5	Sigurimi i pajisjeve personale mbrojtëse (PPM) për gratë fermere, që mundësojnë punë të sigurt me agrokimikatet dhe pajisjet bujqësore.	X	X	X
3	**Forcimi i proceseve të certifikimit dhe të përmbushjes së kritereve për të mundësuar akses në treg dhe çmime optimale për bizneset e bma-ve të drejtuara nga gratë**			
	Shtim i numrit të certifikimeve ndër gratë fermere, përmirësim i konkurrueshmërisë, dhe akses më i madh në tregje me vlerë të lartë.			
3.1	Mbajtja e seancave të posaçme ndërgjegjësuese për gratë fermere në lidhje me rëndësinë e certifikimit dhe hapat e nevojshëm që duhen ndërmarrë për përmbushjen e kushteve.	X	X	X
3.2	Dhënia e ndihmës së drejtpërdrejtë për gratë për marrjen e certifikatave të prodhimit organik dhe sigurimin e përmbushjes së standardeve të cilësisë.		X	X
3.3	Ofrimi i programeve të këshillimit dhe mentorimit me fokus mbi gratë sipërmarrëse në zinxhirin e vlerës të BMA-ve, për t'i ndihmuar ato të orientohen në procesin e certifikimit dhe në zhvillimin e biznesit		X	X
4	**Forcimi i roleve të grave në zinxhirin e vlerës të bma-ve përmes mbështetjes së grupeve prodhuese, forcimit të fuqisë negociuese kolektive dhe promovimit të integrimit të tregut**			
	Forcimi i roleve të grave në zinxhirin e vlerës të BMA-ve përmes mbështetjes së grupeve prodhuese, forcimit të fuqisë negociuese kolektive, dhe promovimit të integrimit të tregut.			
4.1	Organizimi i grave në grupe prodhuese , për rritjen e përfaqësimit, rolit drejtues, dhe fuqisë vendimmarrëse të tyre.		X	X
4.2	Realizimi i programeve me ndjeshmëri gjinore për ndërtimin e kapaciteteve në lidhje me planifikimin e biznesit, marketingun, njohuri financiare, dhe akses të grave fermere në financim.	X	X	X
4.3	Krijimi i partneriteteve midis grupeve të grave prodhuese dhe palëve të interesit në këtë sektor për të mundësuar marrëveshje paraprake dhe marrëdhënie afatgjata biznesi.	X	X	X
4.4	Mbështetja e sipërmarrjeve të drejtuara nga gratë për të aksesuar tregje të reja, me fokus në shitjet drejtpërdrejt tek konsumatori dhe nismat për krijimin e një brandi që thekson kontributet e grave.		X	X

Partnerët/bashkëpunimi në nivel vendor: shoqatat prodhuese kombëtare, rajonale dhe vendore të BMA-ve; bashkia; institucionet publike përkatëse të sektorit; industria; pikat e shitjes. Këto rekomandime ofrojnë një qasje të strukturuar me në qendër gratë për forcimin e zinxhirit të vlerës të BMA-ve përmes ndërhyrjeve të posaçme në kultivim, asistencë teknike, certifikim dhe mbështetje të grupeve të prodhuesve, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së tyre, e aksesit të tyre në burime si dhe të mundësive të tregut në zinxhirin e vlerës të BMA-ve.

Pjesa 3

Analiza e Zinxhirit të Vlerës së Blegtorisë dhe Produkteve të Qumështit

1. Analizë me Ndjeshmëri Gjinore e Zinxhirit të Vlerës së Blegtorisë/Produkteve të Qumështit

Në vitin 2023, në sektorin e blegtorisë në Shqipëri mbizotëronin bagëtitë për prodhimin e qumështit, të të gjitha kategorive. Numri total i gjedhëve arriti në 263.385 krerë, ku lopët e qumështit përbënin shumicën, me 88,24% të të gjitha tufave.
Rritja e dhenve vazhdoi të ishte pjesë e rëndësishme e sektorit, me një total prej 1.206.206 krerësh, nga të cilat 83,43% ishin dele qumështi. Në mënyrë të ngjashme, numri i dhive ishte 640.242, ku dhitë e qumështit përbënin 79,96% të numrit të përgjithshëm të krerëve. Numri i derrave në vitin 2023 ishte 114.833, ku dosat pjellëse përbënin 9,18% të totalit të tufave. Këto shifra janë tregues të rëndësisë që kanë pasur dhe kanë në vijimësi produktet e bulmetit në sektorin blegtoral të vendit, ku lopët, delet, dhe dhitë rriten kryesisht për qumësht.[47]

Industria e qumështit pësoi rënie të ndjeshme në sasinë e qumështit të marrë nga të gjitha kategoritë e bagëtive në vitin 2023, kur u grumbullua një total prej 101 mijë ton qumësht, që përbënte një rënie prej 8% krahasuar me vitin pararendës. Bie në sy tendenca në rënie në sasinë e qumështit të lopës, ku u prodhuan 80 mijë ton, që shënon një rënie prej 7,6%. Edhe qumështi i deleve pësoi një rënie me 10,6%, me 13 mijë ton qumësht delesh gjithsej, ndërsa prodhimi i qumështit të dhive ra me 8,2%, me prodhim total 8 mijë ton. Nga sasia e gjithsejtë e qumështit të grumbulluar, 13 mijë ton ishin për konsum të drejtpërdrejtë të klientëve, ndërsa pjesa tjetër shkoi për përpunim. Pjesa më e madhe e qumështit të prodhuar për konsum ishte qumësht me yndyrë të plotë (88,2%), ndjekur nga qumështi gjysmë i skremuar (8,1%), qumështi i papërpunuar (3,2%), dhe qumështi i skremuar (0,5%). Në tërësi, vihet re rënie e përgjithshme në grumbullimin e qumështit, që sugjeron ekzistencën e vështirësive potenciale në sektorin e blegtorisë për qumësht. Megjithatë, industria e përpunimit vazhdon të jetë mbizotëruese dhe pjesa më e madhe e qumështit kalon në proces përpunimi para se të shkojë tek konsumatorët.[48]

Gratë kanë rol qendror në zinxhirin e vlerës, duke mbajtur përgjegjësi që nga kujdesi për kafshët dhe mjelja deri tek dorëzimi i qumështit në baxho.

Blegtoria është një sektor shumë i rëndësishëm agroushqimor në Shqipëri – rreth gjysma e fermerëve merren me blegtori, përfshirë edhe sektorin e prodhimit të bulmetit. Produktet e bulmetit përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të shportës së mallrave të konsumit të familjeve shqiptare. Pjesa dërrmuese e qumështit të prodhuar është qumësht lope (më shumë se katër të pestat e sasisë së gjithsejtë). Në përgjithësi, produktet e bulmetit janë për tregun e brendshëm dhe, për këtë arsye, rritja e prodhimit e merr shtysën kryesore nga rritja e kërkesës në treg, ndërsa bilanci tregtar i bulmetit ka deficit strukturor.

Zinxhiri i vlerës i produkteve të qumështit konsiderohet sektor prioritar duke marrë parasysh potencialin e tij për zëvendësimin e importit.[49] Rritja e bagëtive të imta bëhet në disa mënyra: a) me sistem ekstensiv dhe verim të bagëtive për 6-8 muaj (të gjitha zonat); b) sistem gjysmë ekstensiv, me verim 5 deri 6 muaj; c) sistem i kullotjes në kullota të përhershme afër fermës; d) kullota natyrore që mund të arrihen lehtë në këmbë dhe bagëtitë kthehen në fermë në mbrëmje.

47. INSTAT. Shih: https://www.instat.gov.al/media/13520/statistikat-e-blegtoris%C3%AB-2023.pdf
48. INSTAT. Shih: https://www.instat.gov.al/al/temat/bujq%C3%ABsia-dhe-peshkimi/blegtoria/
49. Studim i sektorit të qumështit, AASF, 2019. Shih: https://aatsf.com.al/wp-content/uploads/2020/04/8Milkcover-EN.pdf

Megjithatë, aktualisht, prodhimi i qumështit të deleve dhe dhive bëhet pothuaj tërësisht sipas sistemit ekstensiv dhe prodhimi mesatar i qumështit për dele, me rreth 58 litra në vit, dhe për dhi, me rreth 112 litra, është gjithashtu i ulët. Krahasimi i produktivitetit të ripërtypësve të vegjël në Shqipëri me atë në shtetet anëtare të BE-së është më i vështirë, sepse prodhimet janë shumë të ndryshme edhe në rajone që kanë strukturë prodhimi dhe kushte natyrore të ngjashme. Sidoqoftë, mund të thuhet pa frikë se të dhënat e disponueshme tregojnë për një prodhim që varion nga 30% deri në 70% të prodhimit mesatar në rajone të krahasueshme në shtetet anëtare të BE-së.[50]

Kjo shkallë eficience në prodhimin blegtoral ndikohet nga njohuritë e kufizuara të fermerëve për metodat moderne të menaxhimit të fermave. Përmirësimi i njohurive të fermerëve duhet të fillojë me forcimin e rolit dhe performancës së shërbimeve publike të ekstensionit, motivimin e këshilluesve dhe mbështetjen financiare të shërbimit. Në procesin e përafrimit me Bashkimin Evropian, vendi po kërkon të rrisë aftësinë konkurruese dhe standardet ushqimore.[51]

1.1 SITUATA NË ZINXHIRIN E VLERËS TË PRODUKTEVE TË QUMËSHTIT DHE BULMETIT NË MALËSI TË MADHE

Malësia e Madhe ka traditë të gjatë në blegtori, sidomos në rritjen e gjedhëve, dhenve, dhive, dhe ripërtypësve të tjerë të vegjël. Produktet e qumështit dhe të bulmetit përbëjnë një aktivitet të rëndësishëm në zonë, që prodhon qumësht, djathë, kos dhe gjalpë. Gratë janë të përfshira në përpunimin e qumështit, prodhimin e djathit, dhe kujdesin për bagëtitë e imta, si dhentë dhe dhitë.

Bujqësia dhe blegtoria janë pjesë përbërëse integrale të ekonomisë në Malësi të Madhe dhe ofrojnë mundësi të shumta për komunitetet lokale, sidomos në zonat rurale. Të dhënat zyrtare[52] vënë në pah shumëllojshmërinë dhe përhapjen e aktivitetit bujqësor në zonë, si edhe mbështetjen e zonës në mbarështimin e bagëtive si një komponent i rëndësishëm i ekonomisë lokale. Ndër kategoritë kryesore janë gjedhët, bagëtitë e imta (dhentë dhe dhitë) derrat, shpezët, dhe bletaria, me shifra të detajuara për secilin lloj.

Ndër bagëtitë mbizotërojnë ripërtypësit e vegjël, si dhentë (14.927) dhe dhitë (8.900), që tregon për fokusin tradicional të zonës në këto bagëti, me gjasë për shkak të terrenit malor që mbështet nevojat e tyre për kullotje. Numri i konsiderueshëm i dhive të qumështit (5.188) thekson më tej rëndësinë e prodhimit të qumështit në ekonominë e zonës. Spikat edhe rritja e gjedhëve, me 3.552 krerë, nga të cilat 3.015 janë lopë, që tregon përsëri rëndësinë që kanë prodhimet e qumështit. Prodhimi total i qumështit në Malësi të Madhe arriti 8.177 ton në vitin 2023, ku mbizotërues ishte qumështi i lopës, me 5.724 ton. Edhe qumështi i deleve dhe dhive zinte një vend të rëndësishëm, me përkatësisht 1.209 dhe 1.244 ton. Kjo balancë sugjeron ekzistencën e një sektori të fuqishëm të produkteve të qumështit që u përgjigjet një vargu kërkesash të tregut, sidomos për produkte bulmeti tradicionale dhe artizanale.

50. Raport i studimit të sektorit të qumështit. MBZHR, 2021. Shih: https://ipard.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/06-Milk-Sector-Study-Final.pdf
51. Po aty.
52. Vjetari Statistikor i Bujqësisë 2023. INSTAT 2024. Shih: https://www.instat.gov.al/en/themes/agriculture-and-fishery/agriculture/
53. Sipas të dhënave nga faqja e internetit të bashkisë, ka vetëm dy ferma të mëdha gjedhësh dhe 39 ferma bagëtish të imta me më shumë se 100 krerë. Shih: https://bashkiamalesiemadhe.gov.al/2016/05/26/bujqesia/
54. Siipas Portalit të Fermerit, në Malësi e Madhe ka vetëm katër baxho. Shih: https://agroalbania.al/

Konstatime

Konstatimi I Në Malësi të Madhe, blegtoria për prodhimin e qumështit është e rrënjosur thellë në jetën e fermerëve të vegjël.[53] Rreth 60-70 familje furnizojnë me qumësht baxhon e Veleçikut, ndërsa rreth 25 fermerë të tjerë punojnë me baxhon Agro Reçi në Reç.[54] Gratë kanë rol qendror në zinxhirin e vlerës, duke mbajtur përgjegjësi që nga kujdesi për kafshët dhe mjelja deri tek dorëzimi i qumështit në baxho, për ato që jetojnë afër baxhove. Ndonëse kryejnë këto punë, ato nuk kanë kontroll mbi burimet kryesore, kanë akses të kufizuar në pajisje moderne, dhe shpesh nuk kanë mundësi të ndjekin trajnime që mund të përmirësonin efikasitetin dhe të lehtësonin ngarkesën e punës së tyre.

Konstatimi II Zinxhiri i vlerës i përpunimit të qumështit ka potencial të konsiderueshëm për rritje. Baxhoja e Veleçikut planifikon ta zgjerojë veprimtarinë e vet me anë të fondeve të IPARD-it, kur këto të bëhen përsëri të disponueshme. Tregu mund të absorbojë më shumë produkte bulmeti të cilësisë së lartë, duke krijuar mundësi për rritjen e prodhimit dhe të të ardhurave të familjeve fermere. Megjithatë, ka disa probleme strukturore dhe teknike që pengojnë rritjen e sektorit, që kërkon ndërhyrje të fokusuara për të siguruar qëndrueshmëri dhe pjesëmarrje më të madhe të grave në zinxhirin e vlerës.

Konstatimi III Prodhimi i qumështit vazhdon të bazohet në praktika tradicionale, ku mjelja me dorë vazhdon të jetë mënyra e zakonshme e mjeljes. Përdorimi i bidonëve plastikë ose të vjetër për grumbullim dhe transport shton rrezikun e kontaminimit, duke kompromentuar cilësinë dhe sigurinë e qumështit. Njohuritë e kufizuara për praktikat e mira janë një faktor tjetër që ndikon produktivitetin, sepse shumica e fermerëve nuk janë trajnuar për menaxhimin e fermave, standardet higjienike, ose parandalimin e sëmundjeve. Shërbimet e kufizuara të ekstensionit bëjnë që fermerët të mos marrin udhëzime teknike, dhe rjedhimisht nuk janë në gjendje të përdorin teknika moderne dhe më efikase pune në fermë.

Konstatimi IV Për baxhot e Veleçikut dhe Agro Reçit, zgjerimi i prodhimit varet nga sigurimi i një furnizimi të rregullt me qumësht me cilësi të lartë. Megjithatë, luhatjet në çmime dhe konkurrenca e padrejtë krijojnë mungesë stabiliteti për fermerët dhe mungesa e forcave të punës për shkak të migracionit i vështirësojnë më tej proceset e punës. Trajtimi i këtyre problemeve do të kërkojë investime në pajisje moderne, programe trajnimi të strukturuara dhe akses më të mirë në treg. Një njësi e vogël laboratorike në baxho për kontrollin e cilësisë dhe gjurmueshmërinë mund të përmirësojë konsiderueshëm përmbushjen e standardeve të tregut dhe të shtojë besimin e konsumatorëve në produktet vendore të qumështit.

Tabela 6. Analiza SWOT e zinxhirit të vlerës të qumështit

Pikat e forta	Pikat e dobëta
Blegtoria për qumësht është veprimtari e përhapur në Malësi të Madhe. **Gratë janë të përfshira aktivisht në të gjitha fazat** e zinxhirit të vlerës, që nga kujdesi për bagëtitë, mjelja, dhe dorëzimi në baxho. **Gratë kanë aftësi dhe njohuri tradicionale** për bagëtitë. **Ekzistenca e shembujve të praktikave të mira** në blegtorinë për qumësht dhe stallave moderne në zonë (ferma e baxhos së Veleçikut) dhe në vend. **Kushte të favorshme klimatike** dhe tradita në mbarështimin e bagëtive. **Numër i konsiderueshëm i racave të ripërtypësve** të vegjël që janë përshtatur mirë me kushtet e zonës. **Gatishmëria e baxhove të zonës** për të bashkëpunuar me fermerët që prodhojnë qumësht. **Angazhimi i aktorëve kyç të zinxhirit të vlerës** për të rritur sasinë dhe përmirësuar cilësinë e produktit. **Kërkesë e lartë për qumësht** nga baxhot lokale dhe për produkte përfundimtare në treg. (Baxho e Veleçikut ka një gamë të gjerë produktesh unike dhe një rrjet tregu të formuar). **Kërkesë në rritje e tregut** për nënprodukte bulmeti.	**Mungesa e burimeve financiare.** Fermerët e vegjël (me më pak se 10 gjedhë ose 100 ripërtypës të vegjël) janë të përjashtuar nga skema për mbështetjen e bujqësisë 2025. **Mungesa e një laboratori** analizash në baxho. **Sistem i papërshtatshëm** për monitorimin e qumështit të papërpunuar: regjistrat e produkteve të fermës dhe të qumështit shpesh janë të paplotë; kontrolli i cilësisë së qumështit të papërpunuar shpesh nuk bëhet me përdorim të sistemit të duhur të kampionëve. **Njohuri të kufizuara për praktikat e mira** të blegtorisë për qumësht. **Sisteme të pazhvilluara për grumbullimin e qumështit** të papërpunuar dhe infrastrukturë e dobët për grumbullimin e qumështit në zonat malore. **Mjelja bëhet kryesisht me dorë** dhe shumica e fermerëve përdorin bidonë të vjetër plastikë, që çon në cilësi të ulët që qumështit dhe rrezik të lartë kontaminimi. **Nivel i ulët i përmbushjes së standardeve shëndetësore** dhe të higjienës të qumështit të papërpunuar. **Nivel i ulët i njohurive të fermerëve** për standardet minimale të qumështit, higjienës në grumbullimin e qumështit, mbarështimin e bagëtive, menaxhimin e jashtëqitjeve të kafshëve dhe të mbetjeve. **Vështirësitë për marrjen e qumështit** cilësor nga fermerët e vegjël (higjiena). **Shumica e fermave blegtorale të qumështit nuk përdorin pajisje mjelëse** dhe kazanë ftohës, që përbën rrezik për sigurinë ushqimore. **Vëmendje e paktë** për mirëqenien e kafshëve. **Nivel i ulët i shërbimeve të ekstensionit.** **Qeverisja e zinxhirit të mallrave** dhe zbatimi i ligjit janë ende në nivel të pamjaftueshëm, sidomos për gjurmueshmërinë e qumështit. **Informalitet i lartë** në zinxhirin e furnizimit me qumësht. **Luhatje të mëdha sezonale** në prodhimin e qumështit. **Punë e rëndë dhe kushte pune të vështira**, sidomos për gratë. **Gratë nuk kanë kontroll mbi asete**, nuk kanë njohuri për praktikat më të mira në mbarështimin e bagëtive, si edhe vegla dhe pajisje për të pakësuar ngarkesën e punës dhe për të shtuar produktivitetin. **Mungesa aktuale e mundësive financiare** (IPARD) kufizon zgjerimin e baxhos lokale. **Mungesa e interesit të të rinjve** në blegtori dhe shkalla e lartë e emigracionit ndikojnë në numrin e forcave të punës.
Mundësitë	**Kërcënimet**
Ekzistenca e shembujve të praktikave të mira në blegtori dhe e stallave moderne në zonë (baxhoja e Veleçikut) dhe në vend mund të shërbejë si model për t'u ndjekur. **Kuadri ligjor në përgjithësi po përafrohet me acquis-in e BE-së,** i cili përmban edhe dispozita për barazinë gjinore, që ofron një mundësi për përfshirjen e konsideratave gjinore në politikat kombëtare për zhvillimin e bujqësisë dhe të blegtorisë.55 **Rritja e sasisë së furnizimit me qumësht** nga blegtorët mund të shtojë produktin përfundimtar të baxhove. **Mundësi për vijueshmëri** edhe pas projektit, përmes baxhove të zonës, Veleçiku dhe Agro Reçi. **Preferenca e përgjithshme e konsumatorëve** për produkte bulmeti karakteristike të vendit. **Fermerët e vegjël mund të shtojnë produktivitetin** përmes zbatimit të praktikave të mira blegtorale, sidomos në kujdesin për kafshët, higjienën e qumështit, mjedisin, dhe menaxhimin social-ekonomik.	**Luhatjet e mëdha sezonale** në prodhimin e qumështit mund të ndikojnë negativisht në zinxhirin furnizues. **Problemet e pazgjidhura** në lidhje me menaxhimin e të drejtave pronësore mund të ndikojnë investimet në stalla dhe bimë foragjere të përhershme, sidomos për sa u përket grave. **Ndotja e mjedisit** për shkak të blegtorisë dhe sektorit në përgjithësi. **Monitorim i pamjaftueshëm** i produkteve mbrojtëse, aditivëve dhe mbetjeve reziduale të antibiotikëve. **Rritjet e çmimeve** të ushqimeve për kafshët dhe inputeve. **Shkalla e lartë e migracionit** që ndikon në forcat e punës. **Interesat e blegtorëve të vegjël** (sidomos të grave blegtore) pothuaj nuk përfaqësohen nga përfaqësuesit e bujqësisë dhe të sektorit dhe nga grupet e advokacisë. **Ndryshimet klimatike** përbëjnë një rrezik potencial të konsiderueshëm; sidomos sepse ndryshimet e motit mund të ndikojnë kultivimin e bimëve foragjere.

55. Përafrimi i Kapitullit 11 me treguesit e GAP III të BE-së, treguesit gjinorë të Politikës së Përbashkët Bujqësore të BE-së, dhe me treguesit e OZHQ-ve. UN Women, 2023. Shih: https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

2. Diagrami i Zinxhirit të Vlerës të Qumështit në Malësi të Madhe

Në vijim paraqitet një diagram gjithëpërfshirës i hallkave të zinxhirit të vlerës, aktorëve, faktorëve mbështetës dhe çështjeve kryesore të identifikuara, bazuar në konstatimet nga intervistat me grupet e interesit dhe agjencitë mbështetëse vendore, puna kërkimore në terren, dhe konsultimet me specialistë. Diagrami paraqet grupet kryesore të interesit, fazat që nga inputet deri në tregun përfundimtar dhe ndihmon në identifikimin e vështirësive që dalin gjatë prodhimit. Vlerat numerike sipër kutive përfaqësojnë kostot dhe vlerën e shtuar për çdo fazë.

Figura 3. Diagram i zinxhirit të vlerës të qumështit



2.1 AKTORËT NË ZINXHIRIN E VLERËS

Sikurse shihet në diagramin më lart, zinxhiri i vlerës i qumështit në Malësi të Madhe është organizuar në këto nivele kyçe:

- Inpute
- Mbarështimi i bagëtive
- Mjelja dhe ruajtja
- Transporti dhe dorëzimi (në baxho/fabrikë)

Më poshtë vijon një përshkrim i shkurtër i secilit aktor në zinxhirin e vlerës dhe i agjencive mbështetëse në sistemin e tregut, që nga inputet deri tek shpërndarja në treg.

Furnizuesit e inputeve: Në inputet dhe shërbimet për prodhimet e qumështit përfshihen aksesi në material gjenetik, ushqim (si foragjeret, sana, ashtu edhe koncentratet), farat, plehrat dhe produktet për mbrojtjen e bimëve, veglat dhe pajisjet, barnat veterinare, vaksinat, dhe shërbimet veterinare. Përveç vënies në dispozicion të këtyre inputeve dhe shërbimeve, është gjithashtu e rëndësishme që ato të jenë të aksesueshme dhe të volitshme për të gjithë prodhuesit që kanë nevojë për to. Prodhimit bujqësor në Shqipëri i nevojiten produkte agrokimike, fara, plehra, pesticide, spermë, dhe një pjesë e konsiderueshme e ushqimit ose e ingredientëve të ushqimit për kafshë, që e bën sektorin të jetë në mëshirën e luhatjeve të çmimeve ndërkombëtare. Ashtu si në vende të tjera në zhvillim, fermerët dhe tregtuesit e inputeve në Shqipëri kanë mjaft vështirësi për të siguruar furnizime të rregullta dhe me cilësi të lartë. Kjo shkaktohet nga kufizimet financiare, cilësia e ulët e inputeve, si edhe nga shkalla e kufizuar e informacionit dhe njohurive teknike. Inputet relativisht të kushtueshme mund të sigurohen vetëm nëse paguhen me para në dorë, ndaj fuqia e ulët blerëse e fermerëve e kufizon përdorimin e tyre. Shpesh fermerët ankohen për cilësinë e ulët të farave foragjere, pesticideve, ushqimit për kafshë, barnave dhe spermës së buajve. Zakonisht, këto inpute furnizohen nga furnizues vendorë të inputeve, të cilët janë: i) importues/shitës me shumicë dhe me pakicë të farave dhe pesticideve; ii) impiante prodhuese ose importues të ushqimit për bagëtinë; iii) farmaci veterinare për barnat, dhe iv) importues të bagëtive ose inseminuesve për spermën e buajve.

Gratë kanë rol qendror në zinxhirin e vlerës megjithatë ato nuk kanë kontroll mbi burimet kryesore, kanë akses të kufizuar në pajisje moderne, dhe shpesh nuk kanë mundësi të ndjekin trajnime që mund të përmirësonin efikasitetin e punës dhe të lehtësonin ngarkesën e punës së tyre.

Shumë fermerë të vegjël kanë tendencën të blejnë inputet më të lira, për të ulur koston e prodhimit, por në shumicën e rasteve ata dalin me humbje për shkak të performancës së dobët në prodhim. Fermerët e vegjël nuk kanë informacion për inputet dhe e kanë të vështirë të gjejnë informacion, sepse shërbimet publike të ekstensionit nuk kanë kapacitete për të ndihmuar të gjithë fermerët.

Po kështu, ata nuk kanë njohuri dhe fonde për përdorimin e ushqimit për kafshë në sasinë dhe cilësinë e duhur; si rezultat, përmirësimet e shënuara në potencialin gjenetik të bagëtive të qumështit nuk çojnë në përmirësim të prodhimit të qumështit, sepse bagëtitë që nuk ushqehen mirë nuk mund të shprehin potencialin e plotë gjenetik të tyre. Si rezultat, prodhimi i qumështit është një nga më të ulëtit në rajon. Shumica e fermave të vogla blegtorale kanë informacion shumë të paktë për inputet dhe e kanë të vështirë ta gjejnë atë informacion. Disa nga shitësit me pakicë të inputeve në zonat rurale nuk janë kompetentë në atë që mund t'u këshillojnë fermerëve.[56]

56. Raport studimi i sektorit të qumështit. MBZHR, 2021. Shih: https://ipard.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/06-Milk-Sector-Study-Final.pdf

Blegtorët: Prodhimi blegtoral i ripërtypësve të vegjël përgjithësisht i përshtatet mirë kushteve kushtet gjeografike dhe klimatike në Shqipëri. Ripërtypësit e vegjël u japin vlerë kullotave natyrore dhe performanca e prodhimit përputhet me nivelin (e dobët) të ushqyerjes. Ato mund të përdorin burime të kufizuara ushqimore gjatë dimrit ose periudhave të thata gjatë verës, të zhvendosen për distanca të mëdha në kohën e verimit (transhumancave), dhe janë rezistente ndaj sëmundjeve dhe parazitëve. Shumë blegtorë preferojnë racat e vendit. Nga ana tjetër, produktiviteti i racave të vendit është i ulët dhe potenciali i tyre i kufizuar, ndonëse ende i pa shfrytëzuar plotësisht. Në zonat kodrinore dhe malore në Shqipëri mbizotëron sistemi blegtoral ekstensiv. Menaxhimi i ripërtypësve të vegjël bëhet mbi bazat e mbarështimit tradicional, ndërsa teknologjitë e reja pak njihen nga fermerët. Përzgjedhja e riprodhuesve bëhet nga vetë fermerët, bazuar në përvojën e tyre dhe në informacion empirik. Ushqyerja e kafshëve bazohet kryesisht në përdorimin e rezervave pastorale, sepse ripërtypësit e vegjël mbahen në kullota verore për rreth pesë deri gjashtë muaj (që nga prilli deri në tetor). Fermerët që kanë numër të vogël krerësh nuk i verojnë bagëtitë dhe përdorin kullota të përbashkëta. Proceset më të rënda të punës me delet/dhitë, për shembull mjelja, kryhen me dorë. Ka pak ndërgjegjësim ose njohuri për kriteret, standardet minimale dhe praktikat e mira në aspekte të ndryshme të mirëritjes së kafshëve, përdorimit të inputeve dhe praktikave të mjeljes. Zhvillimi i prodhimit primar të qumështit është penguar për vite me radhë nga një numër faktorësh, më kryesorët nga të cilët janë: i) fragmentimi i prodhimit dhe madhësia e vogël e fermave, ii) praktika të dobëta të menaxhimit të fermave, sidomos për sa i përket ushqyerjes, iii) akses i kufizuar në inpute të cilësisë së lartë, iv) moshimi i pronarëve të fermave, që ngadalëson procesin e ndryshimit dhe pakëson mundësitë për investime, v) ofrim i pamjaftueshëm i shërbimeve (shërbimit veterinar, shërbimit të ekstensionit, ndërzimit natyror dhe/ose riprodhimit) dhe, vi) mungesa e organizatave të fermerëve dhe koordinim i pamjaftueshëm në zinxhirin e vlerës. Këta faktorë çojnë në produktivitet dhe efikasitet më të ulët të fermës; aspektet specifike të problemeve më të rëndësishme përshkruhen më poshtë. Intensiteti i ulët kapital i prodhimit – si në fermat e gjedhëve ashtu edhe në ato të ripërtypësve të vegjël të qumështit – rezultojnë në produktivitet të ulët, kosto relativisht të larta prodhimi dhe fitim të ulët, që nga ana tij pengon akumulimin e kapitalit për investime të reja dhe, rrjedhimisht, prodhimi dhe produktiviteti vazhdojnë të mbeten të ulët në shumë ferma të qumështit. Fermat e vogla gjenden aktualisht në udhëkryq: atyre u duhet të marrin një vendim nëse duan të rriten dhe zhvillohen duke përmbushur standardet, apo të mbyllin aktivitetin e tyre komercial. Si rast specifik, fermat me tufa të vogla vështirë se do të vazhdojnë të jenë ferma në të ardhmen. Në përgjithësi, këta fermerë kanë tendencën ta lënë këtë aktivitet sapo gjejnë një mundësi tjetër. Shumë prej problemeve – si cilësia e ulët e qumështit, sasitë e ulëta të prodhimit dhe shkalla e lartë e sezonalitetit – lidhen me shkallën e vogël të veprimtarisë së fermës. Investimet në pajisjet e mjeljes dhe të ruajtjes së ftohtë të qumështit, përmirësimet në praktikat e ushqyerjes dhe foragjere, futja e racave të specializuara të qumështit dhe teknikat e përparuara të mbarështimit të bagëtive janë me rëndësi kyçe për ta kapërcyer këtë vështirësi. Megjithatë, investime dhe përmirësime të tilla janë të pagjasa, madje të pamundura, në fermat e vogla, të cilat janë mbizotëruese në sektorin e qumështit dhe të bulmetit.[57]

Në Malësi të Madhe, blegtoria për prodhimin e qumështit është traditë me rrënjë të thella në jetën e fermerëve të vegjël. Rreth 60-70 familje furnizojnë me qumësht baxhon e Veleçikut, ndërsa rreth 25 fermerë të tjerë punojnë me baxhon Agro Reçi në Reç. Gratë kanë rol qendror në zinxhirin e vlerës dhe përgjegjësitë e tyre përfshijnë që nga kujdesi për kafshët dhe mjelja deri tek dorëzimi i qumështit në baxho, kur banojnë afër tyre. Ndonëse janë të angazhuara me këto punë, ato nuk kanë kontroll mbi burimet kryesore, kanë akses të kufizuar në pajisje moderne, dhe shpesh nuk kanë mundësi të ndjekin trajnime që mund të përmirësonin efikasitetin e punës dhe të lehtësonin ngarkesën e punës së tyre. Prodhimi i qumështit vazhdon të bazohet në praktika tradicionale, ku mjelja me dorë vazhdon të jetë praktika e zakonshme. Përdorimi i bidonëve plastikë ose të vjetër për grumbullim dhe transport shton rrezikun e kontaminimit, duke kompromentuar cilësinë dhe sigurinë e qumështit. Njohuritë e kufizuara për praktikat e mira janë një faktor tjetër që ndikon produktivitetin, sepse shumica e fermerëve nuk janë trajnuar për menaxhimin e fermave, standardet higjienike, ose parandalimin e sëmundjeve. Shërbimet e kufizuara të ekstensionit bëjnë që fermerët të mos marrin udhëzime teknike, dhe rrjedhimisht nuk janë në gjendje të përdorin teknika moderne dhe më efikase pune në fermë.

Baxhot: Industria e përpunimit të qumështit në Shqipëri karakterizohet nga një numër i madh pikash të vogla për përpunimin e qumështit, të quajtura baxho, shumë prej të cilave janë biznese gjysmëformale ose informale.

57. Raport studimi i sektorit të qumështit. MBZHR, 2021. Shih: https://ipard.gov.al/wp-content/uploads/2021/03/06-Milk-Sector-Study-Final.pdf

Baxhot mesatare ose të mëdha janë shumë më të pakta në numër; ato bëjnë përpjekje dhe investime për t'u rritur si biznese dhe për të përmbushur më mirë standardet, dhe përfaqësojnë bazën e industrisë së përpunimit të qumështit. Baxhot e vogla janë në zona rurale dhe të thella. Pjesa më e madhe e baxhove në zonat malore janë sezonale, sepse përpunojnë kryesisht qumësht deleje dhe dhie; gjatë stinës së prodhimit ato përpunojnë edhe sasi të vogla qumështi lope. Ato përdorin metoda/teknologji të vjetruara dhe zbatojnë standarde të pamjaftueshme të sigurisë dhe cilësisë ushqimore. Higjiena është problem në shumicën e këtyre njësive. Ato nuk kanë kapacitetet e duhura për ruajtjen e qumështit dhe qumështi përpunohet sipas kapacitetit të njësisë. Ato kanë gjithashtu probleme me tregtimin e produkteve. Klientët e tyre janë dyqane të vogla në zonat urbane, por jo në rrethet e mëdha dhe ata zakonisht i paguajnë fermerët me një vonesë prej disa muajsh, dhe vetë fermerët nuk kanë mundësi të blejnë ushqim dhe materiale të tjera për bagëtitë e tyre. Nga ana tjetër, këta klientë janë shumë më pak kërkues për cilësinë e qumështit të papërpunuar, krahasuar me baxhot më të mëdha dhe të formalizuara: ata masin vetëm dendësinë dhe përmbajtjen yndyrore të qumështit, por nuk e analizojnë qumështin për ngarkesën e qelizave somatike dhe mikrobiologjike; për të garantuar sigurinë ushqimore ata bëjnë pasterizim për disa minuta, që ndikon në cilësinë; uji i përdorur për përpunimin e qumështit nuk trajtohet paraprakisht; inputet dhe menaxhimi teknologjik bëhen me hamendje. Nuk bëhet menaxhim i mbetjeve ujore.[58]

Familja Hasanaj e krijoi baxhon e Veleçikut në fund të viteve 2000, duke shënuar fillimin e një procesi transformimi në zinxhiri e vlerës së përpunimit të qumështit. Si e para dhe e vetmja baxho në zonë, ajo ofroi një treg për të cilin fshatarët e zonës kishin shumë nevojë, duke u mundësuar atyre të zgjeronin tufat dhe të siguronin të ardhura të qëndrueshme. Prania e baxhos së Veleçikut ka transformuar zinxhirin e vlerës së përpunimit të qumështit në zonë, duke u mundësuar familjeve fermere të shtonin bagëtitë e tyre, përfshirë lopë, dele dhe dhi, dhe duke u mundësuar atyre të kenë një burim të sigurt të ardhurash. Duke pasur një treg të sigurt për qumështin e tyre, fermerët e zonës kanë krijuar stabilitet në prodhimin blegtoral, që ka forcuar qëndrueshmërinë ekonomike të tyre.

Baxhoja e Veleçikut ka përqafuar si traditën, ashtu edhe inovacionin në prodhimin e djathit. Aty vazhdon të prodhohet djathi i bardhë tradicional, por prodhohen edhe djathëra unike, artizanale, si djathë pikant, djathë me sherbelë, djathë me arra, djathë me fara susami, djathë me domate të thara, etj. Produktet e tyre dallohen për përkushtimin ndaj cilësisë dhe për shpirtin krijues, duke e bërë djathin e Veleçikut një brand të njohur përtej komunitetit të tyre. Falë shijes së tij të veçantë dhe reputacionit në rritje, djathi i Veleçikut tani gjendet kudo, në dyqane, tregje, supermarkete dhe restorante në Tiranë, Durrës, Shkodër, dhe më gjerë. Ajo që filloi si një baxho e vogël familjare është shndërruar tani në një agrobiznes të suksesshëm, që demonstron fuqinë e sipërmarrjeve vendore për të çuar përpara zhvillimin ekonomik të zonës dhe blegtorinë për produkte të qumështit. Zinxhiri i vlerës i përpunimit të qumështit ka potencial të konsiderueshëm për rritje. Veleçiku planifikon ta zgjerojë veprimtarinë e vet me anë të fondeve të IPARD-it, kur këto të bëhen përsëri të disponueshme. Tregu mund të absorbojë më shumë produkte bulmeti të cilësisë së lartë, që ofron mundësi për rritjen e prodhimit dhe të të ardhurave të familjeve fermere. Megjithatë, ka disa probleme strukturore dhe teknike që pengojnë rritjen e tij, që kërkon ndërhyrje të fokusuara për të siguruar qëndrueshmëri dhe pjesëmarrje më të madhe të grave në zinxhirin e vlerës. Baxho Agro Reçi është një aktor i rëndësishëm në zinxhirin e vlerës të përpunimit të qumështit në Malësi të Madhe. Ajo punon nga afër me 25 familje fermere nga të cilat merr qumësht të cilësisë së lartë. Baxhoja ka krijuar një treg të qëndrueshëm për fermerët e zonës, duke u mundësuar atyre të mbajnë dhe zgjerojnë prodhimet blegtorale dhe të sigurojnë të ardhura të qëndrueshme. Ashtu si Veleçiku, Agro Reçi përballet me vështirësi që lidhen me furnizimin me qumësht, gjurmueshmërinë, dhe kushtet e ndryshueshme në treg. Shumica e fermerëve vazhdojnë të bëjnë mjelje me dorë dhe përdorin bidonë plastikë të vjetër, që kompromenojnë cilësinë e qumështit dhe sigurinë ushqimore. Krahas kësaj, mungesa e njohurive për menaxhimin e fermës dhe e shërbimeve të ekstensionit kufizon produktivitetin dhe i pengojnë fermerët të përdorin praktikat e mira në blegtori. Për baxhot e Veleçikut dhe Agro Reçit, zgjerimi i mëtejshëm i prodhimit varet nga sigurimi i një furnizimi të rregullt me qumësht me cilësi të lartë. Megjithatë, luhatjet në çmime dhe konkurrenca e padrejtë krijojnë mungesë stabiliteti për fermerët dhe mungesa e forcave të punës për shkak të emigracionit i vështirëson më tej proceset e punës. Trajtimi i këtyre problemeve do të kërkojë investime në pajisje moderne, programe trajnimi të strukturuara dhe akses më të mirë në treg. Një njësi e vogël laboratorike në baxho për kontrollin e cilësisë dhe gjurmueshmërinë mund të përmirësojë konsiderueshëm përmbushjen e standardeve të tregut dhe të shtojë besimin e konsumatorëve në produktet vendore të qumështit.

58. Po aty.

2.2 KUADRI LIGJOR

Kuadri ligjor mbi të cilin mbështetet blegtoria dhe fermat e qumështit në Shqipëri është i strukturuar përmes një vargu ligjesh, vendimesh të qeverisë dhe procesesh të përafrimit me BE-në. Korniza ligjore fokusohet në zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë, mirëqenien e bagëtive, sigurinë ushqimore dhe praktikat e qëndrueshme bujqësore dhe blegtorale. Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit është një kornizë politike kombëtare me qasje shumësektoriale. Strategjia është hartuar për një periudhë shtatëvjeçare, nga viti 2021 deri në vitin 2027. Ajo ka për qëllim të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit agroushqimor për të plotësuar nevojat e njerëzve, të cilët përballen me sfida afatmesme dhe afatgjata në sigurimin e ushqimit, fitimin e jetesës, me ndryshimet klimatike dhe humbjen e biodiversitetit. Ajo synon gjithashtu që t'i ndihmojë njësitë ekonomike familjare në zonat rurale të zhvillohen dhe të bëhen më konkurruese, bazuar në politika që mbështesin përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, përdorimin efikas të inputeve bujqësore, blegtorale dhe të peshkimit, dhe të njohurive bujqësore dhe inovacionit.[59]

Ligji nr. 9441, datë 11.11.2005, "*Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi*". Objektivat kryesore të këtij ligji janë të sigurojë prodhimin e duhur të qumështit në ferma, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit të papërpunuar dhe të përpunuar, si dhe të produkteve me bazë qumështin. Ky ligj synon të sigurojë procese prodhimi dhe tregtimi me cilësi të kontrolluar sipas kërkesave të tregut të brendshëm dhe atij ndërkombëtar. Ai fokusohet gjithashtu në rregullimin me ligj të licencimit të fermave të prodhimit të qumështit dhe qendrave të grumbullimit, standardizimit dhe përpunimit të qumështit. Një objektiv tjetër i rëndësishëm është garantimi i sigurisë së konsumatorit, duke siguruar që qumështi dhe nënproduktet e tij përmbushin standardet e rrepta të sigurisë ushqimore, për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien e publikut.[60]

Ligji nr. 10465, datë 29.9.2011, "*Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë*". Ligji përcakton kuadrin për mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve sipas standardeve të OIE-së dhe BE-së dhe organizimin, funksionimin dhe financimin e shërbimit dhe inspektoratit veterinar, si dhe mbrojtjen e shëndetit publik nga sëmundjet zootonike të transmetuara nga kafshët.[61]

Ligji nr. 9863, datë 28.01.2008, "*Për ushqimin*". Ky ligj synon të sigurojë nivele të larta të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe interesave të konsumatorëve për sa i përket produkteve ushqimore. Ai përcakton rregullat që drejtojnë higjienën e ushqimeve, përgjegjësitë e operatorëve të bizneseve, standardet e cilësisë së ushqimeve, regjistrimin e treguesve gjeografikë të origjinës, etiketimin e ushqimeve dhe standardet e tregtimit. Ligji përcakton gjithashtu sistemin e inspektimit të ushqimeve dhe krijon Agjencinë Kombëtare të Ushqimit. Dispozitat përfundimtare trajtojnë shkeljet dhe dënimet përkatëse.

Ligji nr. 38/2013, me të cilin u ndryshua Ligji nr. 9693, "*Për fondin kullosor*". Ky ligj ka të bëjë me administrimin dhe mbrojtjen e kullotave dhe livadheve. Ai përcakton detyrat dhe detyrimet e organeve të pushtetit qendror dhe vendor në këtë sektor dhe parashikon institucione kërkimore të specializuara.[62]

Ligji nr. 10431/2011, *"Për mbrojtjen e mjedisit"*. Ky ligj mbron mjedisin dhe biodiversitetin në Shqipëri, rregullon përdorimin e tokës për bujqësi dhe siguron që kullotat që përdoren për bagëtitë të mos ndikojnë negativisht në zonat e mbrojtura dhe habitatet natyrore. Ligji përcakton kornizën për sigurimin e mbrojtjes me nivel të lartë të mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve për shëndetin e njeriut dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.[63]

59. Shih: https://faolex.fao.org/docs/pdf/alb211951.pdf
60. Shih: http://aku.gov.al/wp-content/uploads/2016/06/LIGJI-Nr.9441-per-qumshtin.pdf
61. Shih: https://faolex.fao.org/docs/pdf/alb113038.pdf
62. Shih:https://www.fao.org/faolex/results/details/en/c/LEX-FAOC132117/#:~:text=Law%20No.%2038/2013%20amending%20Law%20No.%209693%20on%20the%20Pasture%20Fund
63. Shih: https://faolex.fao.org/docs/pdf/alb112561.pdf

Me përparimin e saj drejt anëtarësimit në BE, Shqipëria po përafron legjislacionin bujqësor dhe blegtoral me rregulloret e BE-së për të siguruar akses në tregjet evropiane. Ky proces përfshin miratimin e standardeve të BE-së për sigurinë ushqimore, mirëqenien e kafshëve, praktikat e qëndrueshme bujqësore, dhe për aksesin në treg. Ligjet shqiptare për produktet e qumështit dhe ato blegtorale janë gjithnjë e më shumë në përputhje me ligjet e BE-së për shëndetin e kafshëve, kontrollet veterinare, gjurmueshmërinë, dhe standardet higjienike. Ndryshimet kryesore fokusohen në përmirësimin e sigurisë ushqimore, sigurimin e trajtimit human të kafshëve, nxitjen e bujqësisë dhe blegtorisë së qëndrueshme, dhe zbatimin e kontrolleve më të rrepta për shëndetin e kafshëve dhe inspektimet veterinare.

2.3 SHËRBIMET E MBËSHTETJES DHE KONTROLLIT

Sektori i prodhimit blegtoral, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në nenin 95 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) dhe në mbështetje të realizimit të programit të qeverisë, synon të analizojë, identifikojë dhe hartojë politika e strategji sektoriale për zhvillimin e blegtorisë. Këtu përfshihet drejtimi dhe mbështetja e përpjekjeve në nivel vendi dhe nivel lokal për plotësimin e kërkesave të tregut për prodhime blegtorale përmes përdorimit racional të burimeve dhe futjes së teknikave dhe teknologjive të reja në prodhim.[64] Sektori fokusohet në:

- Harmonizimin e legjislacionit me standardet e BE-së në kontekstin e politikave të zhvillimit dhe integrimit, përmes propozimit, hartimit, dhe zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjor e në fushën e blegtorisë.
- Hartimin e politikave dhe programeve për përmirësimin e mbarështimit dhe kafshëve dhe të prodhimit blegtoral.
- Përgatitjen e kuadrit ligjor të duhur për zbatimin e politikave të zhvillimit në sektorin e blegtorisë.
- Forcimin e sistemeve të monitorimit dhe zbatimin e standardeve të mirërritjes së kafshëve.
- Nxitjen dhe konsolidimin e sistemeve të qëndrueshme të prodhimit blegtoral me ferma të specializuara, komplekse industriale të prodhimit të vezëve dhe të mishit, si dhe të prodhimit të ushqimeve.
- Miradministrimin e burimeve gjenetike shtazore të kultivuara dhe autoktone në blegtori.
- Përmirësimin e sistemit të kontrollit, cilësisë dhe të tregtimit të materialeve racore, në përputhje me standardet.
- Vlerësimin e tendencave në zhvillimin e blegtorisë nëpërmjet studimeve, analizave mbi strukturën dhe përcaktimin e prioriteteve për prodhimin blegtoral.

Sektori i prodhimit blegtoral e ushtron veprimtarinë e tij mbi bazën e Ligjit nr. 9426, datë 6.10.2005, «Për mbarështimin e blegtorisë « (ndryshuar me ligjin nr. 9864, datë 28.01.2008) dhe disa ligje të tjera, ndër të cilët ligji nr. 10137, datë 11.05. 2009, për licencat, autorizimet dhe lejet dhe në Shqipëri, si dhe një varg aktesh nënligjore. Institucionet e përfshira në realizimin e objektivave në fushën e blegtorisë janë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e cila është autoriteti kompetent për veprimtaritë në fushën e blegtorisë nëpërmjet:
  - Sektorit të prodhimit blegtoral;
  - Specialistëve të blegtorisë në Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë;
  - Qendrave të transferimit të teknologjive bujqësore;
  - Shërbimeve këshillimore publike dhe/ose private.

Sektori i Prodhimit Blegtoral është përgjegjës për zhvillimin e qëndrueshëm të prodhimit blegtoral në vend nëpërmjet hartimit të legjislacionit, strategjive sektoriale, si dhe të politikave të zhvillimit dhe

64. Shih: https://www.bujqesia.gov.al/bujqesia-dhe-blegtoria/

programeve për mbrojtjen, përmirësimin dhe ruajtjen e cilësisë së burimeve gjenetike shtazore. Qëllimi i tij është që të promovojë rritjen e prodhimeve blegtorale, krijimin dhe përhapjen e vlerave racore dhe ruajtjen e diversitetit gjenetik të bagëtive në ferma. Sektori i Prodhimit Blegtoral është përgjegjës për:

- Zhvillimin e strategjisë dhe politikave për sektorin e blegtorisë;
- Monitorimin, vlerësimin dhe përditësimin sistematik të politikave dhe strategjive që lidhen me prodhimin blegtoral;
- Kryerjen e analizave të nevojshme për zhvillimin e politikave dhe krijimin e programeve për zbatimin e politikave të zhvillimit blegtoral me qëllim mbarështimin e mirë të bagëtive;
- Hartimin dhe harmonizimin e legjislacionit në sektorin e blegtorisë;
- Vlerësimin e progresit gjenetik për të përcaktuar rentabilitetin e racave, përmes caktimit të prioriteteve për strategjinë e menaxhimit të racave;
- Identifikimin e burimeve gjenetike autoktone e të kultivuara dhe propozimin e masave mbrojtëse për to;
- Monitorimin dhe zbatimin e legjislacionit për mbarështimin dhe përmirësimin gjenetik të bagëtive si dhe mbrojtjen dhe zhvillimin e burimeve gjenetike autoktone dhe zbatimin e masave në lidhje me standardet e mbarështimit të tyre.

Drejtoritë rajonale të bujqësisë (DRB): Në kuadër të drejtorive rajonale të bujqësisë, specialistët e blegtorisë (zootekinkët) ushtrojnë aktivitetin e tyre për të siguruar:

- zbatimin e legjislacionit në fushën e blegtorisë;
- plotësimin e kushteve për mbarështimin e qëndrueshëm të kafshëve të fermës;
- përmirësimin racor;
- ushqimet dhe të ushqyerit e bagëtive;
- tregtimin e materialeve racore.

Shërbimi zooteknik privat: Shërbimi zooteknik privat i ushtron funksionet e tij në fushën e riprodhimit të bagëtive. Në kuadër të tij ushtrojnë aktivitetin 480 teknikë të inseminimit, të certifikuar nga Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (shërbimi publik). Shërbimi zootenik privat angazhohet në ferma, biznese të tjera blegtorale dhe në biznese të mbarështimit të kafshëve. Programi i tij miratohet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Pesë Qendrat e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore (QTTB)[65] të vendosura në Fushë-Krujë, Shkodër, Vlorë, Lushnjë, dhe Korçë, u krijuan me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 515, datë 19.07.2006, «Për ristrukturimin e instituteve kërkimore-shkencore, në varësi të ministrisë së bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit.» Ndër to, QTTB Lushnjë është posaçërisht e fokusuar në perimet. Përgjegjësitë kryesore të QTTB-ve përfshijnë:

- identifikimin, testimin, përshtatjen dhe futjen, në praktikat bujqësore, të metodave dhe materialeve (inputeve) të reja;
- përgatitjen e paketave teknologjike për kulturat bujqësore kryesore dhe mbarështimin e bagëtive;
- kërkime dhe testime në ferma bujqësore për problemet e ngritura nga fermerët e rajoneve përkatëse;
- trajnime për specialistë të bujqësisë, fermerë, studentë të shkencave bujqësore dhe subjekte të tjera të interesuara;
- sigurimin e ekspertizës teknike për strukturat e shërbimit këshillimor dhe fermerët;
- demonstrimin e teknologjive të reja të kultivimit të kulturave bujqësore dhe mbarështimit të blegtorisë;
- përgatitjen dhe publikimin e materialeve informuese për specialistët e bujqësisë dhe fermerët;
- mbështetjen e hartimit të politikave nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në fushën e bujqësisë, ushqimit, mbrojtjes së konsumatorit dhe zhvillimit rural.

65. Shih: https://bujqesia.gov.al/qendrat-e-transferimit-te-teknologjive-bujqesore-qttb/

Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore në Fushë-Krujë dhe Korçë janë struktura për transferimin e teknologjive blegtorale në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (më parë MBUMK). QTTB-ja në Fushë-Krujë është qendër e referencës kombëtare (QRK) për:

- Kontrollin e ushqimit që përdoret në prodhim blegtoral;
- Kontrollin e materialeve racore (spermë, vezë, embrione);
- QTTB-të i kryejnë veprimtaritë e tyre në përputhje me politikat për zhvillimin e prodhimit blegtoral.

Shërbimi këshillimor: Shërbimi këshillimor është pjesë e strukturave të Drejtorive Rajonale të Bujqësisë (DRB), ku operojnë zooteknikë që ofrojnë këshilla dhe shërbime në nivel vendor (komune).

Këshilli i Blegtorisë: Këshilli i Blegtorisë është një organ këshillimor i caktuar nga Ministri për një mandat katërvjeçar, me mundësi rizgjedhjeje, në përputhje me nenin 73 të Ligjit Nr. 9864, datë 28.01.2008, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9426, datë 06.10.2005, 'Për Mbarështimin e Blegtorisë'". Ndër detyrat e Këshillit të Blegtorisë përfshihen:

- Këshillimi i Ministrit për politikat që kanë lidhje me blegtorinë;
- Dhënia e mendimeve për:
- politikat bujqësore që rregullojnë sektorin e blegtorisë;
- programet e zhvillimit afatgjatë;
- programet racore të propozuara për miratim;
- raportet vjetore për veprimtaritë që lidhen me programet racore;
- rregulloret e rëndësishme në sektorin e blegtorisë;
- njohjen e racave autoktone;
- ushqimet dhe ushqyerjen e bagëtive;
- ndryshimet në metodat ekzistuese ose futjen e metodave të reja për vlerësimin e potencialit racor dhe vlerësimin e bagëtive.

Masat legjislative: Sektori i Prodhimit Blegtoral, në kuadër të angazhimeve që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), synon të zbatojë një numër politikash që lidhen me miratimin e një numri nismash legjislative që synojnë përafrimin e legjislacionit kombëtar me standardet e BE-së.

Në kuadër të masave legjislative, procesi i harmonizimit të kornizës lidhore është fokusuar në hartimin e legjislacionit bazë për prodhimin blegtoral që lidhet me standardet zooteknike për bagëtitë e racës së pastër që përdoren për mbarështim. Këtu përfshihet edhe përcaktimi i kritereve për përdorimin e bagëtive me racë të pastër për qëllime riprodhimi, si edhe vendosja e standardeve zooteknike dhe e kushteve për tregtimin e materialeve për riprodhim, si dhe kriteret për përdorimin e racave të pastra për riprodhim natyror dhe/ose inseminim artificial dhe në lidhje me përdorimin e spermës së tyre.
Masat legjislative do të synojnë përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar në sektorin e blegtorisë me rregulloret e BE-së si dhe përmirësimin e bashkërendimit ndërinstitucional për zbatimin e tij.
Politikat aktuale të sektorit të prodhimit blegtoral fokusohen kryesisht në rritjen e numrit të krerëve të bagëtive (gjedhë dhe bagëti të imta) në fermat blegtorale, me qëllim konsolidimin e këtyre fermave dhe orientimin e tyre drejt tregut. Po kështu, mbështetja e prodhimit të bagëtive me racë të pastër synon të krijojë dhe të promovojë shoqatat për mbarështimin e bagëtive dhe krijimin e një tregu të brendshëm për kafshë me vlerë gjenetike të identifikuar.

Legjislacioni për prodhimin blegtoral

1. Ligji nr. 9426, datë 06.10.2005, "Për mbarështimin e blegtorisë", ndryshuar me Ligjin nr. 9864, datë 28.01.2008, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9426, datë 06.10.2005 "Për mbarështimin e blegtorisë", dhe me ligjin nr. 10137, datë 11.05.2009 ,"Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë».

2. Urdhër i Ministrit nr. 4, datë 09.09.2008, për miratimin e rregullores mbi "Standardet minimum të mbarështimit të kafshëve shtëpiake (standardet minimum të mbarështimit të gjedhit- viçave)".

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1708, datë 29.12.2008, "Për zbatimin e programeve për ruajtjen in-situ të racave autoktone të bagëtive të imta».

4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 436, datë 02.06.2010 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1634, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave 'Për përcaktimin e procedurave dhe të mënyrës së mbështetjes financiare, për ruajtjen e rezervës gjenetike të racës autoktone të buajve'».

5. Urdhër i Ministrit nr. 3, datë 05.08.2008, për miratimin e rregullores "Për certifikimin e kafshëve racëpastër të specieve të gjedhit, dhenve, dhive, kuajve, derrave racëpastër dhe hibridë, spermës, ovulave dhe embrioneve të tyre».

6. Urdhër i Ministrit nr. 1, datë 04.03.2009, për miratimin e rregullores "Për standardet për mbarështimin e derrave dhe pulave pjellëse».

7. Urdhër i Ministrit nr. 2 dt. 22. 07. 2008 për miratim rregullores "Për riprodhimin e kafshëve të fermës, prodhimin dhe tregtimin e materialeve racore"

8. Urdhër i Ministrit nr. 422, datë 17.12.2009, për miratimin e rregullores "Për kushtet për regjistrimin e riprodhuesve racëpastër të specieve të gjedhit, dhenve, dhive, kuajve, derrave racëpastër dhe hibridë në librin gjenealogjik».

9. Urdhër i Ministrit nr. 83, datë 16.03.2010, për miratimin e rregullores "Për organizatat e mbarështimit të kafshëve".

10. Urdhër i Ministrit nr. 300, datë 8.10.2010, për miratimin e rregullores "Për metodat e matjes dhe vlerësimit të prodhimit dhe tipareve të tjera si dhe metodat për vlerësimin e vlerave gjenetike të riprodhuesve racë-pastër të species së gjedhit».

11. Urdhër i Ministrit nr. 333, datë 17.11.2010, për miratimin e rregullores "Për metodat e matjes dhe vlerësimit të prodhimit dhe tipareve të tjera si dhe metodat për vlerësimin e vlerave gjenetike të riprodhuesve racë-pastër të dhenve dhe dhive».

12. Urdhër i Ministrit nr. 332, datë 17. 11. 2010, për miratimin e rregullores "Për metodat e matjes dhe vlerësimit të prodhimit dhe tipareve të tjera si dhe metodat për vlerësimin e vlerave gjenetike të riprodhuesve racë-pastër të derrave dhe derrave hibridë"

13. Urdhër i Ministrit nr. 303, datë 04.11.2011, për miratimin e rregullores "Për standardet zooteknike të kafshëve riprodhuese racëpastër të species së gjedhit".

14. Urdhër i Ministrit nr. 318, datë 14.11.2011, për miratimin e rregullores "Për standardet zooteknike të kafshëve riprodhuese racëpastër të specieve dhen dhe dhi".

15. Urdhër i Ministrit nr. 6, datë 09. 01. 2012, për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e kritereve për përdorimin e kafshëve racëpastër të llojit gjedh për qëllime riprodhimi".

16. Urdhër i Ministrit nr. 360, datë 27. 12. 2011, për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e kritereve për përdorimin e kafshëve racëpastër të llojit dhen dhe dhi për qëllime riprodhimi".

17. Urdhër i Ministrit nr. 237 datë 26.07.2012, për miratimin e rregullores "Për standardet zooteknike të derrave racëpastër për riprodhim».

18. Urdhër i Ministrit nr. 298, datë 10.10.2012, për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e kritereve për përdorimin e derrave racëpastër për qëllime riprodhimi».

19. Urdhër i Ministrit nr. 346, datë.13.12.2012, për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e kritereve për përdorimin e derrave hibridë për qëllime riprodhimi».

Shërbimi veterinar në Shqipëri rregullohet me Ligjin nr. 10465, miratuar më 29.09.2011, i cili synon mbrojtjen e shëndetit dhe mirërritjes së kafshëve si dhe mbajtjen nën kontroll të sëmundjeve ngjitëse tek kafshët. Autoriteti kryesor në këtë fushë është Drejtoria e Shërbimit Veterinar (DSHV), në përgjegjësitë e së cilës përfshihen:

- **Hartimi i politikave dhe strategjive për shëndetin e kafshëve përmes:**
  - Krijimit të programeve për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse tek kafshët;
  - Propozimit të përmirësimeve në legjislacionin veterinar në përputhje me legjislacionin veterinar të Bashkimit Evropian;
  - Monitorimit të situatës epidemiologjike të sëmundjeve ngjitëse dhe informimit të institucioneve përkatëse.

- **Mbikëqyrja e veprimtarive veterinare përmes:**
  - Kontrollimit të kushteve sanitare veterinare dhe sigurisë ushqimore për kafshët;
  - Regjistrimit të fermave dhe stabilimenteve të

bagëtive, enteve që tregtojnë kafshë, dhe personave që transportojnë kafshë;
- Mbikëqyrjes së punës së veterinerëve zyrtarë dhe monitorimit të shëndetit të kafshëve në hapësirat rurale dhe publike.

- **Shërbimi Veterinar Rajonal:**
  - Shërbimi veterinar rajonal funksionon në varësi të Drejtorive Rajonale të Bujqësisë, dhe ka përfaqësues në secilin prej qarqeve të Shqipërisë. Ata kryejnë funksione si kontrollimi i kushteve sanitare, mbrojtja nga sëmundjet ngjitëse, dhe monitorimi i kushteve të mbarështimit të kafshëve.

- **Sistemi i identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve:**
  - Ky sektor është përgjegjës për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve dhe të fermave blegtorale, si edhe për zbatimin e legjislacionit kombëtar në lidhje me këto procese.

- **Kontrolli i tregtimit dhe transportimit të kafshëve:**
  - Shërbimi veterinar mbikëqyr tregtimin dhe transportimin e kafshëve dhe të produkteve embrionike, për të siguruar përmbushjen e kritereve të sigurisë dhe mirëqenies së kafshëve.

- **Monitorimi dhe vënia** nën kontroll e sëmundjeve ngjitëse:
  - Shërbimi veterinar është përgjegjës për monitorimin e sëmundjeve parazitare dhe infektive dhe zbatimin e masave për parandalimin dhe mbajtjen nën kontroll të tyre.
  - Në këtë kontekst, DSHV-ja është një strukturë qendrore për garantimin e shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjen e shëndetit të publikut, si edhe për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të blegtorisë.

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) është qendra laboratorike kombëtare e referencës për shërbimet veterinare (sipas ligjit nr.10465). Ai është në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe përgjegjës për hartimin e strategjive të gjurmimit dhe luftimit të sëmundjeve infektive, parazitare në kafshët e tokës, të ujit dhe shpendë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Veterinar (DSHV). Instituti kryen diagnostikime veterinare dhe analiza profilaktike të shëndetit të kafshëve në përputhje me programin kombëtar. Ai kryen gjithashtu programe analizash për kontrollimin e sëmundjeve epizootike, barnave veterinare, si edhe diagnostikime të sëmundjeve të përgjithshme. Po ashtu, ai kryen analiza të produkteve ushqimore me origjinë shtazore në bashkëpunim me Institutin e shëndetit Publik. ISUV-ja bashkëpunon me FAO-n, OBSH-në dhe OIE-në, si dhe me laboratorë të tjerë reference për konfirmimin e sëmundjeve të ndryshme infektive.

Departamenti i Shëndetit të Kafshëve në ISUV, përbëhet nga gjashtë sektorë: ai i bakteriologjisë, virologjisë, parazitologjisë, mykologjisë, epidemiologjisë veterinare dhe i kontrollit të barnave veterinare. Ky departament ka 28 punonjës, prej të cilëve 23 specialistë dhe pesë teknikë laborantë. Pjesë e ISUV-së është gjithashtu edhe sektori i prodhimit të biopreparateve, me 11 punonjës: tre specialistë dhe tetë teknikë laboratori. ISUV zbaton sistemin e menaxhimit të cilësisë bazuar në standardin ISO 17025:2005. Departamenti i Menaxhimit të Cilësisë në ISUV përbëhet nga pesë specialistë dhe 13 referentë cilësie (nga një për secilin sektor të ISUV-së). Deri më tani, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (trupa kombëtare e akreditimit) ka akreditуar gjashtë analiza, të cilat janë akreditуar edhe nga një trupë e huaj akreditimi (Accredia – organi akreditues kombëtar në Itali).

Laboratori Shtetëror i Kontrollit Veterinar (LSHKV) është pjesë e shërbimit veterinar dhe është përgjegjës për kontrollimin e produkteve mjekësore veterinare (barna dhe bioprodukte), të prodhuar në vend ose të importuara. Biopreparatet në vend prodhohen nga njësi të autorizuara nga ministria dhe përdoren pasi të jenë kontrolluar nga LSHKV-ja. Tarifat për kryerjen e analizave përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat.

Ligjet bazë në fushën e veterinarisë

Ligji nr. 10465, datë 29.09.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë":
- Ky ligj përcakton parimet bazë për mbrojtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së kafshëve sipas standardeve ndërkombëtare të Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve (WOAH, më parë e njohur si OIE) dhe të Bashkimit Evropian.
- Rregullon dhe organizon shërbimet veterinare, duke përcaktuar përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat për mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve.
- Garanton mbrojtjen e shëndetit publik në Shqipëri nga sëmundjet zoonotike të transmetueshme nga kafshët, në përputhje me legjislacionin e BE-së.

Ligji nr. 8702, datë 01.12.2000, "Për sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve»:

- Synon të rregullojë lëvizjet e bagëtive përmes identifikimit individual të tyre.
- Vendos regjistrimin e fermave blegtorale dhe u cakton atyre një numër unik regjistrimi.
- Siguron shkëmbimin e shpejtë dhe të saktë të të dhënave për vendndodhjen e kafshëve për qëllime veterinare, zooteknike dhe statistikore.
- Rregullon marrëdhëniet midis institucionit shtetëror përgjegjës dhe pronarëve të fermave blegtorale. tate institution and livestock farm owners.

Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM)

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 646 i vitit 1995, «Për adaptimin e direktivave të EU në fushën e produkteve të detit «.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 320, datë 19.03.2008, «Për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave blegtorale».

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 198, datë 19.02.2009, «Për një ndryshim në VKM nr.320, datë 19.03.2008, Për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave blegtorale».

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 831, datë 29.07.2009 «Për një shtesë në VKM nr.320, datë 19.03.2008, Për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave blegtorale».

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 08.05.2013, «Për dëmshpërblimin për kafshët e eliminuara».

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 230, datë 20.03.2013, «Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standardeve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore».

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 02.04.2013 « Për ngritjen e grupit ndërministror të punës për koordinimin dhe kontrollin e fushatës së vaksinimit oral kundër sëmundjes së tërbimit në Shqipëri».

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 283, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në tokë bujqësore" (ndryshuar me VKM nr. 592, datë 01.07.2015; VKM nr. 956, datë 25.11.2015; VKM nr. 734, datë 20.10.2016; VKM nr. 373, datë 05.06.2024). Ky vendim përcakton kuadrin ligjor për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në tokë bujqësore. Ai përcakton llojet e objekteve të lejuara, duke specifikuar se cilat ndërtime lejohen brenda zonave bujqësore, rregullat dhe kriteret teknike për të siguruar qëndrueshmërinë e mjedisit, sigurinë ushqimore, dhe përmbushjen e standardeve kombëtare dhe të BE-së, si dhe procedurat për marrjen e lejeve dhe miratimeve nga autoritetet përkatëse.

Në kuadër të nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në lidhje me përafrimin e legjislacionit dhe të nenit 95 «Bujqësia dhe sektori agro-industrial», janë miratuar një varg aktesh nënligjore në zbatim të Ligjit nr. 9308, datë 04.11.2004, «Për shërbimin dhe inspektoratin veterinar» dhe më vonë, pas shfuqizimit të tij, në zbatim të Ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011 «Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë.» Këto akte synojnë përmirësimin e standardeve për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve, sidomos ndaj sëmundjeve zootonike me ndikim negativ në shëndetin e njerëzve, si dhe forcimin e kontrollit zyrtar përmes forcimit të mbrojtjes së shëndetit publik dhe të interesave të konsumatorëve.

Katër Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB),[66] në Lushnjë, Korçë, Tiranë, dhe Shkodër (që përfshin edhe Malësinë e Madhe) operojnë nën Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 13.03.2018, «Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor." Këto agjenci rajonale synojnë të bëhen aktore kyçe në zhvillimin e një sektori konkurrues dhe të qëndrueshëm bujqësor në vend, duke punuar në partneritete afatgjata me përfituesit. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të tyre përfshijnë:

- të ofrojnë informacion dhe këshillim për zhvillimin teknik e teknologjik të fermave bujqësore, me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë në bujqësi;

66. Shih: https://bujqesia.gov.al/drejtorite-e-bujqesise/, dhe https://www.bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/06/2.1-struktura-AREB-TIRANE.doc

- të ofrojnë informacion dhe të asistojnë fermerët për të përfituar nga skemat mbështetëse kombëtare, IPARD-i dhe projekte të tjera në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural;
- të nxisin dhe të ndihmojnë krijimin e funksionimin e formave të ndryshme të kooperimit të fermerëve;
- të organizojnë dhe të kryejnë trajnimin profesional të fermerëve në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural;
- të sigurojnë informacion për standardet lidhur me mjedisin, cilësinë, marketingun, bujqësinë organike, produktet me tregues gjeografikë;
- të informojnë dhe të këshillojnë fermerët për përzgjedhjen dhe përdorimin e makinerive e të pajisjeve bujqësore, duke ofruar asistencë teknike pa pagesë.

Zyra lokale e AREB-it në Malësi të Madhe përbëhet nga dhjetë punonjës të ekstensionit bujqësor (tri gra dhe shtatë burra).

Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB)[67] është përgjegjës për garantimin e shëndetit dhe sigurisë së kafshëve, bimëve dhe prodhimeve bujqësore në Shqipëri. Ai operon në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe luan rol kyç në mbrojtjen e shëndetit të publikut, promovimin e qëndrueshmërisë bujqësore dhe lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare të prodhimeve bujqësore dhe ushqimore. Ndër përgjegjësitë kryesore të AKVMB-së përfshihen:

- Shërbimet veterinare: Monitorimi dhe kontrollimi i shëndetit të kafshëve, parandalimi i përhapjes së sëmundjeve ngjitëse, dhe garantimi i sigurisë ushqimore në produktet me prejardhje shtazore.
- Mbrojtja e bimëve: Zbatimi i masave fitosanitare për parandalimin dhe kontrollimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve që mund të dëmtojnë prodhimin bujqësor.
- Roli rregullator për pesticidet dhe plehrat: Mbikëqyrja e importit, shpërndarjes, dhe përdorimit të pesticideve dhe plehrave, duke siguruar përmbushjen e standardeve të sigurisë.
- Siguria ushqimore dhe inspektimi: Kryerja e inspektimeve të fermave, mjediseve të përpunimit ushqimor, dhe tregjeve, për të siguruar që produktet përmbushin standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë ushqimore.
- Kontrolli kufitar dhe biosiguria: Menaxhimi i inspektimeve kufitare veterinare dhe fitosanitare për parandalimin e hyrjes së dëmtuesve, sëmundjeve dhe produkteve të pasigurta ushqimore në vend.
- Legjislacioni dhe zbatimi i ligjit: Hartimi dhe zbatimi i ligjeve, politikave dhe rregulloreve që lidhen me shërbimet veterinare dhe mbrojtjen e bimëve.
- Ndërtimi i kapaciteteve dhe trajnimet: Ofrimi i trajnimeve dhe mbështetjes për fermerët, veterinerët dhe specialistët bujqësorë për përmirësimin e praktikave më të mira në menaxhimin e shëndetit të bimëve dhe të kafshëve.

AKVMB-ja e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe është organizuar në nivel qendror nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme dhe në nivel rajonal, nëpërmjet katër drejtorive rajonale të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve në Elbasan, Vlorë, Shkodër, dhe Tiranë. Drejtoritë rajonale veprojnë brenda fushave të tyre të përgjegjësisë dhe kryejnë këto detyra:

- vlerësojnë nevojat dhe problematikat që lidhen me shërbimet veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve, dhe i propozojnë zgjidhje Drejtorisë së Përgjithshme;
- planifikojnë nevojat për shërbime veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve dhe ia paraqesin ato Drejtorisë së Përgjithshme;
- koordinojnë dhe monitorojnë ofrimin e shërbimeve veterinare dhe të mbrojtjes së bimëve në territorin e tyre;
- përgatisin raporte për marrjen e kampioneve, materialeve patologjike dhe rezultateve të analizave për sëmundje të dyshuara dhe konfirmuara;

67. Shih: https://akvmb.gov.al/

- hartojnë raporte periodike për shkallën e infeksionit të bimëve dhe statusin e produkteve bimore;
- detajojnë dhe zbatojnë planet e punës të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- lëshojnë dokumente dhe certifikata sipas dispozitave ligjore, akteve nënligjore dhe autorizimeve të Drejtorisë së Përgjithshme;
- kryejnë detyra të tjera të ngarkuara sipas ligjit ose sipas urdhrave të Drejtorisë së Përgjithshme.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)[68] është një institucion shtetëror në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përgjegjës për inspektime dhe menaxhim në fushat e mbrojtjes së konsumatorit, mbrojtjes së bimëve dhe mbarështimit të kafshëve. AKU funksionon sipas Ligjit nr. 10433, datë 16.06 2011, «Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë», konkretisht neni 7, «Parimi i programit të inspektimeve». Koha e kryerjes së inspektimeve përcaktohet në programin vjetor të inspektimeve, por kryhen edhe inspektime rastësore kur kërkohet nga ligji. Neni 4 i të njëjtit ligj përcakton qëllimet e inspektimeve, ku përfshihen: i) vlerësimi i respektimit të kërkesave ligjore; ii) dokumentimi i praktikave të mira në respektimin e kërkesave ligjore; iii) këshillimi i subjektit të inspektuar për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore; iv) urdhërimi i korrigjimit të shkeljeve ligjore dhe eliminimit të pasojave të tyre; dhe, v) dhënia e dënimeve dhe marrja me masave administrative për shmangien e rreziqeve ndaj interesit publik.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) në Shqipëri është organi rregullator përgjegjës për garantimin e sigurisë dhe cilësisë ushqimore dhe respektimin e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare. AKU mbikëqyr të gjithë hallkat e furnizimit ushqimor, që nga prodhimi dhe përpunimi, deri tek shpërndarja dhe konsumi, dhe synon mbrojtjen e shëndetit publik dhe sigurisë së ushqimeve. Detyrat kryesore të tij përfshijnë:

- mbikëqyrjen dhe inspektimin e prodhimit, përpunimit të ushqimit dhe të mjediseve të shpërndarjes;

Gratë luajnë role kyçe në prodhim, por u mungon mbështetja për të përmbushur standardet e sigurisë ushqimore, gjë që kufizon qasjen në treg.

- garantimit i respektimit të rregulloreve dhe standardeve të sigurisë ushqimore;
- kryerja e kontrolleve të cilësisë së ushqimeve dhe testimeve për të parandaluar kontaminimin dhe garantuar sigurinë e ushqimeve;
- zbatimin e ligjeve për sigurinë ushqimore dhe të rregulloreve të vendosura nga qeveria;
- koordinimin me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare për harmonizimin e praktikave të sigurisë ushqimore;
- udhëzimin dhe trajnimin e bizneseve dhe palëve të interesit në industrinë ushqimore në lidhje me praktikat më të mira;
- lëshimin e certifikatave dhe miratimeve për prodhime ushqimore, sipas ligjit.

Certifikimi HACCP[69] është një standard ndërkombëtar që bazohet në parimet e *FAO/WHO Codex Alimentarius Commission* (Komisioni *Codex Alimentarius* i FAO-s dhe OBSH-së), dhe përfshin një varg të plotë parimesh mbi higjienën dhe sigurinë ushqimore. Ai është një sistem parandalues për menaxhimin e sigurisë ushqimore, që është i detyrueshëm për të gjitha bizneset ushqimore, në përputhje me Rregulloret Evropiane (EC) 178/2002[70]

68. Shih: https://aku.gov.al/
69. Shih: https://aku.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Udhezim_Nr.20.pdf
70. Shih: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32002R0178

dhe 852/2004[71], si dhe me Udhëzimin Kombëtar nr. 20 20, datë 25.11.2010, të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.[72] Procesi i certifikimit HACCP zakonisht zgjat nga 14 deri 30 ditë, në varësi të kërkesave konkrete të biznesit përkatës, dhe përfshin:

- Vizitë tek biznesi: Biznesi vizitohet nga një kompani konsulente e specializuar në vlerësimin e proceseve të punës dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësime dhe përshtatje me qëllim plotësimin e standardeve të HACCP-it.
- Përgatitja e dokumentacionit: Biznesi duhet të përgatisë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, ku përfshihen evidenca, procedura dhe plane që lidhen me sigurinë dhe higjienën ushqimore.
- Krijimi i sistemeve për mbajtjen e dokumentacionit: Duhet të ngrihet një sistem për mbajtjen e dokumentacionit dhe të dhënave, për të garantuar që procedurat e sigurisë ushqimore të jenë të dokumentuara siç duhet dhe të gjurmueshme.
- Inspektimi nga organi certifikues: Organi certifikues inspekton biznesin për të siguruar plotësimin e të gjitha kritereve HACCP dhe kontrollon si dokumentacionin, ashtu edhe praktikat e ndjekura.
- Lëshimi i certifikatës: Pas inspektimit të suksesshëm, trupa certifikuese lëshon certifikatën HACCP, që konfirmon se biznesi përmbush standardet e sigurisë ushqimore.

2.4 KONSTATIMET E STUDIMIT

Bazuar në punën në terren, vrojtimet e drejtpërdrejta dhe intervistat e kryera me aktorë kyç të zinxhirit të vlerës – përfshirë prodhues, përpunues, dhe specialistë teknikë në produktet e bulmetit – u identifikuan një numër konstatimesh të rëndësishme. Këto konstatime theksojnë si mundësitë për rritje dhe qëndrueshmëri në zinxhirin e vlerës të qumështit, ashtu edhe kufizimet që vazhdojnë të ekzistojnë dhe problematikat gjinore që duhen trajtuar..

Mundësitë:

Investimet në infrastrukturë, si në sisteme për grumbullimin e qumështit, kazanë ftohës, dhe laboratorë për analiza, janë një mundësi e rëndësishme për përmirësimin e cilësisë së qumështit, garantimin e sigurisë ushqimore dhe respektimin e standardeve shëndetësore.

Forcimi i miradministrimit në zinxhirin e vlerës dhe vendosja e mekanizmave të gjurmueshmërisë mund të ndihmojë që të trajtohen dobësitë strukturore në zinxhirin e furnizimit të qumështit. Këto masa do të kontribuonin që të ketë më shumë transparencë, garantim të cilësisë dhe qëndrueshmëri afatgjatë të sektorit.

Zgjerimi i furnizimit me qumësht nga blegtorët e zonës do të shtonte edhe kapacitetin prodhues të baxhove ekzistuese, si Veleçiku dhe Agro Reçi. Ky zgjerim mund të diktohet nga tregu, i mbështetur nga preferenca e spikatur e konsumatorëve për produkte bulmeti të vendit, dhe ka potencial që të vazhdojë edhe pas projektit.

Praktikat më të mira ekzistuese në blegtori, si stalla moderne që menaxhohet nga Veleçiku, shërbejnë si modele për t'u ndjekur nga fermerët e vegjël në zonë, duke ofruar shembuj praktikë të prodhimit të cilësisë së lartë që mund t'i arrijnë në fermat e tyre.

Përfshirja e grave në të gjithë zinxhirin e vlerës – që nga kujdesi për bagëtitë, mjelja dhe deri tek dorëzimi i qumështit – përfaqëson një vlerë të rëndësishme, por të pashfrytëzuar. Gratë kontribuojnë aktivisht në punët e përditshme, por ato shpesh nuk kanë akses në vegla, pajisje dhe nuk kanë pushtet vendimmarrës. Me trajnim dhe mbështetje të posaçme, gratë mund të shtojnë produktivitetin e tyre, të përmirësojnë standardet e cilësisë dhe të fitojnë më shumë kontroll mbi të ardhurat dhe burimet.

71. Shih: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32004R0852
72. Shih: https://faolex.fao.org/docs/pdf/alb144203.pdf

Zbatimi më i mirë i praktikave të mira blegtorale nga fermerët e vegjël ofron potencial si për përmirësimin e cilësisë, ashtu edhe për shtimin e prodhimit. Ndërhyrjet e fokusuara në lidhje me kujdesin për bagëtitë, higjienën, menaxhimin e mjedisit dhe aftësitë social-ekonomike, mund të rrisin qëndrueshmërinë dhe aftësinë e përballimit të situatave.

Mundësi konkrete ekzistojnë në këto fusha:

- **Kujdesi për bagëtitë** – sigurimi i ushqimit të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm, kujdesi veteriner dhe trajtimi human i bagëtive.

- **Higjiena e mjeljes** – nxitja e pastërtisë në procesin e mjeljes dhe pajisje për të garantuar sigurinë e produktit.

- **Menaxhimi i mjedisit** – zbatimi i sistemeve të qëndrueshme për menaxhimin e mbetjeve dhe të ujit.

- **Menaxhimi social-ekonomik** – rritja e kapaciteteve të blegtorëve në planifikimin e biznesit, buxhetim dhe akses në tregje.

Kufizimet:

Një pjesë e mirë e veprimtarive të blegtorisë së qumështit vazhdojnë të jenë informale. Shumë prodhues – veçanërisht gratë – nuk janë të regjistruara në zyrat tatimore apo institucionet vendore. Si rezultat, ato janë të përjashtuara nga sistemet mbështetëse, si subvencionet, sigurimet shëndetësore, skemat e pensionit dhe programe të tjera kombëtare ose të financuara nga donatorët.

Fermerët e vegjël që kanë më pak se dhjetë krerë gjedhë, ose më pak se 100 krerë bagëti të imta, nuk përmbushin kriteret për t'u përfshirë në skemën e mbështetjes së bujqësisë për vitin 2025.[73] Ky përjashtim pakëson aksesin e tyre në mbështetje financiare me rëndësi për ta. Përveç kësaj, zinxhiri i furnizimit me qumësht karakterizohet nga një nivel i lartë informaliteti, shërbime të kufizuara ekstensioni dhe administrim i dobët – sidomos në fusha si gjurmueshmëria e qumështit dhe në zbatimin e detyrueshëm të rregulloreve të kontrollit të cilësisë.

Sigurimi i cilësisë së qumështit të papërpunuar është i dobët. Shumë ferma nuk mbajnë dokumentacionin e duhur dhe metodat e kampionimit janë të vjetruara dhe jokonsistente. Në baxho nuk kryhen analiza laboratorike dhe mjelja shpesh kryhet me dorë, me mjete të vjetruara, që shton rrezikun e kontaminimit. Në zonat e thella, sistemet e pazhvilluara të grumbullimit të qumështit dhe mungesa e kazanëve ftohës komprometon sigurinë ushqimore të qumështit. Luhatjet sezonale në prodhim dhe furnizimi jokonsistent me qumësht kufizojnë më tej kapacitetet prodhuese, sidomos në baxhot e vogla lokale.

Mungesa e përgjithshme e ndërgjegjësimit dhe e njohurive teknike ndër fermerët në lidhje me praktikat e mira blegtorale kontribuon në sasi dhe cilësi të ulët të prodhimit të qumështit, sidomos ndër gratë blegtore. Niveli i ulët i higjienës gjatë mjeljes, njohja dhe kuptimi i kufizuar i standardeve të sigurisë ushqimore, dhe menaxhimi joefikas i mbetjeve, janë mjaft të përhapura. Kjo është sidomos e dukshme në fermat e bagëtive të imta. Gratë në zinxhirin e vlerës punojnë në kushte higjienike të këqija dhe me orar të zgjatur. Ato nuk kanë kontroll mbi asetet e prodhimit dhe kanë akses të kufizuar në pajisje që do të përmirësonin efikasitetin e punës. Po kështu, angazhimi i të rinjve në blegtori është minimal, kryesisht për shkak të nivelit të lartë të migracionit dhe mungesës së shtysave të posaçme për ta, gjë që vështirëson qëndrueshmërinë afatgjatë të sektorit.

Çështje të Pabarazisë Gjinore dhe të Përfshirjes së Grave në Zinxhirin e Vlerës

Përveç kufizimeve social-ekonomike dhe institucionale të përshkruara më sipër, rritja e sektorit të qumështit/bulmetit në Malësi të Madhe pengohet edhe nga ekzistenca e barrierave specifike gjinore. Në informacionet e marra nga intervistat në terren dhe diskutimet në grupe vihen në dukje pabarazitë gjinore që vazhdojnë të ekzistojnë në të gjitha fazat e zinxhirit të vlerës.

Gratë luajnë rol të rëndësishëm në të gjitha fazat e zinxhirit të vlerës të qumështit – si mbarështimi i bagëtive, mjelja dhe transportimi i qumështit në qendrat e grumbullimit dhe baxhot përpunuese të qumështit. Me gjithë rolin e tyre qendror, gratë kanë kontroll të kufizuar mbi asetet prodhuese, nuk kanë autoritet vendimmarrës dhe akses në inpute kritike, si pajisje moderne, trajnim apo shërbime financiare. Kontributet e tyre shpesh nënvlerësohen dhe nuk shpërblehen sa duhet.
Të dhënat tregojnë se gratë zakonisht përdorin ndërmjetësit – kryesisht burra – për shitjen e qumështit,

73. Shih: https://azhbr.gov.al/wp-content/uploads/2025/03/vendim-2025-03-06-150.pdf

Bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet aktorëve të ndryshëm është thelbësor për avancimin e Zinxhirit të Vlerës së Qumështit në Malësi të Madhe, duke u mundësuar grave fermere të përfitojnë nga zgjidhjet për sfidat vendore dhe të kenë akses në mundësitë e tregjeve në zhvillim.

negocimin e çmimeve dhe marrjen e vendimeve për biznesin. Kjo varësi përforcon përjashtimin e tyre nga planifikimi financiar, lidhjet me tregun dhe njohjen e tyre formale si aktore ekonomike. Gjithashtu, gratë rrallë përfaqësohen në strukturat e kooperativave ose në rrjetet vendore të fermerëve, gjë që kufizon dukshmërinë e tyre dhe aftësinë për të advokuar për të drejtat e tyre. Gratë zotërojnë aftësi blegtorale bazë shumë të mira, por u mungojnë mundësitë për përmirësimin e aftësive teknike, sidomos për sa i përket shëndetit të bagëtive, standardeve të higjienës, dhe kompetencave sipërmarrëse.

Mungesa e programeve trajnuese të posaçme dhe e aksesit në vegla dhe mjete, jo vetëm pengon produktivitetin, por edhe rrit ngarkesën e punës së tyre dhe përforcon barrën gjinore të punës. Ky problem ndërlikohet më tej nga vështirësitë demografike të krijuara nga emigrimi i të rinjve nga zonat rurale. Eksodi i brezave të rinj pakëson forcat e punës të disponueshme në blegtori dhe krijon një boshllëk në përcjelljen e njohurive nga brezi në brez. Marrë së bashku, këta faktorë kërcënojnë qëndrueshmërinë afatgjatë dhe barazinë gjinore në zinxhirin e vlerës të qumështit në zonë.

Mundësitë e Financimit për Blegtorët

Aksesi në financim mbetet një nga pengesat më kryesore për blegtorët e vegjël në Malësi të Madhe. Për shumë familje në zonat rurale, blegtoria dhe prodhimi i qumështit është burimi parësor ose i vetëm i të ardhurave, ku fitimet varen nga shitja e qumështit të tyre tek baxhot lokale. Megjithatë, një pjesë e madhe e këtyre prodhuesve – sidomos ata që kanë më pak se dhjetë krerë gjedhë ose 100 krerë bagëti të imta – përballen me vështirësi të mëdha financiare.

Kjo situatë vështirësohet më tej nga përjashtimi i tyre prej skemës kombëtare të mbështetjes së bujqësisë për vitin 2025, për shkak të mosplotësimit të kritereve të caktuara për subvencione direkte dhe asistencë institucionale. Informaliteti në zinxhirin e furnizimit me qumësht dhe mungesa e administrimit formal të tij – sidomos për sa i përket gjurmueshmërisë dhe zbatimit të detyrueshëm të standardeve të cilësisë – pakësojnë mundësitë për të siguruar financim të jashtëm.

Një nga barrierat më kryesore është mungesa e kontratave formale midis blegtorëve dhe baxhove, që e bën të vështirë për prodhuesit të demonstrojnë qëndrueshmërinë e bizneseve të tyre. Për shkak të mungesës së marrëveshjeve të strukturuara, çmimeve transparente dhe dokumentacionit të prodhimit, fermerët e vegjël shpesh konsiderohen si huamarrës me risk nga institucionet financiare. Në këtë kontekst, mikrokredia ka dalë si një mekanizëm i rëndësishëm alternativ financimi. Institucionet e mikrofinancimit ofrojnë kredi të vogla, të përballueshme, që janë më të përshtatshme për fermerët që nuk kanë kolateral, regjistrim formal të biznesit, apo histori krediti. Këto hua mund të përdoren për të blerë vegla dhe mjete të rëndësishme, për të investuar në infrastrukturë, apo për të zgjeruar prodhimin. Megjithatë, ka disa kufizime që pengojnë efektivitetin e mikrokredisë në zonat rurale. Së pari, ndërgjegjësimi për ekzistencën e produkteve të mikrofinancës mbetet i ulët, sidomos në zonat e thella dhe ato malore. Së dyti, normat e interesit të ofruara nga institucionet e mikrokredisë shpesh janë më të larta se ato të bankave tradicionale, që e shton barrën financiare të fermerëve të vegjël. Së treti, shumë fermerë (sidomos gra fermere) kanë njohuri financiare të kufizuara dhe nuk kanë njohuritë e nevojshme për të vlerësuar kushtet e kredisë, menaxhuar shlyerjen e kësteve, apo për të vlerësuar kthimin e investimit, gjë që e shton rrezikun e futjes në borxh më tej.

Për t'i trajtuar këto probleme kërkohet mbështetje e fokusuar për rritjen e ndërgjegjësimit, ndërtimin e kapaciteteve dhe zhvillimin e produkteve financiare të posaçme. Duke përmirësuar përfshirjen financiare të tyre, blegtorët e vegjël – sidomos gratë – mund të shtojnë produktivitetin, qëndrueshmërinë dhe pavarësinë afatgjatë ekonomike të tyre.

2.5 REKOMANDIME PËR FORCIMIN E ZINXHIRIT TË VLERËS TË QUMËSHTIT

Për çlirimin e potencialit të plotë të sektorit të qumështit në Malësi të Madhe dhe për të siguruar zhvillimin e tij përfshirës dhe të qëndrueshëm, rekomandohen një varg ndërhyrjesh. Këto veprime synojnë përmirësimin e produktivitetit, rritjen e cilësisë së qumështit, promovimin e barazisë gjinore, zgjerimin e aksesit në financim dhe forcimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të sektorit.

1. Forcimi i zbatimit të praktikave të mira blegtorale

Duhet të organizohen rregullisht programe trajnimi dhe për ndërtimin e kapaciteteve të blegtorëve të vegjël – veçanërisht të grave – me fokus në praktikat më të mira në kujdesin për kafshët, higjienën e mjeljes, menaxhimin e mbetjeve, dhe mirëqenien e bagëtive. Përveç kësaj, duhet të krijohen edhe ferma pilot (me pronare gra) për të demonstruar përdorimin e pajisjeve moderne, strehimin e përshtatshëm dhe proceset higjienike të mjeljes. Këto ferma pilot mund të shërbejnë si shembuj pozitivë për nxitjen e përdorimit më të gjerë të praktikave të mira blegtorale.
Grave blegtore duhet t'u mundësohet akses në vegla bazë dhe pajisje moderne, si makineri mjelëse, kazanë ftohës, doreza, dhe kontejnerë të sigurt për ruajtjen e qumështit, përmes skemave të mikrokredisë dhe partneriteteve me bashkinë. Mbështetja në veçanti e grave me këto lloj pajisjesh jo vetëm që do të shtojë produktivitetin, por edhe do të pakësojë barrën e punës fizike të kryer prej tyre.

2. Përmirësimi i infrastrukturës dhe i sistemeve të kontrollit të cilësisë së qumështit

Investimet në infrastrukturë janë me rëndësi thelbësore për përmirësimin si të sasisë ashtu edhe të cilësisë së qumështit. Ngritja e një laboratori për kryerjen e analizave të qumështit në baxho është një masë e rëndësishme për të siguruar përmbushjen e standardeve të sigurisë si dhe për t'i fuqizuar gratë me aftësitë dhe kapacitetet për të kryer analiza të cilësisë. Kjo duhet të shoqërohet me përmirësime në sistemin e mbledhjes së qumështit të papërpunuar – sidomos në zonat malore ku transporti është i ngadalshëm dhe qumështi mund të prishet.

Futja e një sistemi higjienik dhe eficient për transportimin e qumështit dhe pajisja e fermave me kazanë ftohës do të ndihmojë në minimizimin e humbjeve pas mjeljes dhe do të ruajë integritetin e produktit në të gjithë zinxhirin furnizues. Për të siguruar që gratë blegtore – të cilat shpesh merren me blegtori të shkallës së vogël dhe me qumështin – të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga këto përmirësime, duhet të ofrohet mbështetje e posaçme për shtimin e aksesit të tyre në pajisje ftohëse në fermë dhe sisteme transporti të përbashkëta. Këtu përfshihen subvencionet për cisterna ftohëse ose për përdorimin e përbashkët të kazanëve ftohës nga fermat e drejtuara nga gratë, forcimi i kooperativave të grave, dhe sigurimi i pjesëmarrjes së tyre në trajnime teknike për higjienën, cilësinë e qumështit dhe përdorimin e infrastrukturës.

3. Zgjerimi i aksesit të blegtorëve të vegjël në produkte financiare

Është me rëndësi thelbësore që blegtorët e vegjël të përfshihen më shumë në mundësi financimi përmes skemave të posaçme të mikrokredive. Këto skema duhet të kenë norma interesi të përballueshme dhe kushte fleksibël për blerjen e pajisjeve, përmirësimin e stallave, ose rritjen e produktivitetit. Gjithashtu duhet të bëhen edhe trajnime për dhënien e njohurive financiare për të siguruar që gratë të kuptojnë se si të menaxhojnë kreditë, si të vlerësojnë planet për shlyerjen e tyre dhe të marrin vendime për investime të bazuara në informacion.

Paralelisht me këtë, duhet të bëhen përpjekje për përfshirjen e blegtorëve të vegjël – sidomos të grave – në skemat kombëtare për mbështetjen e bujqësisë. Kjo përfshirja do të përmirësonte konsiderueshëm qëndrueshmërinë e tyre financiare dha aksesin në subvencione dhe grante publike.

4. Nxitja e fuqizimit të grave dhe e barazisë gjinore

Gratë duhet të mbështeten që të ndërmarrin role më aktive në proceset e vendimmarrjes në familje, ferma, dhe institucionet vendore. Nismat për krijimin e grupeve prodhuese dhe kooperativave të grave, ose grupe kursimi të përbashkëta (të ashtuquajturat lotari) mund të nxisin shkëmbimin e njohurive, veprime kolektive dhe investime të përbashkëta. Pajisja e grave me mjete dhe pajisje moderne për mjelje do të pakësojë ngarkesën e punës së tyre, do të rrisë efikasitetin dhe do të përmirësojë cilësinë e qumështit të dorëzuar.

5. Forcimi i kapaciteteve vendore dhe institucionale

Duhet të forcohen kapacitetet e shërbimeve vendore të ekstensionit bujqësor për dhënien e ndihmës teknike, kryerjen e vizitave të rregullta në terren, dhe ofrimin në vijimësi të shërbimeve këshillimore për blegtorët. Këto shërbime janë veçanërisht të rëndësishme për komunitetet në zonat e thella dhe ku këto shërbime nuk ofrohen sa duhet. Duhet të krijohen platforma bashkëpunimi për vendosjen e lidhjeve midis blegtorëve, përpunuesve të bulmetit, autoriteteve vendore dhe institucione financiare, duke nxitur shkëmbimin e informacionit dhe veprime të koordinuara.

6. Forcimi i qëndrueshmërisë ndaj kërcënimeve mjedisore dhe klimatike

Për t'i përgatitur fermerët për sfidat që lidhen me ndryshimet klimatike, duhet të promovohen praktika të qëndrueshme dhe inteligjente klimatike. Programet e trajnimit duhet të përqendrohen në vaditjen me përdorim efikas të ujit, prodhimin e ushqimit për bagëtitë, kultivimin e bimëve rezistente ndaj thatësirës. Po kështu, sistemet për menaxhimin e mbetjeve, teknikat e kompostimit dhe përdorimi i plehrave organike, mund të pakësojnë më tej ndikimin e blegtorisë në mjedis. Këto ndërhyrje jo vetëm që duhet të zbusin ndikimet negative në mjedis, por edhe të rrisin qëndrueshmërinë afatgjatë të fermave.

Duke qenë se gratë shpesh luajnë një rol kyç në punët e fermës, si ushqyerja e bagëtive, përdorimi i ujit dhe trajtimi i mbetjeve, është thelbësore që ato të përfshihen aktivisht në trajnime për praktika bujqësore inteligjente në lidhje me klimën. Seanca të posaçme për ngritjen e kapaciteteve të grave blegtore – të ofruara në formate dhe vende të aksesueshme – duhet të trajtojnë rolet, kufizimet dhe mangësitë specifike në njohuritë e tyre. Përveç kësaj, pjesëmarrja e grave në krijimin dhe zbatimin e këtyre praktikave të qëndrueshme mund të çojë në strategji më përfshirëse dhe më efektive të përshtatjes ndaj klimës.

7. Sigurimi i një force punëtore të qëndrueshme dhe i angazhimit të të rinjve

Përpjekjet për përmirësimin e kushteve të punës në blegtori duhet të përfshijnë futjen e teknologjive që kursejnë punën e krahut, sidomos ato që lehtësojnë ngarkesën e punës fizike të grave – të cilat shpesh kryejnë punët më të rënda dhe me orar të zgjatur, si mjelja, ushqyerja e kafshëve dhe pastrimi. Po kështu, është me shumë rëndësi të garantohet kompensim i drejtë dhe kushte të denja pune për të gjithë punëtorët dhe punëtoret. Në të njëjtën kohë, duhet të hartohen edhe strategji për angazhimin e të rinjve përmes formimit profesional, praktikave të punës dhe fushatave të ndërgjegjësimit në lidhje me mundësitë moderne në sektorin e blegtorisë dhe të bulmetit. Këto strategji duhet të nxisin aktivisht përfshirjen e vajzave të reja, duke trajtuar barrierat ndaj pjesëmarrjes së tyre, duke dhënë shembuj pozitivë të grave në këtë fushë, dhe duke krijuar trajnime dhe mjedise pune të sigurta dhe mbështetëse. Krijimi i mundësive për karrierë të të rinjve në bujqësi dhe blegtori do të ndihmojë në zbutjen e emigracionit nga zonat rurale dhe do të sigurojë një fuqi punëtore të qëndrueshme në të ardhme.

Ky plan ndërhyrjesh ofron një udhërrëfyes gjithëpërfshirës dhe me ndjeshmëri gjinore për forcimin e zinxhirit të vlerës të qumështit/bulmetit në Malësi të Madhe. Duke trajtuar njëkohësisht barrierat në prodhim, pabarazitë sociale, rreziqet mjedisore dhe aksesin në financim, veprimet e propozuara synojnë që të forcojnë aftësinë e sektorit për të përballuar krizat, gjithëpërfshirjen dhe fitimin e të ardhurave.

Tabela 7. Rekomandime për zinxhirin e vlerës të qumështit

Nr.	Veprimtaria	Impakti		
		Afatshkurtër	Afatmesëm	Afatgjatë
1	**Shtimi i njohurive dhe zbatimi i praktikave të mira blegtorale për rritjen e produktivitetit dhe për sigurimin e qumështit dhe produkteve të bulmetit me cilësi më të mirë.**			
1.1	o Trajnim dhe ndërtim kapacitetesh o Të organizohen seminare trajnimi për blegtorët, sidomos për gratë blegtore, për praktikat e mira blegtorale, si kujdesi për bagëtitë, higjiena e mjeljes, dhe menaxhimi social-ekonomik. o Të ofrohen trajnime në lidhje me për teknikat moderne të mjeljes dhe rëndësinë e standardeve higjienike në blegtori. o Të ofrohen trajnime të specializuara në mbarështimin e bagëtive, menaxhimin e mbetjeve, menaxhimin e jashtëqitjeve të kafshëve, dhe mirëqenien e bagëtive.	X	X	X
1.2	o Pilotim programesh për praktikat e mira blegtorale o Të zbatohen programe pilot në ferma të caktuara, ku fermerët mund të demonstrojnë praktikat moderne dhe të shërbejnë si shembull për komunitetin. o Të prezantohen stalla moderne dhe kazanë ftohës në fermat pilot për të demonstruar efektivitetin e tyre.	X	X	X
1.3	Mbështetje për mjete dhe pajisje o Të mbështetet aksesi në pajisje mjelëse dhe kontejnerë higjienikë përmes skemave të mikrokredisë, partneritetit me bashkinë, projekteve dhe granteve vendore. o Të mbështeten gratë blegtore me vegla dhe mjete bazë (si doreza, kontejnerë të përshtatshëm, etj.) për të pakësuar rrezikun e kontaminimit.	X	X	X
2	**Përmirësimi i sistemeve të infrastrukturës dhe monitorimit të cilësisë për rritjen e kapacitetit të prodhimit dhe të cilësisë së produkteve**			
2.1	Mbështetje për ngritjen e një laboratori analizash për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e qumështit të papërpunuar përpara përpunimit të tij në baxho.	X	X	X
2.2	Krijimi i një sistemi monitorimi të qumështit të papërpunuar o Të përmirësohet infrastruktura për mbledhjen e qumështit, sidomos në zonat malore, për të siguruar akses më të mirë dhe për të pakësuar prishjen e qumështin. o Të mbështetet zhvillimi i një sistemi transporti për transportim higjienik dhe në kohë të qumështit në baxho.		X	X
3	**Përmirësimi i aksesit të blegtorëve në burime financiare për rritjen e produktivitetit dhe të qëndrueshmërisë së fermave të tyre**			
3.1	Promovimi i skemave financiare: o Të punohet me institucionet e mikrokredisë për ofrimin e produkteve financiare të posaçme për blegtorët e vegjël, si kredi me interes të ulët për blerjen e pajisjeve dhe përmirësimin e fermave. o Të organizohen trajnime për t'u dhënë fermerëve njohuri financiare, që ata të kuptojnë sistemin e mikrokredisë, proceset e aplikimit për kredi, dhe planet e pagimit të kësteve.	**X**	**X**	X

(Vazhdon në faqen tjetër)

Nr.	Veprimtaria	Impakti		
		Afatshkurtër	Afatmesëm	Afatgjatë
3.2	Avokim për përfshirjen e fermerëve të vegël, sidomos të grave, në skemën e mbështetjes për bujqësinë, për t'i ndihmuar ato që të kenë akses në asistencën e duhur financiare.		X	X
4	**Fuqizimi i grave dhe forcim i barazisë gjinore**			
4.1	Promovim i rolit udhëheqës të grave në vendimmarrje o Të mundësohet përfshirja e grave në proceset e vendimmarrjes, si në nivel të fermës, ashtu edhe në menaxhimin e baxhos. o Të krijohen grupe grash për shkëmbim të njohurive, vendimmarrje të përbashkët dhe investime kolektive.		X	X
4.2	o Të kryhen seanca trajnimesh vetëm për gratë në lidhje me praktikat e mira blegtorale, menaxhimin e aseteve dhe sipërmarrjen. o Të pajisen gratë me aftësi për menaxhimin e cilësisë së qumështit, të financave të fermës dhe strategji të biznesit.		X	X
4.3	Mbështetje e aksesit të grave në vegla dhe pajisje o Të sigurohet që gratë të kenë akses në veglat dhe pajisjet e nevojshme për përmirësimin e produktivitetit dhe pakësimin e ngarkesës së punës së tyre, si makineri për mjelje, kontejnerë të përshtatshëm dhe kazanë ftohës.	X	X	X
5	**Ndërtimi i kapacitetve vendore dhe institucionale për sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë dhe të aftësisë për përballimin e situatave në blegtori**			
5.1	Forcimi i shërbimeve të ekstensionit dhe rritje e bashkëpunimit të grupeve të interesit o Të forcohet infrastruktura e shërbimeve vendore të ekstensionit për t'u ofruar blegtorëve, sidomos atyre në zonat e thella, ndihmë dhe këshilla në vijimësi. o Të organizohen rregullisht vizita në terren, demonstrime dhe programe shkëmbimi mes fermerëve për promovimin e shkëmbimit të njohurive. o Të forcohet bashkëpunimi mes blegtorëve, autoriteteve bujqësore dhe institucioneve financiare për sigurimin e suksesit dhe qëndrueshmërisë afatgjatë. o Të avokohet për administrim më të mirë në zinxhirin e furnizimit me qumësht, për të forcuar gjurmueshmërinë dhe kontrollet e cilësisë.	X	X	X
6	**Forcimi i qëndrueshmërisë ndaj sfidave mjedisore dhe pakësimi i ndikimit të blegtorisë në mjedis**			
6.1	Promovimi i praktikave të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike o Të prezantohen praktika që i ndihmojnë fermerët të përshtaten me ndryshimet klimatike, si vaditja me përdorim efikas të ujit, menaxhim më i mirë i ushqimit të kafshëve, dhe bimët e qëndrueshme ndaj klimës. o Të ofrohen trajnime në lidhje me teknika bujqësore dhe blegtorale të qëndrueshme për të zbutur ndikimin e ndryshimeve klimatike në kultivimin e bimëve foragjere.		X	X
6.2	Nxitja e qëndrueshmërisë mjedisore o Të mbështetet krijimi i sistemeve të menaxhimit të mbetjeve dhe riciklimit në fermë, për pakësimin e ndotjeve. o Të nxitet përdorimi i plehrave organike dhe të qëndrueshme, si edhe i ushqimit të kafshëve për pakësimin e ndikimit në mjedis.		X	X

Nr.	Veprimtaria	Impakti		
		Afatshkurtër	Afatmesëm	Afatgjatë
7	**Sigurimi i një force punëtore të qëndrueshme në vijimësi përmes trajtimit të problemeve të emigracionit dhe përmirësimit të kushteve të punës**			
7.1	Tërheqja e rinisë në blegtori o Të krijohen shtysa për nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve dhe të rejave në blegtori, si për shembull bursa për programe trajnimi, këshillim, dhe mundësi për karrierë në bujqësi dhe blegtori. o Të promovohet sektori i qumështit/bulmetit si një mundësi e realizueshme karriere për të rinjtë, përmes organizimit të fushatave ndërgjegjësuese mbi mundësitë në blegtori.		X	X
7.2	Përmirësimi i kushteve të punës të grave: o Të zbatohen teknologji dhe praktika që kursejnë punën fizike, sidomos për gratë, për pakësimin e ngarkesës së punës së tyre dhe përmirësimin e kushteve të punës. o Të avokohet për më shumë të drejta në punësim dhe shpërblim të drejtë për punën e grave që punojnë në blegtori.		X	X

Suksesi i zinxhirit të vlerës me ndjeshmëri gjinore të blegtorisë në Malësi të Madhe varet nga ekzistenca e partneriteteve të fuqishme midis aktorëve kyç lokalë, agjencive përkatëse të sektorit, baxhove lokale dhe palëve të tjera të interesit në sektor. Këto bashkëpunime janë thelbësore për kapërcimin e vështirësive me të cilat përballen blegtorët e vegjël, sidomos gratë blegtore, duke shfrytëzuar në të njëjtën kohë anët e forta ekzistuese dhe mundësitë e tregut.

Rekomandimet kanë për qëllim t'u ofrojnë blegtorëve mbështetje gjithëpërfshirëse, me theks të veçantë mbi fuqizimin e grave. Ato fokusohen në përmirësimin e praktikave blegtorale në ferma, promovimin e barazisë gjinore dhe sigurimin e qëndrueshmërisë mjedisore. Duke trajtuar këto fusha kyçe, plani synon ndërtimin e një zinxhiri vlere të qumështit më të aftë për të përballuar situatat, më konkurrues dhe më fitimprurës, që njeh dhe forcon rolin kritik të grave në blegtori.

Një element kritik i kësaj qasjeje është pjesëmarrja aktive e grave fermere, duke siguruar që ato të kenë akses në nisma për ndërtimin e kapaciteteve, pajisje moderne dhe mbështetje financiare. Gratë janë shtylla kurrizore e blegtorisë në Malësi të Madhe, të cilat merren me punë si kujdesi për kafshët, mjelja, dhe dërgimi i qumështit në baxho, por ato shpesh nuk kanë kontroll mbi asete, vendimmarrje dhe burime. Këto rekomandime i japin përparësi trajnimeve, përfshirjes në financim dhe organizimit në kooperativa, për rritjen e produktivitetit, pavarësisë dhe rolit të tyre udhëheqës në sektorin e blegtorisë/bulmetit.

Përmes nxitjes së bashkëpunimit, inovacionit dhe qëndrueshmërisë, kjo ndërhyrje synon të krijojë impakte pozitive afatgjata për gratë fermere, familjet fermere, bizneset lokale të baxhove dhe për ekonominë rurale në përgjithësi në Malësi të Madhe.

Pjesa 4
Shtojcat

Shtojca 1. Bashkia Malësi e Madhe: Informacion i Përgjithshëm

Malësia e Madhe shtrihet në pjesën veriperëndimore të Shqipërisë dhe kufizohet në veri, veriperëndim dhe verilindje me Malin e Zi, në jugperëndim me Liqenin e Shkodrës dhe në jug dhe juglindje me Bashkinë Shkodër. Territori i Bashkisë së Malësisë së Madhe ka një sipërfaqe prej 951 km^2, që ndahet në gjashtë njësi administrative: Kelmendi, Kastrati, Shkreli, Kopliku, Njësia Qendër, dhe Gruemira – me dy qytete, Kopliku dhe Bajza, si edhe 56 fshatra. Bashkia ka një popullsi prej 21.684 banorë, me dendësinë më të madhe të popullsisë në zonat fushore të territorit të bashkisë.[74]

Bashkia ka lidhje dhe ndërveprim ekonomik, infrastrukturor dhe social me zonën e Shkodrës dhe Malin e Zi, duke krijuar një lidhje të fortë midis këtyre dy vendeve. Në pjesën perëndimore të bashkisë kalon një aks i rëndësishëm infrastrukturor dhe ekonomik, që lidh Podgoricën, kalon përmes Malësisë së Madhe, vazhdon në Shkodër dhe shkon më tej deri në Lezhë, Tiranë, dhe më në fund në Durrës. Përveç kësaj, me rëndësi të madhe është edhe rruga panoramike, një rrugë ndërkombëtare që kalon përgjatë pjesës perëndimore të Malësisë së Madhe, duke krijuar një lidhje panoramike me Malin e Zi – ku përfshihet territori alpin i Parkut Ballkanik të Paqes.

Itinerari alpin-liqenor është një pjesë e rëndësishme e itinerareve turistike për shkak të lidhjes midis turizmit liqenor dhe atij malor. Ky itinerar përfshin një varg shtigjesh për ecje në Malësi të Madhe, që shkojnë deri në zonën e Gucisë dhe vazhdojnë në zonat malore të Kolashinit në Mal të Zi, në veri të Bashkisë Malësi e Madhe, ndërsa ato në lindje të bashkisë vazhdojnë deri në Tropojë dhe degëzohen me Fierzën dhe Kukësin, ku kryqëzohet edhe me itinerarin vozitës.[75] Ky itinerar vozitës ndjek vijat ujore dhe përfundon në brigjet e Liqenit të Shkodrës, dhe më tej në lumin e Bunës.

Dendësia e popullsisë në bashki është shumë e ulët dhe mbi 70% e lëvizjeve metabolike natyrore të saj janë gjithashtu të kufizuara dhe të shpërndara, po ashtu të shpërndara janë edhe qendrat e banuara. Nga pikëpamja e analizës metabolike, është shumë e rëndësishme të ruhen burimet ujore, sidomos burimet ujore nëntokësore, sepse ndotja e tyre do të ishte pasoja me për ekosistemin e Liqenit të Shkodrës. Turizmi paraqet potencialin më të madh për zhvillim, pas ekonomisë bujqësore, dhe për këtë arsye rrjedhat janë analizuar jo vetëm për sa i përket lëvizjes por edhe për vendndodhjen e zonave me potencial turistik dhe rajonet që duhen ruajtur për potencialin e tyre të madh natyror.

Demografia dhe popullsia

Sipas Censusit të vitit 2023, bashkia ka një popullsi prej 21.684 banorësh, ku numri i meshkujve (10.879) është pak më i lartë se ai i femrave (10.805 femra).

74. Shih: https://bashkiamalesiemadhe.gov.al/
75. Strategjia e Zhvillimit të Territorit, Bashkia Malësi e Madhe.

Tabela 8. Popullsia sipas grupmoshës dhe gjinisë

Grupmosha	Banorë gjithsej	Meshkuj	Femra
0-4	870	438	432
5-9	1,005	491	514
10-14	1,082	570	512
15-19	1,322	655	667
20-24	1,332	631	701
25-29	1,201	671	530
30-34	1,062	644	418
35-39	974	548	426
40-44	975	465	510
45-49	1,166	525	641
50-54	1,647	726	921
55-59	1,935	913	1,022
60-64	2,179	1,096	1,083
65-69	1,660	835	825
70-74	1,229	656	573
75-79	904	473	431
80-84	721	328	393
85+	420	214	206
Gjithsej	**21,684**	**10,879**	**10,805**

Burimi: INSTAT 2024.

Në vitin 2023, Bashkia e Malësisë së Madhe kishte gjithsej 21.684 banorë. Të dhënat ilustrojnë strukturën demografike, me përqendrimin më të madh të personave në grupmoshën 15-19 vjeç (1.322 banorë), që tregon për një popullsi relativisht të re në moshë. Me rritjen e moshës, ka një rënie të ndjeshme në numrin e banorëve, sidomos në grupmoshat më të moshuara. Krahas kësaj, tabela tregon për tendencat gjinore në kategoritë e ndryshme moshore. Ndërsa në grupmoshat më të reja dominojnë meshkujt, numri i femrave është më i madh në grupmoshat më të vjetra, sidomos pas grupmoshës 50-54 vjeç, ku numri i femrave është shumë më i lartë se i meshkujve. Grupmosha 85+ shfaq një tendencë të pazakontë, me një numër pak më të lartë meshkujsh se femrash.

Tabela 9. Gjendja civile, 2023

Gjendja civile	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Beqar/beqare	7,404	4,267	3,137
I/e martuar	12,414	6,158	6,256
I/e divorcuar/ndarë	120	64	56
I/e ve	1,746	390	1,356

Burimi: INSTAT 2024.

Në Malësi të Madhe ka gjithsej 7.404 banorë të pamartuar, me një numër më të madh meshkujsh beqarë (4.267) krahasuar me femrat beqare (3.137), që pasqyron një dallim gjinor, ku burrat kanë më tepër gjasa të jenë të pamartuar. Personat e martuar përbëjnë grupin më të madh, me 12.414 persona, me një shpërndarje pothuaj të barabartë mes meshkujve (6.158) dhe femrave (6.256), që sugjeron barazi gjinore në gjendjen martesore. Përkundër kësaj, numri i personave të divorcuar ose të ndarë është minimal, me vetëm 120 persona, ku numri i meshkujve (64) është pak më i lartë se i femrave (56).Ndërsa në shifrat e popullatës të ve ka dallim gjinor të konsiderueshëm – ndër 1.746 personat e ve, shumica janë femra (1.356), krahasuar me vetëm 390 meshkuj.

Tabela 10. Popullsia sipas gjendjes civile, 2023

Përbërja e bërthamave familjare (2023)	Gjithsej	Çifte të martuara/që bashkëjetojnë, pa fëmijë	Çifte të martuara/që bashkëjetojnë, me fëmijë	Prindër të vetëm
Gjithsej bërthama familjare	6,558	2,837	3,174	547
0 fëmijë	2,837	2,837	..	..
1 fëmijë	1,729	..	1,350	379
2 fëmijë	1,197	..	1,076	121
3+ fëmijë	795	..	748	47

Burimi: INSTAT 2024.

Në Malësi të Madhe, përbërja e bërthamave familjare në vitin 2023 jep informacion të konsiderueshëm për strukturat familjare, me rëndësi për të kuptuar dinamikat social-ekonomike dhe rolet gjinore në komunitet. Numri i gjithsejtë i bërthamave familjare është 6.558, të kategorizuara kryesisht në tri grupe: çifte të martuara ose që bashkëjetojnë, pa fëmijë; çifte të martuara ose që bashkëjetojnë, me fëmijë; dhe familje me një prind të vetëm. Çiftet e martuara ose që bashkëjetojnë pa fëmijë përbëjnë një numër të konsiderueshëm të totalit, me 2.837 bërthama familjare. Çiftet me fëmijë përbëjnë 3.174 bërthama familjare, që tregon për mbizotërimin e familjeve me fëmijë në rajon. Familjet me një prind, që përbëjnë në segment më të vogël por të konsiderueshëm të familjeve, janë gjithsej 547. Një analizë e mëtejshme bazuar në numrin e fëmijëve ofron edhe më shumë detaje. Numri i familjeve me një fëmijë është gjithsej 1.729, ku shumica janë çifte të martuara ose që bashkëjetojnë (1.350), ndërsa familje me një prind janë 379. Numri i familjeve me dy fëmijë është 1.197, kryesisht çifte (1.076) dhe më pak familje me një prind (121). Familjet me tre ose më shumë fëmijë janë 795; shumica janë çifte (748), me një përfaqësim minimal të familjeve me një prind (47). Këto shifra tregojnë për mbizotërimin e bërthamave familjare me fëmijë dhe për një numër më të vogël të familjeve me një prind.

Tabela 11. Numri dhe shpërndarja e anëtarëve të familjes, 2023

NJA	Gjithsej	Pa bërthamë familjare (NJEF)	Me një bërthamë familjare	Me dy ose më shumë bërthama familjare
Malësi e Madhe	21,107	1,720	16,637	2,750
Gruemirë	6,630	495	5,194	941
Kastrat	4,335	378	3,442	515
Kelmend	1,464	125	1,181	158
Koplik	2,990	246	2,399	345
Qendër Koplik	3,610	282	2,832	496
Shkrel	2,078	194	1,589	295

Burimi: INSTAT 2024.

Të dhënat pasqyrojnë shpërndarjen e njësive ekonomike familjare (NJEF) në të gjithë Malësinë e Madhe dhe në njësitë administrative të saj në vitin 2023. Në bashki janë të regjistruara gjithsej 21.107 NJEF. Nga këto, 1.720 NJEF nuk kanë bërthamë familjare, 16.637 kanë një bërthamë familjare kanë një bërthamë familjare, dhe 2.750 kanë dy ose më shumë bërthama familjare, që tregon se shumica e familjeve në Malësi të Madhe janë të strukturuara si njësi me një bërthamë të vetme familjare.

Gruemira është njësia administrative më e madhe me 6,630 NJEF. Nga këto, 495 NJEF nuk kanë bërthamë familjare, 5.194 NJEF kanë një bërthamë familjare, dhe 941 NJEF kanë dy ose më shumë bërthama familjare. Kjo shpërndarje vë në pah mbizotërimin e familjeve me një bërthamë në këtë zonë.

Kastrati përbëhet nga 4.335 NJEF. Nga këto, 378 NJEF nuk kanë bërthamë familjare, 3,442 NJEF kanë një bërthamë familjare, dhe 515 NJEF kanë dy ose më shumë bërthama familjare. Të dhënat flasin për një tendencë të fuqishme drejt familjeve me një bërthamë.

Në Kelmend, ka gjithsej 1,464 NJEF. Nga këto, 125 NJEF nuk kanë bërthamë familjare, 1,181 kanë një bërthamë familjare, dhe vetëm 158 kanë dy ose më shumë bërthama familjare. Të dhënat sugjerojnë një strukturë më të vogël dhe më të njëtrajtshme familjare krahasuar me zona të tjera.

Kopliku ka 2,990 NJEF. Nga këto, 246 nuk kanë bërthamë familjare, 2,399 kanë një bërthamë familjare, dhe 345 kanë dy ose më shumë bërthama familjare. Shumica e NJEF-ve janë njësi familjare me një bërthamë, me një numër më të vogël NJEF-sh me strukturë familjare komplekse.

Qendër Kopliku ka 3.610 NJEF, ku 282 prej tyre nuk kanë bërthamë familjare, 2.832 kanë një bërthamë familjare, dhe 496 kanë dy ose më shumë bërthama familjare. Kjo shpërndarje pasqyron tendencën e përgjithshme të mbizotërimit të NJEF-ve me një bërthamë familjare.

Në Shkrel, banojnë 2,078 NJEF, nga të cilat 194 nuk kanë bërthamë familjare, 1,589 kanë një bërthamë familjare, dhe 295 përbëhen nga dy ose më shumë bërthama familjare. Ashtu si në njësitë e tjera administrative, edhe këtu mbizotërojnë NJEF-të me një bërthamë familjare.

Në të gjithë Malësinë e Madhe mbizotërojnë NJEF-të me një bërthamë familjare, që reflekton një strukturë familjare tradicionale. Një numër më i vogël familjesh nuk kanë bërthamë familjare, që tregon për praninë e organizimeve jotradicionale të jetesës. Familjet me dy ose më shumë bërthama familjare, ndonëse të pranishme, mbeten pakicë, që tregon për përhapje më të vogël të jetesës në familje të zgjeruara në bashki. Kjo është e njëjtë në të gjitha njësitë administrative të bashkisë, ku Gruemira ka përqendrimin më të lartë ndërsa Kelmendi përqendrimin më të ulët të familjeve.

Konteksti social-ekonomik

Ofrimi i shërbimeve sociale në Malësi të Madhe fokusohet në promovimin e gjithëpërfshirjes, uljen e varfërisë dhe krijimin e mundësive për zhvillim të qëndrueshëm. Ndër nismat më themelore përfshihen programet e asistencës ekonomike, mbështetja me strehim, dhe ndërhyrjet e posaçme për familjet me nevoja të veçanta. Këto programe janë me rëndësi jetësore për ngushtimin e dallimeve në akses në burime, sidomos për banorët e zonave të thella që kanë barriera në aksesimin e shërbimeve themelore.

Shërbimet sociale dhe ndihma ekonomike

Tabela në vijim paraqet një ndarje demografike të detajuar e popullsisë në Bashkinë Malësi e Madhe për vitin 2023. Bashkia ka gjithsej 18.727 banorë, me 1.275 individë (6,8%) të identifikuar si persona me aftësi të kufizuara.

Tabela 12. Popullsia sipas NJA-ve, gjinisë dhe statusit të aftësisë së kufizuar, 2023

Njësia adm.	Popullsia gjithsej	Me aftësi të kufizuara	Pa aftësi të kufizuara	Gjithsej meshk.	Meshkuj me aftësi të kufizuara	Meshkuj pa aftësi të kufizuara	Gjithsej femra	Femra me aftësi të kufizuara	Femra pa aftësi të kufizuara
Malësi e Madhe	18,727	1,275	17,452	9,380	596	8,784	9,347	679	8,668
Gruemirë	5,656	424	5,232	2,695	196	2,499	2,961	228	2,733
Kastrat	3,727	270	3,457	1,838	122	1,716	1,889	148	1,741
Kelmend	1,251	77	1,174	620	35	585	631	42	589
Koplik	2,565	220	2,345	1,240	109	1,131	1,325	111	1,214
Qendër Koplik	3,135	158	2,977	1,511	66	1,445	1,624	92	1,532
Shkrel	2,393	126	2,267	1,476	68	1,408	917	58	859

Burimi: INSTAT 2024.

Nga pikëpamja e gjinisë, ndarja e popullsisë është pothuaj e barabartë midis meshkujve (9.380) dhe femrave (9.347). Nga meshkujt, 596 (6,4%) kanë aftësi të kufizuara, ndërsa nga femrat 679 (7,3%) raportojnë se kanë aftësi të kufizuara, me një incidencë pak më të lartë të aftësive të kufizuara tek femrat.

Sa i përket popullsisë sipas njësive administrative, Gruemira ka popullsinë më të madhe, me 5.656 banorë, nga të cilët 424 (7,5%) kanë aftësi të kufizuara. Njësia e Kastratit ka 3.727 banorë, nga të cilët 270 (7.2%) me aftësi të kufizuara. Kelmendi, me 1.251 banorë, ka 77 (6,2%) persona me aftësi të kufizuara, që është numri më i vogël i PAK në bashki. Kopliku, me 2.565 banorë ka 220 (8,6%) persona me aftësi të kufizuara, ndërsa Qendër Koplik, me 3.135 banorë, 158 (5%) nga të cilët raportojnë se kanë aftësi të kufizuara. Së fundi, Shkreli ka një popullsi prej 2.393 banorë, nga të cilët 126 (5,3%) persona me aftësi të kufizuara.

Tabela 13. Familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike

Kategoria	Gjithsej	Koplik	Kastrat	Shkrel	Gruemirë	Qendër	Kelmend
Familjet aplikuese	850	148	142	155	135	140	130
Familjet përfituese	741	113	136	133	117	120	122
Përfitues në zonat rurale (%)	87%	-	-	-	-	-	-
Përfitues të NE (6%)	58	10	11	8	10	9	10

Burimi: MTBP 2021-2023, Bashkia Malësi e Madhe

Familjet në zonat rurale përbëjnë 87% të përfituesve, që tregon për përqendrimin e ndihmës ekonomike në komunitetet bujqësore të pambuluara sa duhet me shërbime. Në zonat rurale, gratë shpesh menaxhojnë përgjegjësitë familjare, përfshirë kujdesin për fëmijët dhe punët e bujqësisë për nevojat e familjes. Vënia në fokus e këtyre komuniteteve mund të ndihmojë fuqizimin e grave përmes aktiviteteve për gjenerimin e të ardhurave ose zhvillimit të aftësive. Bllok ndihma 6% për përfituesit e klasifikuar si NE (me gjasë, "në nevojë ekstreme") tregon për një nëngrup kritik që ka nevojë për mbështetje të posaçme. Bazuar në të dhënat e bashkisë, vihet re se në Malësi

të Madhe ka 60 familje[76] që tani jetojnë në kushte banimi të papërshtatshme dhe kanë nevojë për strehim. Sipas informacionit, aktualisht nuk ka asnjë familje që përfiton nga programet ekzistuese të strehimit në bashki.
Në Malësi të Madhe ka 1.284 persona me aftësi të kufizuara, ku numri i femrave (682) është pak më i lartë se i meshkujve (602). Kjo mund të jetë tregues se gratë përballen me më shumë vështirësi në menaxhimin e aftësive të kufizuara, gjë që mund të ndikojë aksesin e tyre në shërbime, pjesëmarrje ekonomike dhe në mirëqenien e tyre.

Tabela 14. Personat me aftësi të kufizuara sipas gjinisë

Kategoria	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Gjithsej persona me aftësi të kufizuara	1,284	602	682
Me aftësi të kufizuara në shikim	346	164	182
Me aftësi të kufizuara në dëgjim	335	161	174
Me aftësi të kufizuara në ecje/lëvizje	931	399	532
Probleme me kujtesën	285	141	144
Probleme të kujdesit për veten	403	188	215
Probleme komunikimi	256	125	131

Burimi: INSTAT 2024.

Kufizime në shikim kanë 346 persona, 164 meshkuj dhe 182 femra. Kjo sugjeron se gratë një incidencë pak më të lartë të aftësive të kufizuara në shikim tek gratë.

335 persona kanë probleme me dëgjimin, nga të cilët 161 meshkuj dhe 174 femra. Njësoj si në rastin e aftësive të kufizuara në shikim, numri i femrave të prekura është më i lartë, që tregon se gratë mund të kenë vështirësi të veçanta për sa i përket komunikimit, sidomos në komunitet dhe në mjedise pune.

Numri më i lartë i aftësive të kufizuara lidhet me lëvizjen/të ecurit, me 931 persona gjithsej. Nga këta, 399 janë meshkuj, dhe 532 femra. Këto shifra flasin për një hendek gjinor të konsiderueshëm, me më shumë gra që kanë probleme të aftësisë për të lëvizur.
285 persona kanë aftësi të kufizuara që lidhen me kujtesën, ndër të cilët 141 meshkuj dhe 144 femra. 403 individë kanë vështirësi të kujdesen për veten, nga të cilët 188 meshkuj dhe 215 femra.
256 persona kanë vështirësi në komunikim, nga të cilët 125 meshkuj dhe 131 femra. Njësoj si në kategoritë e tjera, gratë kanë një shkallë pak më të lartë vështirësish në komunikim, që mund të ndikojë në aksesin e tyre në arsim, shërbim shëndetësor dhe mundësi punësimi.

Arsimi

Arritjet arsimore janë një tregues kyç i zhvillimit të përgjithshëm të një komuniteti, që ndikon në mundësitë individuale, rritje ekonomike dhe trajtim social të barabartë. Në rastin e Malësisë së Madhe, arritjet arsimore tregojnë progres, por edhe sfida në vijimësi. Gjatë viteve, rajoni ka ecur shumë përpara sa i përket aksesit në arsim, por pengesa ende ekzistojnë, sidomos në zonat rurale ku faktorët social-ekonomikë, infrastruktura dhe normat kulturore ndikojnë në rezultatet arsimore.
Kjo pasqyrë e arritjeve arsimore në Malësi të Madhe tregon shpërndarjen e niveleve arsimore në popullatën e zonës në vitin 2023, me fokus mbi dallimet mes burrave dhe grave. Të dhënat nxjerrin në pah numrin e individëve që kanë përfunduar arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë, si edhe dallimet gjinore mes këtyre grupeve.

76. Bashkia Malësi e Madhe, Sektori i Shërbimeve Sociale.

Tabela 15. Arritjet arsimore sipas gjinisë, 2023

Niveli arsimor	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Arsimi fillor	1,003	523	480
Shkolla nëntëvjeçare	902	490	412
Shkolla e mesme	856	498	358
Arsim i lartë	586	201	385
Arsim i lartë i shkurtuar	24	11	13
Arsim i lartë	436	141	295
Nivel pasuniversitar (Master ose Doktoraturë)	126	49	77

Burimi: INSTAT 2024.

Tabela paraqet të dhënat e arritjeve arsimore në Malësi të Madhe në vitin 2023, ndarë sipas gjinisë. Ajo ndihmon të kuptohet shkalla e arsimimit të popullatës, sipas niveleve të ndryshme arsimore.
Arsimin fillor e kanë përfunduar 1.003 persona. Ndër ta, 523 janë meshkuj dhe 480 janë femra, që tregon një shpërndarje gjinore relativisht të balancuar, me një avantazh pak më të madh të meshkujve në arsimin fillor.
Shkollën nëntëvjeçare e kanë përfunduar 902 persona. Nga këta, 490 janë meshkuj dhe 412 janë femra. Dallimet gjinore janë më të vogla se sa në arsimin fillor; megjithatë, përsëri numri i meshkujve është përsëri pak më i lartë se i femrave.
Sa u takon shkollës së mesme, këtë nivel e kanë përfunduar 856 persona. Ndër ta 498 janë meshkuj dhe 358 janë femra. Dallimet midis meshkujve dhe femrave janë më të dukshme në arsimin e mesëm, ku numri i djemve është shumë më i lartë se i vajzave.
Në kategorinë e arsimit të lartë, 586 persona në bashki kanë kualifikim të lartë. Megjithatë, në këtë kategori, numri i femrave është më i lartë se i meshkujve, me 385 femra kundrejt 201 meshkuj. Kjo shënon një tendencë pozitive të pjesëmarrjes më të madhe të femrave në arsimin e lartë.

Në programet e arsimit të lartë të shkurtuar kanë marrë pjesë 24 persona: 11 meshkuj dhe 13 femra. Ndonëse numër i vogël, ai tregon për një pjesëmarrje pak më të lartë të femrave në këtë kategori arsimore. Sa i përket arsimit të lartë, 436 persona kanë diplomë universitare, me 141 meshkuj dhe 295 femra. Së fundi, në kategorinë pasuniversitare (Master ose Doktoraturë), këto kualifikime i kanë marrë 126 persona: 49 meshkuj dhe 77 femra. Njësoj si në rastin e diplomave universitare, numri i femrave që kanë përfunduar studimet pasuniversitare është më i lartë se i meshkujve.

Tabela 16. Numri i çerdheve dhe kopshteve

Nr.	Njësia administrative	Numri i kopshteve	Kapaciteti	Numri i fëmijëve	Numri i edukatoreve	Fëmijë për edukatore
1	Koplik	1	150	112	8	14
2	Qendër	6	150	96	7	14
3	Kastrat	6	185	104	9	12
4	Shkrel	4	105	65	4	16
5	Gruemirë	11	345	179	15	12
6	Kelmend	1	25	16	1	16
Gjithsej		**29**	**960**	**572**	**44**	**13**

Burimi: Bashkia Malësi e Madhe.

Bashkia ka 29 kopshte gjithsej me kapacitet 960 vende, ku shkojnë 572 fëmijë. Vetëm 15% e fëmijëve të grupmoshës 0-6 vjeç (gjithsej 4.045) janë të regjistruar në kopshte. Mesatarisht, në shkallë bashkie ka një edukatore për 13 fëmijë, me dallime të vogla nga një njësi në tjetrën. Numri varion nga 12 fëmijë për edukatore në Kastrat dhe Gruemirë në 16 fëmijë për edukatore në Shkrel dhe Kelmend.

Tabela 17. Numri i shkollave

Nr.	Njësia administrative	Numri i shkollave	Numri i nxënësve	Numri i mësuesve	Nxënës për mësues
1	Koplik	1	521	39	13
2	Qendër	3	228	36	6
3	Kastrat	6	524	64	8
4	Shkrel	6	297	51	6
5	Gruemirë	6	710	85	8
6	Kelmend	6	228	40	6
Gjithsej		**28**	**2,508**	**315**	**8**

Burimi: Bashkia Malësi e Madhe.

Bashkia ka 28 shkolla të shpërndara në gjashtë njësi administrative. Në njësitë e Gruemirës, Kastratit, Shkrelit, dhe Kelmendit janë 6 shkolla në secilën, kurse në Koplik ka vetëm një. Në të gjithë bashkinë ka 2.508 nxënës të regjistruar. Gruemira ka numrin më të madh të nxënësve (710), ndërsa në Kelmendi dhe Qendra kanë numrin më të vogël (228 secili).

Raporti i përgjithshëm nxënës-mësues është 8:1, që tregon ngarkesë mësimdhënëse të menaxhueshme. Kopliku ka raportin më të lartë (13 nxënës për mësues), ndërsa Qendra, Shkreli, dhe Kelmendi kanë raportin më të ulët (6 nxënës për mësues). Shpërndarja e 315 mësuesve duket se është proporcionale në të gjitha njësitë, ku të gjitha njësitë kanë raport nxënës-mësues që ndihmon mësimdhënien dhe nxënien efektive.

Tabela 18. Shkollat e mesme në njësitë administrative të Malësisë së Madhe

Nr.	Njësia administrative	Numri i shkollave	Numri i nxënësve	Numri i mësuesve	Nxënës për mësues
1	Koplik	1	350	29	12
2	Qendër	0	0	0	-
3	Kastrat	2	189	17	11
4	Shkrel	2	164	11	15
5	Gruemirë	1	92	13	7
6	Kelmend	1	55	4	13
Gjithsej		**7**	**850**	**74**	**12**

Burimi: Strategjia e Zhvillimit të Territorit, Bashkia Malësi e Madhe.

Shkollat e mesme ndiqen nga 850 nxënës, që përfaqësojnë 33% të grupmoshës përkatëse të regjistruar në regjistrat e gjendjes civile. Megjithatë, lëvizjet e popullsisë me siguri që ndikojnë në këto përqindje, Në bashki nuk ka shkolla profesionale, gjë që kufizon mundësitë e nxënësve për të ndjekur studime profesionale ose teknike.

Shëndetësia

Në ofrimin e shërbimeve shëndetësore në Malësi të Madhe ka pasur si arritje, ashtu edhe sfida. Megjithëse rajoni ka një gamë institucionesh shëndetësore, përfshirë qendra shëndetësore primare dhe shërbime të specializuara, disa barriera vazhdojnë të ekzistojnë, sidomos në zonat e thella, të cilat ndikojnë aksesueshmërinë, cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve shëndetësore të ofruara. Ky material informativ jep situatën gjendjen e tanishme të shërbimeve shëndetësore në Malësi të Madhe, me fokus në aspekte kyçe, si numri i dhe llojet e institucioneve shëndetësore, disponueshmëria e personelit mjekësor dhe ofrimi i shërbimeve për popullatën. Të dhënat tregojnë shpërndarjen e shërbimeve shëndetësore në të gjitha njësitë administrative, përfshirë praninë e profesionistëve dhe specialistëve të fushës së shëndetësisë, si edhe kapacitetet shërbimit të urgjencës. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve për të forcuar infrastrukturën shëndetësore, zona përballet me probleme të vazhdueshme si burime të kufizuara, personel mjekësor i pamjaftueshëm dhe pabarazitë në akses në shërbime shëndetësore, sidomos për popullatat e cenueshme.

Tabela 19. Shërbimet shëndetësore

Nr.	Njësia administrative	Qendra shëndetësore	Ambulanca	Personel mjekësor gjithsej	Mjekë	Infermierë
1	Kelmend	1	6	12	2	10
2	Kastrat	1	11	29	5	24
3	Koplik	1	1	9	4	5
4	Qendër	1	6	11	2	9
5	Shkrel	1	10	11	3	8
6	Gruemirë	1	10	11	5	6
Gjithsej	**-**	**6**	**44**	**83**	**21**	**62**

Burimi: Strategjia e Zhvillimit të Territorit, Bashkia Malësi e Madhe.

Në Malësi të Madhe ka shtatë qendra shëndetësore dhe 44 ambulanca në të gjitha njësitë administrative, të cilat i shërbejnë një popullsie totale prej 47.394. Bashkia ka 21 mjekë, 62 infermiere, por nuk ka mjekë specialistë dhe spital. Në vendet me numër më të madh popullsie, si Gruemira, numri i personelit është i ngjashëm me atë të vendeve më të vogla, që tregon për pabarazi të mundshme në shpërndarjen e burimeve.

Aktiviteti ekonomik

Malësia e Madhe karakterizohet nga një strukturë ekonomike e shumëllojshme, ku rol të rëndësishëm kanë bujqësia, sipërmarrjet e vogla dhe shërbimet. Ekonomia e zonës është kryesisht bujqësore, me një pjesë të mirë të popullsisë që merret me bujqësi dhe blegtori. Këta sektorë mbetet burim kyç i të ardhurave dhe jetesës për komunitetin, që pasqyron mbështetjen e zonës në prodhimin bujqësor dhe blegtoral. Krahas tyre, në zonë ka edhe një prani të konsiderueshme ndërmarrjesh të vogla e të mesme, me një numër gjithnjë e më të madh sipërmarrësish dhe sipërmarrësesh që kontribuojnë në aktivitetin ekonomik të zonës. Vitet e fundit, në bashki vihet re rritje e numrit të bizneseve aktive, me shtim të numrit të ofruesve të shërbimeve, sidomos në sektorët e tregtisë, ndërtimit dhe mikpritjes. Tregu i punës në Malësi të Madhe përballet me sfida të lidhura me shkallën e punësimit, ku burrat përgjithësisht kanë mundësi më të mëdha punësimi se gratë.

Tabela 20. Ndërmarrjet aktive sipas gjinisë 2023

Treguesi	2021	2022	2023
Malësi e Madhe (Gjithsej)	524	535	526
Burra	394	400	394
Gra	130	135	132

Burimi: INSTAT 2024.

Tabela më sipër jep informacion për shpërndarjen gjinore të ndërmarrjeve aktive në Malësi të Madhe:
Numri i ndërmarrjeve me pronarë ose drejtues burra vazhdon të jetë i lartë, me një rritje të lehtë nga 394 në vitin 2021 në 400 në vitin 2022, dhe përsëri në 394 në vitin 2023. Edhe numri i ndërmarrjeve të drejtuara nga gratë ka pasur shifra të qëndrueshme, duke u rritur pak nga 130 në vitin 2021 në 135 në vitin 2022, dhe pastaj ra përsëri në 132 në vitin 2023. Të dhënat tregojnë se ndonëse burrat vazhdojnë të dominojnë sektorin e sipërmarrjes, ka pasur rritje modeste të ndërmarrjeve aktive të grave, që flet për një tendencë pozitive në pjesëmarrjen e grave në biznes. Megjithatë, hendeku gjinor mbetet i dukshëm, ku burrat janë pronarë të një përqindjeje shumë të madhe ndërmarrjesh.

Tabela 21. Ndërmarrjet aktive sipas aktivitetit ekonomik

Treguesi	2021	2022	2023
Malësi e Madhe (Gjithsej)	524	535	526
I. Prodhues të të mirave	84	84	79
II. Prodhues të shërbimeve	440	451	447

Burimi: INSTAT 2024.

Numri total i ndërmarrjeve pësoi një rritje të vogël, nga 524 në vitin 2021 në 535 në vitin 2022, dhe më pas u stabilizua në 526 në vitin 2023. Prodhuesit e të mirave: Numri i ndërmarrjeve që merren me prodhimin e të mirave mbeti relativisht i qëndrueshëm në 84 në vitin 2021 dhe 2022, por u ul pak, në 79, në vitin 2023. Prodhuesit e shërbimeve: Numri i ndërmarrjeve në sektorin e shërbimeve ka shënuar rritje konstante, duke u rritur nga 440 në vitin 2021 në 451 në vitin 2022, me një rënie të ulët në 447 në vitin 2023. Kjo tregon për mbizotërimin e sipërmarrjeve të shërbimeve në zonë, që mund të pasqyrojë një profilizim gjithnjë e më të madh drejt aktivitetit të orientuar nga shërbimet në ekonominë vendore, me gjasë të nxitur nga faktorë si kërkesa e klientëve dhe tendencat e tregut.

Tabela 22. Ndërmarrjet aktive sipas numrit të të punësuarve

Treguesi	2021	2022	2023
Malësi e Madhe (gjithsej)	524	535	526
1-4 të punësuar	458	468	457
5-9 të punësuar	29	28	33
10+ të punësuar	37	39	36

Burimi: INSTAT 2024.

Kjo tabelë tregon shpërndarjen e ndërmarrjeve aktive në Malësi të Madhe gjatë viteve (2021-2023).

Ndërmarrjet me më pak se 5 të punësuar përbëjnë shumicën, me një rënie të vogël nga 458 në vitin 2021 në 457 në vitin 2023. Numri i ndërmarrjeve me 5-9 të punësuar u rrit pak, nga 29 në vitin 2021 në 33 në vitin 2023.

Numri i ndërmarrjeve më të mëdha (ato me mbi 10 të punësuar) pësoi luhatje të vogla, nga 37 në vitin 2021 në 36 në vitin 2023. Numri i ndërmarrjeve të vogla (1-4 të punësuar) tregon për tendencën mbizotëruese të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në vend.

Rritja e numrit të ndërmarrjeve të mesme (5-9 të punësuar) mund të sugjerojë rritje në sektorin e biznesit vendor, ndërsa stabiliteti i kompanive më të mëdha, tregon për punësim të qëndrueshëm, ndonëse të kufizuar, në veprimtari më të konsiderueshme

Tregu i punës, punësimi dhe papunësia në Malësi të Madhe

Statistikat e forcave të punës në Qarkun e Shkodrës, që përfshin edhe Malësinë e Madhe, për vitin 2023 tregojnë se shkalla e përgjithshme e pjesëmarrjes në forcat e punës është 63,8%, me një dallim të ndjeshëm midis burrave (72%) dhe grave (56%).

Tabela 23. Treguesit e tregut të punës, Qarku i Shkodrës, 2023

Treguesi	Total	Men	Women
Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës	63.8%	72.0%	56.0%
Shkalla e punësimit	59.4%	67.5%	51.7%
Shkalla e inaktivitetit	36.2%	28.0%	44.0%
Shkalla e papunësisë	6.9%	6.2%	7.8%

Burimi: INSTAT 2024.

Shkalla e punësimit është 59,4%, me një nivel punësimi më të lartë tek burrat (67,5%) krahasuar me gratë (51,7%). Shkalla e inaktivitetit, që përfaqëson personat që nuk marrin pjesë në forcat e punës është gjithsej 36,2%, me një shkallë më të lartë inaktiviteti tek gratë (44,0%) krahasuar me burrat (28,0%). Niveli i përgjithshëm i papunësisë është relativisht i ulët, me 6,9% - me një nivel pak më të ulët papunësie ndër burrat (6,2%) krahasuar me gratë (7.8%). Këto të dhëna ilustrojnë dallimet gjinore në punësim, ku burrat kanë nivel pjesëmarrjeje dhe punësimi më të lartë, ndërsa ndër gratë ka më shumë inaktivitet dhe papunësi. Këto tendenca mund të reflektojnë faktorët ekonomikë dhe shoqërore që ndikojnë pjesëmarrjen në tregun e punës në Malësi të Madhe dhe më gjerë në rrethin e Shkodrës.

Infrastruktura: toka, ujërat, energjia elektrike dhe jeta sociale

Malësia e Madhe ka sisteme të shumëllojshme dhe të integruara, secili prej të cilëve kontribuon në zhvillimin ekonomik, qëndrueshmërinë mjedisore dhe fitimin e jetesës në zonë. Sistemi natyror ofron shërbime ekologjike vitale, ndërsa sistemi bujqësor është thelbësor për prodhimin e ushqimit në zonë. Sistemi urban pasqyron tendencat e rritjes së popullsisë dhe të urbanizimit, ndërsa sistemi i furnizimit me ujë është shumë i rëndësishëm si për konsum ashtu edhe për ujitje. Së fundi, sistemi i infrastrukturës mbështet aktivitetin ekonomik në zonë, duke përmirësuar konektivitetin dhe aksesin në shërbime.

Tabela 24. Shpërndarja e sistemeve në Malësi të Madhe

Lloji i sistemit	Sipërfaqja që zë (në ha)	Karakteristika kyçe
Sistemi natyror	77.293	Mbizotërues në pjesët verilindore dhe jugperëndimore, sidomos në zonat malore. Përfshin peizazhe, pyje dhe koniferë.
Sistemi bujqësor	15.093	I përhapur gjerësisht në të gjithë bashkinë; i përqendruar në zonat e ulëta fushore, shtrihet deri në zonën malore.
Sistemi urban	3.570	Zonat e urbanizuara afër Koplikut dhe njësive të tjera administrative, të lidhura migrimin nga zonat e thella.
Sistemi ujor	601	Përfshin lumenj, përrenj, rezervuarë, dhe një pjesë të Liqenit të Shkodrës. Zona me furnizim të mjaftueshëm me ujë, ndonëse në disa prej tyre nuk ka.
Sistemi i infrastrukturës	256	Përfshin rrjetet e rrugëve, hekurudhave, të furnizimit me ujë, të kanalizimeve të ujërave të zeza, të ujitjes, të energjisë elektrike dhe të telekomunikacionit. Lidhjet e rrugëve kryesore dhe rrugët lokale janë gjithashtu pjesë e sistemit.

Burimi: Strategjia e Zhvillimit të Territorit.[77]

77. Strategjia e Zhvillimit të Territorit, Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Malësi e Madhe.

Sistemi natyror (77.293 ha): Sistemi natyror është tipari më mbizotërues në territorin e bashkisë. Ai zë një sipërfaqe shumë të madhe, ku përfshihen kryesisht zonat verilindore dhe jugperëndimore, sidomos në zonat malore. Ai përfshin veçori natyrore të shumëllojshme si pllaja, pyje (si pyje me drurë gjethegjerë dhe koniferë), dhe tipare të tjera natyrore. Ai përbën një pjesë të rëndësishme të territorit të bashkisë, ofron burime ekologjike dhe mbështet biodiversitetin.

Sistemi bujqësor (15.093 ha): Sistemi bujqësor është një tjetër tipar i rëndësishëm i territorit; bujqësia në bashki është sektor qendror për zhvillimin lokal. Ky sistem, me një shtrirje prej 15.093 hektarë, gjendet në të gjithë bashkinë, por përqendrohet kryesisht në zonat fushore. Sistemi bujqësor shtrihet edhe në zonat malore, dhe kontribuon në prodhimin e ushqimit, fitimin e jetesës, dhe në ekonomi. Bujqësia mbetet prioritet zhvillimor në bashki.

Sistemi urban (3,570 ha): sistemi urban zë një sipërfaqe më të vogël, prej 3.570 ha, dhe ka pësuar ndryshime të konsiderueshme, sidomos që nga vitet 1990. Për shkak të emigrimit të banorëve nga zonat e izoluara malore në pjesë më të aksesueshme, si qyteti i Koplikut dhe njësitë administrative përreth, si Kastrati dhe Gruemira, urbanizimi është shtuar. Këto zona ofrojnë më shumë mundësi për punësim dhe shërbime më të mira. Tabela tregon për qendra urbane në rritje në këto zona, të cilat lidhen me rrjete rrugore dhe shërbejnë si qendra ekonomike.

Sistemi ujor (601 ha): Sistemi ujor përfshin disa burime ujore natyrore, si lumenj, përrenj, rezervuarë, dhe një pjesë të Liqenit të Shkodrës, me sipërfaqe totale prej 601 hektarë. Pjesa më e madhe e bashkisë ka furnizim të mirë me ujë, megjithëse disa zona nuk kanë burime ujore të mjaftueshme. Lumenj si lumi i Cemit, lumi i Vermoshit, Lumi i Thatë, dhe të tjerë, si edhe Çezma e Koplikut, kontribuojnë konsiderueshëm në burimet ujore të bashkisë. Ky sistem është me rëndësi kritike, si për ujitje ashtu edhe për furnizimin me ujë të komuniteteve të zonës.

=Sistemi i infrastrukturës (256 ha): Sistemi i infrastrukturës në Malësi të Madhe përfshin 256 hektarë dhe mbështet një numër funksionesh thelbësore. Përbërësit kryesorë të infrastrukturës janë rrjetet e transportit (rrugor dhe hekurudhor), të furnizimit me ujë, të ujërave të zeza, të ujitjes dhe kullimit, si dhe rrjeti i energjisë elektrike, dhe i telekomunikacionit. Bashkia ka një rrjet rrugor të lidhur mirë, me aksin e rrugës kryesore që lidh Malësinë e Madhe me Shkodrën dhe Podgoricën. Rrugët lokale lidhin fshatrat, zonat turistike dhe zonën e Liqenit të Shkodrës. Hekurudha ofron lidhje ndërkombëtare, që lehtëson më tej zhvillimin. Përpos kësaj sistemet e furnizimit me ujë ndryshojnë nga njësia në njësi, me disa zona që përdorin puset, tubacionet ose depozitat e ujit. Bashkia ka gjithashtu një rrjet mjaft të përhapur kanalesh vaditëse dhe kulluese, ndonëse disa prej tyre kanë nevojë të mirëmbahen ose përmirësohen.

Shërbimet komunale: furnizimi me ujë dhe energji elektrike

Në zonat rurale të Malësisë së Madhe, banorët kanë probleme për sa i përket furnizimit me ujë, sidomos gjatë kushteve të vështira të motit. Pushteti vendor ka ndërmarrë hapa për të menaxhuar dhe përmirësuar sistemet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve të ujërave të zeza në fshatra, me qëllim mundësimin e aksesit të rregullt të banorëve me ujë të pijshëm.

Tabela 25. Njësitë e banesave dhe sistemet e furnizimit me ujë, 2023

Kategoria	Banesa të banuara	Njësi ekonomike familjare (NJEF)
Gjithsej	**6,294**	**6,510**
Furnizim me ujë brenda në banesë	1,748	1,863
Furnizim me ujë jashtë banesës, por brenda ndërtesës	1,305	1,322
Furnizim me ujë jashtë ndërtesës	2,104	2,162
Sistem tjetër furnizimi me ujë	1,072	1,097
Pa sistem furnizimi me ujë	65	66

Burimi: INSTAT 2024.

Të dhënat vënë në pah pabarazitë në furnizim me ujë në Malësi të Madhe – një faktor që ndikon konsiderueshëm në rolet gjinore, sidomos të grave dhe vajzave. Vetëm 27,8% e banesave të banuara dhe 28,6% e njësive ekonomike familjare kanë furnizim me ujë brenda në shtëpi. Ky akses i kufizuar shton ngarkesën e punës së grave, që tradicionalisht kanë përgjegjësinë për menaxhimin e nevojave të familjes për ujë. Duke qenë se mbi 33,4% të banesave dhe 33,2% të njësive familjare e vendin e furnizimit me ujë jashtë ndërtesës së banimit, grave dhe vajzave u duhet të kalojnë kohë të konsiderueshme duke mbushur e bartur ujë. Afërsisht 17% e NJEF-ve dhe familjeve përdorin sisteme alternative të furnizimit me ujë, ndërsa 1% nuk kanë asnjë sistem furnizimi me ujë. Kjo mungesë infrastrukture i bën ato edhe më të cenueshme, sidomos në kohë thatësirash dhe urgjencash, me ndikim të madh në shëndetin dhe kushtet e jetesës së grave.

Infrastruktura publike dhe jeta sociale

Malësia e Madhe përballet me një sërë sfidash në fushat e shërbimeve, ekonomisë dhe turizmit. Ndër problemet kryesore janë mungesa e vendparkimeve të caktuara dhe e një terminali multimodal, si dhe një sistem transporti urban i pazhvilluar. Ka probleme të konsiderueshme me sinjalistikën rrugore, korsitë e dedikuara, si dhe mungesë modernizimi dhe standardizimi në nivel kombëtar. Në zonë ka gjithashtu probleme me rrjetet elektrike dhe telekomunikacionit, ndriçim të pamjaftueshëm të rrugëve, dhe amortizim të infrastrukturës ekzistuese që çon në humbje të mëdha të energjisë. Krahas kësaj, rreziku i defekteve të pajisjeve elektrike për shkak të tensionit të paqëndrueshëm dhe kontakti i njerëzve me linjat dhe kabinat elektrike, e përkeqësojnë më tej këtë situatë.[78]
Këto mangësi në infrastrukturë pengojnë rritjen e ekonomisë së zonës, vështirësojnë jetën e përditshme dhe pengojnë zhvillimin e turizmit, i cili do të përfitonte nga përmirësimi i shërbimeve dhe objekteve. Trajtimi i këtyre problematikave është me rëndësi kyçe për modernizimin e zonës dhe përmirësimin e përgjithshëm të shërbimeve publike në të. Problemi është edhe më i theksuar në zonat rurale, ku izolimi social i grave është më i madh dhe aksesi i tyre në shërbime kyçe është më i vogël. Këto kufizime ndikojnë në mirëqenien mendore, mundësitë ekonomike dhe pjesëmarrjen e tyre në procese vendimmarrëse në komunitetet e tyre.

Turizmi, trashëgimia kulturore dhe historike

Peizazhi natyror i Malësisë së Madhe është i pasur dhe i shumëllojshëm dhe ofron burime të ndryshme me potencial si për konservim ashtu edhe për zhvillim, sidomos për sa i përket ruajtjes së biodiversitetit dhe promovimit të ekoturizmit. Këtu spikat prania e Alpeve Shqiptare dhe e Liqenit të Shkodrës, krahas zonave të mbrojtura si Parku Kombëtar i Alpeve Shqiptare dhe Parku Rajonal i Shkrelit, që kontribuojnë konsiderueshëm si në ruajtjen e mjedisit ashtu edhe në zhvillimin e zonës.Bashkia Malësi e Madhe është një zona me vlera të jashtëzakonshme natyrore dhe të peizazhit, falë pozitës gjeografike dhe terrenit të favorshëm, pranisë së Liqenit të Shkodrës dhe maleve, klimës së butë, dhe monumenteve natyrore në zonë. Puna e madhe e banorëve ka treguar edhe potencialin e jashtëzakonshëm për zhvillimin e këtij rajoni. Disa nga burimet kryesore natyrore janë:

- Zonat alpine dhe Liqeni i Shkodrës: Ndër burimet natyrore më të rëndësishme në bashki janë përfshirja e saj në Alpet e Shqipërisë dhe afërsia me Liqenin e Shkodrës – që të dy elementë shumë të rëndësishëm për biodiversitetin e Shqipërisë.

- Parku Kombëtar i Alpeve Shqiptare: Ky park, që shtrihet në tre shtete, zë një hapësirë të konsiderueshme në Bashkinë Malësi e Madhe. Krijimi i këtij parku synon jo vetëm mbrojtjen e territorit, por edhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm në zonë.

- Parku Rajonal i Shkrelit: Një zonë tjetër e rëndësishme në Bashkinë Malësi e Madhe është Parku Rajonal i Shkrelit, që ka rol qendror në ruajtjen e biodiversitetit të pasur të rajonit. Statusi i parkut ndihmon në ruajtjen dhe mbrojtjen e burimeve natyrore të zonës, si dhe mbështet promovimin dhe zhvillimin e turizmit malor.

Bashkia është e pasur në monumente natyrore, që janë elementë kyç të trashëgimisë natyrore të zonës dhe luajnë rol të rëndësishëm në identitetin ekologjik dhe kulturor të saj.

78. Strategjia e Zhvillimit të Territorit, Bashkia Malësi e Madhe.

Tabela 26. Monumente të natyrës në Malësi të Madhe

Monumenti i natyrës	Kanioni i Bashkimit (Vermosh)
Syri i Sheganit	*Mrizi (ahu) i Pleshtit (Bogë)*
Vulfenia e Shtegut të Dhenve	*Mullaret e Radit (Rapsh)*
Fortesa e Kelmendit	*Arra e Madhe*
Burimet e Koprishtit	*Foljeta e Lohjes*
Syri i Gjonit	*Shpella e Pucit*
Shpella e Krevenicës	*Pusi i Xhek Markut*
Morenat e Razmës	*Shpella e Njerëzve të Lagur*
Cirku i Livadhit të Bogës	*Kanioni i Poicës*
Burim i Vuklit	*Mullarët e Gurtë të Bajzës*
Blini i Bzhetës	*Pusi i Cilikokajve*
Vidhat tek pusi i Markajve	*Kalaja e Shtegut të Dhenve*
Ahui Geçës (Mri i Geçës)	*Lugu akullnajor i Runicës*
Carraca e Vrithit	*Depozitimet fluvio-glaciale të Bogës*
Tarraca e Greçës	*Lugu akullnajor i Seferçës*
Shpella e Gjolajve	*Gështenja e Reçit*

Burimi: Strategjia e Zhvillimit të Territorit, Bashkia Malësi e Madhe.

Sa i përket turizmit, Malësia e Madhe është e njohur për peizazhe me bukuri mahnitëse, trashëgiminë e pasur natyrore dhe mundësitë e shumta për turizëm. Me pozicionin e saj unik gjeografik, të karakterizuar nga terreni malor, liqene të virgjër dhe lumenj piktoreskë, kjo zonë ofron një gamë të gjerë përvojash turistike gjatë të gjithë vitit. Nga aktivitetet e ujit në Liqenin e Shkodrës dhe Lumin e Cemit, deri tek ngjitjet në Alpet Shqiptare dhe eksplorimi i pikave me interes historik dhe kulturor, Malësia e Madhe është një destinacion ideal për admiruesit e natyrës, amatorët e aventurave dhe ata që kërkojnë të mësojnë më shumë për traditat e pasura të Shqipërisë.

Në veçanti, njësitë administrative të Kelmendit dhe Shkrelit, që janë zona malore, kanë gjithashtu edhe një faqe interneti të dedikuar, www.kelmend-shkrel.org, ku jepet një listë e hollësishme e burimeve turistike të këtyre zonave.

Të gjithë fshatrat turistikë janë të lidhur me internetin, si dhe kanë numra celulari dhe adresa elektronike, që ua bën të lehtë turistëve të bëjnë rezervime, madje edhe në fshatin më të thellë të Vermoshit.

Tabela 27. Llojet e turizmit

Lloji i turizmit	Përshkrimi
Turizmi ujor	Turizëm i lidhur me trupa ujorë, si Liqeni i Shkodrës dhe Lumi i Cemit, që ofrojnë vende për të bërë plazh dhe aktivitete ujore.
Turizmi i gjelbër dhe i bardhë	Përqendrohet në peizazhet natyrore, përfshirë malet dhe pyjet, për aktivitete si ngjitjet dhe eksplorimi.
Turizmi historik-kulturor	Eksplorimi i historisë, kulturës dhe traditave të pasura të rajonit nëpërmjet pikave të interesit, festivaleve, dhe trashëgimisë lokale.
Turizmi i sporteve	Përfshin aktivitete sportive në natyrë, si udhëtimet me biçikleta malore, ngjitjet në male dhe aventura të tjera sportive në natyrë.
Turizmi gjeo-arkeologjik	Turizëm i përqendruar në vende me interes gjeologjik dhe arkeologjik në zonë, që ofron një tablo të së kaluarës së zonës.

Burimi: Bashkia Malësi e Madhe.[79]

Veçori kryesore të zonës janë Liqeni i Shkodrës që shtrihet për afërsisht 30 km nga Vraka-Gril (në njësinë administrative Gruemirë) deri në Han të Hotit (njësia administrative Kastrat), dhe Lumi i Cemit, që përshkon një gjatësi rreth 31 km nëpër njësinë administrative të Kelmendit. Buzë Liqenit të Shkodrës ka disa vende për të bërë plazh, si në Gril dhe Grizhë (njësia administrative Gruemirë), Culaj (njësia administrative Koplik), Stërbeq, Kamicë (njësia administrative Qendër), si edhe në Shegan dhe Hot (njësia administrative Kastrat).

Në këto vende ofrohen shërbime ditore, si lokale të shumta të zonës, që ofrojnë ushqim tradicional dhe bashkëkohor, me fokus të veçantë në gatimin e peshkut, si krapi, trofta, dhe peshq nga Lumi i Cemit dhe Liqeni i Shkodrës.

Mundësitë për turizëm elitar në Malësi të Madhe shtohen vazhdimisht, duke garantuar një përvojë të cilësisë së lartë si për vizitorët vendas ashtu edhe të huaj që zgjedhin këtë zonë për të gjitha llojet e turizmit.

Bujqësia dhe blegtoria

Bujqësia dhe blegtoria janë elementë përbërës të ekonomisë në Malësi të Madhe, që ofrojnë mundësi të shumëllojshme për komunitetet lokale, veçanërisht në zonat rurale. Në tabelën në vijim jepen statistikat e blegtorisë dhe të rritjes së shpendëve në Malësi të Madhe për vitin 2023. Të dhënat tregojnë shumëllojshmërinë dhe përhapjen e veprimtarisë blegtorale në zonë, me fokus mbarështimin e bagëtive si komponent i rëndësishëm i ekonomisë së zonës. Ndër kategoritë kryesore përfshihen gjedhët, bagëtitë e imta (dhentë dhe dhitë), derrat, shpezët dhe bletët, me shifra të hollësishme për secilin lloj.

79. Faqja e internetit e Bashkisë Malësi e Madhe: https://bashkiamalesiemadhe.gov.al/turizmi/

Tabela 28. Shifrat e bagëtive

Kategoria	Lloji	Numri i krerëve (2023)
Gjedhë	**Gjithsej gjedhë**	**3,552**
	Lopë	3,015
Bagëti të imta	Gjithsej bagëti të imta	23,827
	Dhen	14,927
	Dhi	8,900
	Dhi qumështi	5,188
Derra	Gjithsej derra	3,175
	Dosa	238
Kafshë barre	Kuaj dhe gomarë	836
Shpezë	Gjithsej shpezë	206,213
	Pula	202,088
	Gjela deti	0
Bletari	Koshere	13,684

Burimi: INSTAT 2024.

Sektori blegtoral në Malësi të Madhe ka një traditë të fuqishme. Numrin më të madh të bagëtive e përbëjnë ripërtypësit e vegjël si dhentë (14.927) dhe dhitë (8.900), që tregon fokusin tradicional të zonës në këto bagëti, me gjasë për shkak të terrenit malor që plotëson nevojat e tyre për kullotje. Numri i konsiderueshëm i dhive për qumësht (5.188) thekson më tej rëndësinë e prodhimit të qumështit në ekonominë lokale.

Mbarështimi i gjedhëve është gjithashtu i rëndësishëm, me 3.552 krerë, nga të cilat 3.015 lopë, që është tregues i fokusit në prodhimin e bulmetit dhe të mishit. Mbarështimi i derrave, megjithëse në një shkallë më të vogël, kontribuon në diversitetin blegtoral, me 3.175 krerë derra dhe 238 dosa pjellëse.

Rritja e shpendëve, veçanërisht e pulave, përbën segmentin më të konsiderueshëm, me mbi 200.000 pula, që tregon për rëndësinë e prodhimit të mishit të shpendëve dhe vezëve për tregjet lokale dhe më gjerë. Fakti që nuk rriten gjelat e detit mund të jetë tregues i mungesës së fokusit ose i mungesës së kërkesës për këtë lloj shpezësh. Bletaria, me 13.684 koshere, është një tjetër sektor i rëndësishëm që tregon për kapacitetin e zonës në prodhimin e mjaltit, mbështetur nga biodiversiteti dhe flora e pasur e saj.

Në përgjithësi, të dhënat e portretizojnë Malësinë e Madhe si një rajon me profil bujqësor dhe blegtoral të balancuar dhe shumëllojshëm, duke e bërë atë kontribuese të rëndësishme në sektorin e blegtorisë shpezëve në Shqipëri.

Tabela 29. Produktet blegtorale

Kategoria	Lloji	Prodhimi (2023)
Qumësht (gjithsej)	**Qumësht gjithsej**	**8.177 ton**
	- Qumësht lope	5.724 ton
	- Qumësht deleje	1.209 ton
	- Qumësht dhie	1.244 ton
Mish (gjithsej)	**Mish gjithsej**	**1.233 ton**
	- Mish lope	366 ton
	- Mish deleje	390 ton
	- Mish dhie	210 ton
	- Mish derri	205 ton
	- Mish shpendësh	62 ton
Vezë	Gjithsej vezë	49.915.000 kokrra
Lesh	Gjithsej lesh	33.6 ton
Mjaltë	Gjithsej mjaltë	154 ton

Burimi: INSTAT 2024.

Sasia totale e qumështit të prodhuar në Malësi të Madhe arriti në 8.177 ton në vitin 2023, ku mbizotëronte qumështi i lopës, me 5.724 ton. Edhe delet dhe dhitë kontribuojnë sasi të konsiderueshme qumështi, me përkatësisht 1.209 dhe 1.244 ton. Kjo balancë flet për një sektor bulmeti të shëndoshë, që plotëson një varg kërkesash të ndryshme në treg, veçanërisht për produkte tradicionale dhe artizanale të bulmetit.

Sasia totale e prodhimit të mishit ishte 1.233 ton, me kontribues kryesorë mishin e deles (390 ton) dhe mishin e lopës (366 ton). Edhe mishi i dhisë (210 ton) dhe i derrit (205 ton) zënë vend të rëndësishëm në dietën dhe ekonominë e zonës. Mishi i shpendëve, megjithëse në sasi krahasimisht më të ulët, me 62 ton, është një segment më i vogël, por me vlerë i tregut.

Mbarështimi i shpendëve duket se është një ndër elementët kryesorë në aktivitetin blegtoral në Malësi të Madhe, me gati 50 milion kokrra vezë të prodhuara në vitin 2023, që janë një burim i rëndësishëm proteinik për konsum lokal dhe rajonal.

Prodhimi i leshit ishte 33,6 ton, që tregon për rëndësinë e mbarështimit të dhenve krahas rritjes së tyre për mish. Prodhimi i mjaltit, që ishte 154 ton, tregon për kapacitetin e zonës për apikulturë të cilësisë së lartë, me gjasë për shkak të florës së shumëllojshme të zonës.

Tabela 30. Bimët e arave

Kategoria e bimëve të arave	Sipërfaqja (ha)	Prodhimi (ton)	Rendimenti (ton/ha)
Drithëra (gjithsej)	405.0	1,895.0	..
Grurë	267.0	905.0	33.9
Misër	138.0	990.0	71.7
Perime (gjithsej)	457.0	6,678.0	..
Patate	528.0	11,933.0	226.0
Fasule	372.0	415.0	11.2
Duhan	172.0	254.0	14.8
Bimë foragjere	3,018.0	57,104.0	..
Bimë mjekësore dhe aromatike	5,200.0	12,150.0	23.4

Burimi: INSTAT 2024.

Profili bujqësor i Malësisë së Madhe në vitin 2023 dëshmon për një kombinim të balancuar të kulturave bujqësore bazë, perimeve me rendiment të lartë dhe bimëve të specializuara. Krahas kultivimit me sukses të kulturave bujqësore si patatet dhe bimët mjekësore, në zonë bëhet edhe:
Kultivimi i drithërave në 405 hektarë, me një prodhim total 1.895 ton. Misri kishte rendimentin më të lartë me 71,7 ton për hektar, ndjekur nga gruri me një rendiment të respektueshëm prej 33,9 ton për hektarë. Nuk ka raporte për drithëra të tjera si thekra dhe elbi.
Kultivimi i perimeve në 457 hektarë, me një prodhim total prej 6.678 ton, që flet për përdorim të konsiderueshëm të tyre në ushqimin e banorëve të zonës. Bie në sy kultivimi i patates në 528 hektarë dhe prodhim total prej 11.933 ton, që bën ato një kulturë bujqësore të rëndësishme dhe me rendiment mbresëlënës prej 226 ton për hektar. Fasulet u kultivuan në një sipërfaqe prej 372 hektarë, por rendimenti i tyre ishte relativisht i ulët me 11,2 ton për hektar, që tregon se ka vend për përmirësimin e praktikave të kultivimit të fasules. Duhani, i kultivuar në një sipërfaqe prej 172 hektarë, arriti një rendiment prej 14,8 ton për hektar, që tregon për rëndësinë e tij si kulturë unike e zonës.

Me një sipërfaqe prej 5.200 hektarë, bimët mjekësore dhe aromatike janë një tipar i rëndësishëm i bujqësisë së zonës, me prodhim total 12.150 ton dhe rendiment 23,4 ton për hektar. Ky sektor dëshmon potencialin e zonës për kultivimin e kulturave bujqësore me vlerë të lartë.
Kulturat foragjere zënë një sipërfaqe prej 3.018 hektarë, me një prodhim total prej 57.104 ton, që është tregues i rëndësisë së tyre në mbështetjen e sektorit të fuqishëm blegtoral të zonës.

Tabela 31. Kultivimi i perimeve në Malësi të Madhe (2023)

Kategoria	Sipërfaqja (ha)	Prodhimi (ton)
Gjithsej perime (fushë + serra)	**475.0**	**6,678.0**
Perime të freskëta (fushë + serra)	285.0	3,870.0
Perime të thata të kultivuara në fushë	190.0	2,808.0

Burimi: INSTAT 2024.

Kultivimi i perimeve në Malësi të Madhe tregon për një fokus të konsiderueshëm në perimet e freskëta dhe ato thata. Perimet kultivohen në një sipërfaqe totale prej 475 hektarësh me një prodhim total 6.678 ton. Megjithatë, në këtë kategori mungojnë të dhënat e hollësishme për prodhimet e serrave.

Perimet e freskëta kultivohen në një sipërfaqe prej 285 hektarë, me prodhim total 3.870 ton dhe përbëjnë një pjesë të madhe të prodhimit të përgjithshëm të perimeve. Kontributi i serrave në këtë kategori nuk specifikohet. Perimet e thata të fushës kultivohen në një sipërfaqe prej 190 hektarë, me prodhim total 2.808 ton, që tregon për rolin e rëndësishëm të tyre në sektorin bujqësor lokal.

Tabela 32. Prodhimi dhe rendimenti i perimeve të freskëta në Malësinë e Madhe (2023)

Kategoria	Sipërfaqja (ha)	Prodhimi (ton)	Rendimenti (ton/ha)
Gjithsej perime të freskëta	**285.0**	**3,870**	**..**
Domate	68.0	1,088	160.0
Tranguj	40.0	716	179.0
Speca	70.0	860	122.9

Burimi: INSTAT 2024.

Në Malësi të Madhe, perimet e freskëta kultivohen në 285 hektarë, me një prodhim total prej 3.870 ton perime. Nuk ka ende të dhëna specifike për kultivimin dhe rendimentin e perimeve të kultivuara në serra, që tregon për mungesa në mbledhjen e të dhënave të serrave.
Domatet rriten në një sipërfaqe prej 68 hektarë, me prodhim 1.088 ton. Rendimenti mesatar është 160 ton për hektarë, që nxjerr në pah praktikat efikase të prodhimit.
Trangujt kultivohen në një sipërfaqe prej 40 hektarë, me prodhim total 716 ton. Rendimenti është 179 ton për hektar, më i larti ndër perimet përmendura, që flet për prodhim të lartë.
Specat kultivohen në një sipërfaqe prej 70 hektarë, me prodhim total 860 ton. Rendimenti mesatar është 122,9 ton për hektarë, pak më i ulët se ai i domateve dhe trangujve.
Rendimenti i lartë i domateve dhe trangujve tregon se në fushë të hapur zbatohen praktika bujqësore efikase. Megjithëse sipërfaqja e mbjellë me speca është më e madhja ndër kulturat bujqësore të përmendura, rendimenti është krahasimisht i ulët, që sugjeron se duhet të eksplorohen mënyra për të shtuar produktivitetin.

Tabela 33. Pemët frutore dhe prodhimi i tyre në Malësi të Madhe (2023)

Kategoria	Gjithsej sipërfaqe (ha)	Sipërfaqe në prodhim (ha)	Prodhimi (ton)
Gjithsej pemë frutore	**496**	**163**	**6,464**
Mollë	12	12	324
Kumbulla	66	34	1,030
Qershi	28	17	162
Fiq	..	..	961
Nektarina/pjeshkë	9	10	609
Gështenja	1	1	1,241
Arra	182	4	315

Burimi: INSTAT 2024.

Në vitin 2023 në Malësi të Madhe, pemët frutore kultivoheshin në 496 hektarë tokë nga të cilat 163 hektarë janë aktualisht në prodhim, me 6.464 ton fruta gjithsej.

- Kultura dominuese ndër frutat janë gështenjat me 1.241 ton, ndonëse kultivohen në një sipërfaqe prej vetëm 1 hektar, që tregon për rendimentin e tyre të lartë.
- Kumbullat janë kultura e dytë më e rëndësishme, që kontribuojnë me një prodhim 1.030 ton nga një sipërfaqe prej 34 hektarë.
- Mollët, që kultivohen në një sipërfaqe vetëm 12 hektarë, kanë një prodhim total prej 324 ton.
- Qershitë, që kultivohen në një sipërfaqe prodhimi më të vogël, 17 hektarë, japin një prodhim prej 162 ton.
- Prodhimi i fiqve shkon në 961 ton, por mungojnë të dhënat për sipërfaqen e kultivimit dhe sipërfaqen në prodhim.
- Arrat kultivohen në një sipërfaqe të konsiderueshme (182 hektarë), megjithatë aktualisht në prodhim janë vetëm 4 hektarë, me një prodhim total 315 ton.

Nektarinat/pjeshkat kanë një prodhim prej 609 ton me 10 hektarë në prodhim, që flet për rendiment mesatar. Një pjesë e konsiderueshme e sipërfaqes totale të zënë me pemë frutore (333 hektarë), nuk është ende në prodhim, që tregon se ka potencial për rritje të prodhimit në të ardhmen. Rendimenti jashtëzakonisht i lartë i gështenjave flet për rëndësinë e tyre si një kulturë e specializuar bujqësore në zonë.

Në Malësi të Madhe sipërfaqja totale e mbjellë me vreshta është 376 hektarë, nga të cilat aktualisht janë në prodhim 334 hektarë. Kjo tregon se afërsisht 89% e sipërfaqes me vreshta kontribuon aktivisht në prodhimin e rrushit. Vreshtat dhanë një prodhim prej 1.770 ton rrush në vitin 2023. Rendimenti për hektar në sipërfaqen në prodhim është afërsisht 5,3 ton për hektar, që është rendiment mesatar në prodhimin e rrushit. Rreth 42 hektarë vreshta mbeten joprodhuese dhe përbëjnë një mundësi për kultivim dhe rritje të prodhimit në të ardhmen. Sipërfaqja e konsiderueshme me vreshta flet për rëndësinë e vreshtarisë në skenën bujqësore të zonës.

Shtojca 2: Konteksti Kombëtar i Barazisë Gjinore

Korniza ligjore në Shqipëri, sidomos për sa i përket barazisë gjinore, është ndërtuar mbi dispozitat kushtetuese dhe ligjore që synojnë të sigurojnë të drejta të barabarta të burrave dhe grave.

Neni 18/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit, se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk duhet të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etniciteti, gjuha, bindjet politike, ose karakteristika të tjera.

Gjatë viteve, Shqipëria ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të harmonizuar kornizën e saj ligjore me standardet ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe luftimin e diskriminimit, dhunës, dhe abuzimit në familje me bazë gjinore. Ndër ligjet kryesore që kontribuojnë në këtë kornizë ligjore përfshihen:

1. **Ligji "Për barazinë gjinore në shoqëri"** (Ligji nr. 9970/2008): Ky ligj trajton çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, për sigurimin e mundësive të barabarta për burrat dhe gratë në ushtrimin e të drejtave të tyre, që ata të kontribuojnë në sektorë të ndryshëm të shoqërisë. Ai gjithashtu parashikon masa të veçanta të përkohshme, ndër të cilat edhe kuota gjinore prej 30% për poste politike dhe vendimmarrëse.

2. **Kodi Zgjedhor (Ligji nr. 10019/2008):** Me ndryshimet që iu bënë në vitin 2012, në Kod u përfshinë kuotat gjinore në procesin zgjedhor, duke siguruar që asnjëra gjini të mos përfaqësohej nga më pak se 30% në listat e kandidatëve të partive politike për zgjedhjet parlamentare. Përpos kësaj, në vitin 2020 dhe vitin 2024 u përfshinë dispozita të specifike për garantimin e kuotave gjinore. Ndryshimet që iu bënë Kodit në 2015 dhe 2020 i zgjeruan më tej kuotat gjinore, ndër të cilat edhe kuota prej 50% meshkuj dhe 50% femra për zgjedhjet vendore.

3. **"Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9936**, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar (Ligji Nr. 57/2016), përfshin për herë të parë konceptin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në menaxhimin e sistemit buxhetor, duke shtuar si parim të funksionimit të tij respektimin e barazisë gjinore, ku burri dhe gruaja gëzojnë mundësi dhe akses të barabartë në të drejta dhe përfitime të së njëjtës natyrë.

4. **Ligji "Për financat e vetëqeverisjes vendore"** (Ligji nr. 68/2017) ka krijuar mundësi për përfshirjen e efektshme të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit financiar vendor (programimi i buxhetit vjetor dhe afatmesëm, monitorimi dhe raportimi, vlerësimi dhe auditimi). Ndër të tjera, ky ligj synon të sigurojë që nëpërmjet krijimit dhe shpërndarjes së burimeve financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore të përshpejtohet dhe realizohet barazia gjinore.

5. **Kodi i Punës (Ligji nr. 7961/1995):** Kodi i Punës ndalon diskriminimin në punësim, kërkon akomodim të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuara dhe ndalon ngacmimin moral dhe seksual në vendin e punës. Ai përfshin gjithashtu edhe dispozita për promovimin e barazisë gjinore në punësim dhe të drejta profesionale.

6. **Ligji "Për personat me aftësi të kufizuara"** (Ligji nr. 93/2014): Ky ligj garanton mundësi dhe akses të barabartë për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë garantimin që gratë me aftësi të kufizuara të kenë të njëjtat mundësi si burrat me aftësi të kufizuara për akses në të drejtat e garantuara nga ky ligj.

7. **Ligji "Për sigurimet shoqërore"** (Ligji nr. 104/2014): Ky ligj njeh të drejtën e nënave dhe të baballarëve për leje prindërore, përfshirë zgjatjen e lejes së barrëlindjes deri në 63 ditë dhe aplikimi i bonusit për nënat me foshnja të porsalindura.

8. **Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"** (Ligji nr. 9669/2006): Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" (Ligji nr. 9669/2006): Ky ligj synon parandalimin dhe reduktimin e të gjitha formave të dhunës, duke u ofruar mbrojtje viktimave përmes procedurave të shpejta, jo të kushtueshme dhe të thjeshta. Me ndryshimet që iu bënë ligjit në vitet 2018 dhe 2020 u forcuan dispozitat që lidhen me parandalimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave.

9. **Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi",** i ndryshuar (Ligji nr. 221, datë 04.02.2010). Sipas këtij ligji, askush nuk mund të diskriminohet për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicionit gjenetik, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë, ose për çdo shkak tjetër. Edhe ky ligj u përmirësua me Ligjin 124/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.221/04.02.2010 për mbrojtjen nga diskriminimi", ku ndër të tjera saktësohet më tej objekti i këtij ligji, shtohen përkufizimet, duke theksuar gjuhën e urrejtjes, jepet përkufizim për format e rënda të diskriminimit, etj.

10. **Ligji 22/2018 "Për strehimin social"**, ku theksohet parimi i mosdiskriminimit, për planifikimin, pajisjen, shpërndarjen dhe menaxhimin e strehimit për grupet sociale në nevojë për strehim. Nga programi i banesave të specializuara përfitojnë shtresat vunerabël përfshirë viktimat e trafikimit, dhunës në familje dhe vajzat nëna.

11. **Ligji 110/2018 "Për noterinë"**, që fuqizon pavarësinë ekonomike të gruas dhe është garant kryesor i të drejtave pronësore të saj, duke sjellë risi në çështjet e rregullimit të barazisë gjinore në aspektin e mbrojtjes së pasurive.

12. **Ligji 111/2018 "Për kadastrën"**, që gjithashtu rregullon çështjet e barazisë gjinore, lidhur me regjistrimin e pasurisë së bashkësisë ligjore.

13. **Ligji 15/2019 "Për nxitjen e punësimit"**, ku viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje apo nënat nën moshën 18 vjeç, specifikohen tek grupet e veçanta të punëkërkueseve/punëkërkuesve të pafavorizuar në tregun e punës, të cilat/cilët përfitojnë nga shërbimet dhe programet e nxitjes së punësimit.

14. **Ligji 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"** ku përcaktohen si përfituese/përfitues të ndihmës ekonomike ndër të tjera viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre si dhe viktimat e dhunës në familje, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të cilat nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

15. **Ligji 34/2019 "Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara"**, ku theksohet miradministrimi dhe përdorimi eficient, efektiv dhe ekonomik i pasurive të sekuestruara e konfiskuara nga organet e drejtësisë dhe pasurive të sekuestruara me urdhër të ministrit përgjegjës për financat, rikthimi në komunitet i pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme dhe kompensimi financiar i viktimave të krimit.

Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore 2021-2030 (SKBGJ) përbën një udhërrëfyes drejt një shoqërie ku të gjithë individëve gra, burra, të reja, të rinj, vajza e djem, pavarësisht moshës, gjinisë, vendlindjes e vendbanimit, grupit etnik apo social, aftësive të kufizuara, përkatësisë e besimit fetar, shprehjes së identitetit gjinor e orientimit seksual, si dhe karakteristikave të tjera individuale, u jepen mundësi të barabarta të zhvillojnë potencialet e tyre; të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrjen politike e publike; të zgjedhin e të zgjidhen; të edukohen dhe aftësohen gjatë gjithë jetës; të punësohen e punësojnë duke avancuar drejt profesioneve të reja e duke sfiduar stereotipat dhe ndarjen gjinore të punës; të ndikojnë në zhvillimin socio-ekonomik të vendit dhe të mbështeten për

t'u zhvilluar në aspektin social dhe ekonomik; të krijojnë familje të shëndetshme, ku prindërit ndajnë përgjegjësitë në mënyrë të barabartë dhe ku komunikimi është çelësi i zgjidhjes së problemeve; të jetojnë të lirë nga praktikat e dëmshme dhe dhuna; si dhe ku grupet e cenueshme trajtohen me përparësi dhe mbështeten derisa të fuqizohen e gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës – pra një shoqëri ku barazia nuk ngatërrohet me njëtrajtshmërinë dhe ku askush nuk duhet të mbetet pas.[80]

Në nivel vendor, promovimi i përfshirjes dhe barazisë gjinore është bërë pjesë e kornizave ligjore dhe të politikave që theksojnë detyrimet e njësive të vetëqeverisjes vendore në fushën e barazisë gjinore (UN Women, 2019). Për shembull, Ligji «Për barazinë gjinore» shtjellon nevojën për promovimin e barazisë gjinore në qeverisjen lokale dhe njësitë e veçanta që janë përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës dhe shërbimit, përfshirë barazinë gjinore. Janë bërë përpjekje nga disa bashki për t'iu përmbajtur dispozitave të rregullores së e Këshillit të Bashkive dhe Rajoneve Evropiane (KBRE) dhe standardeve e BE-së, me strukturë të qartë, prioritete, përgjegjësi dhe buxhete që u përgjigjen nevojave të grave, burrave, të rinjve e të rejave në mënyrë të barabartë (UN Women, 2018). Tetëmbëdhjetë njësi vetëqeverisëse vendore kanë nënshkruar "Kartën evropiane për barazinë e burrave dhe grave në jetën vendore" – një numër i tyre me ndihmën e UN Women, dhe 15 prej tyre kanë hartuar plan veprimi vendor për barazinë gjinore.

Si rezultat i këtyre, ligjeve, politikave dhe planeve, Shqipëria ka shënuar përmirësime në shumë aspekte të barazisë gjinore, për shembull, në rolin e grave në zhvillimin e sektorit privat. Përqindja e sipërmarrjeve me pronare ose administratore gra është rritur në të gjitha zonat e Shqipërisë. Megjithatë decentralizimi dhe zbatimi i suksesshëm i kornizave ligjore dhe të zhvillimit ende has në vështirësi dhe ritmi i ndryshimit në fuqizimin ekonomik të grave përmes zhvillimit të sektorit privat është i ngadaltë, sidomos ndër gratë në zonat rurale. Normat, rolet dhe përgjegjësitë gjinore, dhe tendencioziteti gjinor në aksesin e grave në burimet prodhuese (si toka, financat, rrjetet, teknologjia dhe pajisjet) dhe në shërbimet e biznesit, bëjnë që ende të mos ketë barazi për gratë dhe burrat në sferat ekonomike dhe sociale. Disa ndikime të tendenciozitetit gjinor që shihet në Shqipëri për sa i përket fuqizimit të grave përmes zhvillimit të sipërmarrjeve, janë:

- 31,2% e ndërmarrjeve drejtohen nga gra.[81] Në vitin 2022, përqindja e grave pronare dhe administratore u pakësua krahasuar me vitin 2021, si për sa u përket bizneseve që prodhojnë mallra, ashtu edhe ato në sektorin e shërbimeve. Numri i bizneseve me pronare ose administratore gra është më i madh në sektorin e shërbimeve se sa në sektorin e prodhimit të mallrave, me përkatësisht 33,4 % and 17,2 %.

- Shkalla e punësimit në vitin 2023 ishte 72,9 % për burrat dhe 58, 9 % për gratë në grupmoshën 15-64 vjeç. Struktura e të punësuarve sipas statusit të aktivitetit tregon se 45,4% e grave janë të punësuara me pagë, ndërsa 23,5% e tyre janë punëtore pa pagesë në biznesin e familjes.[82]

- Në Shqipëri, numri i familjeve me kryefamiljarë burra është 4 herë më i madh se i atyre me kryefamiljare gra. Grupmosha 55-64 vjeç ka numrin më të madh të familjeve me kryefamiljarë burra, dhe grupmosha 74+ vjeç, numrin më të madh të grave kryefamiljare. Për të gjitha grupmoshat, numri i familjeve me kryefamiljarë burra është më i lartë.[83]

- Gratë luajnë një rol të rëndësishëm në sektorët e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Shqipëri, ku përbëjnë një pjesë të madhe të forcës punëtore në bujqësi, ndonëse në shumicën e rasteve në punësim informal. Në vitin 2023, 37,3 % e grave të punësuara ishin të punësuara në sektorin e bujqësisë, me një rritje prej 0,1 pikë përqindjeje krahasuar me vitin pararendës. Bujqësia është burimi më i rëndësishëm i punësimit për gratë që jetojnë në zonat rurale.

80. VKM nr. 400, datë 30.06.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021-2030, dhe të planit të saj të veprimit"
81. INSTAT, Regjistrat e Biznesit, 2023. https://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/regjistrat-e-biznesit/#tab3
82. Gra dhe burra në Shqipëri, 2022, https://www.instat.gov.al/en/themes/demography-and-social-Treguesis/gender-equality/#tab3
83. Po aty.

Pabarazitë gjinore në bujqësi shpesh vazhdojnë të ekzistojnë për shkak të kornizave administrative diskriminuese. Ndër to përfshihen praktika që: (i) i pengojnë gratë të jenë (bashkë-)pronare të tokës; (ii) i pengojnë gratë të fitojnë të ardhurat të vetat apo të kenë akses në shërbime mbështetëse (për shembull, duke u refuzuar përdorimin e numrit tatimor);[84] (iii) kërkojnë nga gratë që të paraqesin "certifikatën e fermerit" si kriter për të marrë pjesë në programe trajnimi dhe për të përfituar shërbime këshillimore; dhe (iv) i lejojnë shoqatat e përdoruesve të ujit të përdorin pronësinë mbi tokën si kriter për anëtarësim në to.[85] Faktorë të tjerë pengues janë mungesa e transportit publik në zonat rurale dhe mundësitë e kufizuara të lëvizjes. Në Shqipëri, pjesa më e madhe e motoçikletave dhe automjeteve zotërohen dhe drejtohen nga burrat dhe në vend mbizotëron norma sociale se nuk është e përshtatshme që gratë të udhëtojnë të pashoqëruara. Mundësitë e kufizuara të lëvizjes e bëjnë të vështirë që gratë të kenë akses në tregje.[86]

Shumë gra nuk janë ende të regjistruara si (bashkë-)pronare të shtëpive, tokës dhe pasurive të tjera të tyre, që vazhdojnë të figurojnë të regjistruara më së shumti në emër të bashkëshortit ose të anëtarëve të tjerë meshkuj të familjes. Ndër gratë që zotërojnë pronë, pjesa më e madhe (afërsisht 76 për qind) e kanë emrin në një titull ose dokument pronësie për shtëpinë, por jo për tokën.[87] Gratë luajnë rol kyç në zhvillimin dhe rritjen ekonomike të komuniteteve rurale. Por ky rol i rëndësishëm i tyre – sidomos në prodhimin bujqësor – shpesh është "i padukshëm" dhe nuk njihet.[88]

Shtojca 3. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural: Çështje Gjinore Kyçe në Shqipëri

Puna e grave në bujqësi kontribuon konsiderueshëm në ekonomi, por roli i tyre përgjithësisht vazhdon të mos njihet

Në vitin 2022 bujqësia përfaqësonte 17,7 për qind të PBB-së në Shqipëri.[89] Ajo vazhdon të jetë sektor kyç në ekonominë e vendit, ku angazhohen 33,9 për qind të forcave aktive të punës. Bujqësia është burimi më i rëndësishëm i punësimit për gratë që jetojnë në zonat rurale: ato përbëjnë 40,1 për qind të forcave të punës në bujqësi, krahasuar me 28,7 për qind të burrave.[90] Bujqësia është burimi më i rëndësishëm i punës për gratë që jetojnë në zonat rurale. Ashtu si sektorë të tjerë të ekonomisë, sektori bujqësor karakterizohet nga segmentimi gjinor i tregut të punës. Gratë e punësuara në bujqësi kanë më tepër gjasa të kryejnë punë me paga të ulëta, me kohë të pjesshme ose sezonale, ndërsa burrat janë më së shumti të punësuar në vende pune të paguara më mirë dhe me kualifikim më të lartë.[91] Në përgjithësi, gratë janë të mbipërfaqësuara në punësim informal, punë të papaguar,

84. Sipas Udhëzimit nr.19, 'Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar', datë 3/9/2014, fermerët që i shesin prodhimet e tyre duhet të regjistrohen në zyrat tatimore dhe të kenë një numër unik identifikimi të personit të tatueshëm. Ky regjistrimi është i detyrueshëm që fermerët të përfitojnë nga skemat mbështetëse për fermerët në vend. Pjesa më e madhe e atyre që kanë numër identifikimi të personit të tatueshëm janë burra, megjithëse, në parim, bashkëregjistrimi është i lejueshëm/i mundshëm. Shih: https://www.tatime.gov.al/c/3/12/23/fermere

85. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2024.

86. FAO dhe UN Women (në botim). *National Gender Profile of Agriculture and Rural Livelihoods Albania* (Profili gjinor kombëtar i bujqësisë dhe fitimit të jetesës në zonat rurale në Shqipëri).

87. INSTAT (2018). Studimi i Dytë Demografik dhe Shëndetësor Shqiptar (2017-2018). Shih: https://dhsprogram.com/pubs/pdf/FR348/FR348.pdf

88. Po aty.

89. INSTAT [në internet]. Të dhënat e llogarive kombëtare (PPB) të vitit 2023. Shih: https://www.instat.gov.al/en/themes/economy-and-finance/national-accounts-gdp/

90. INSTAT (2023). Gra dhe Burra. Shih: https://www.instat.gov.al/media/12598/burra-dhe-gra-2023.pdf. Ndërsa në vitin 2019, burrat përbënin 32,2 për qind, përqindja e grave ka mbetur pothuaj e pandryshuar.

91. FAO (2011). *The Role of Women in Agriculture* (Roli i grave në bujqësi). Shih: https://openknowledge.fao.org/items/a605b688-83e0-4e3a-ad47-874f0d6f63b1

dhe si kontribuese të punës në familje. Një analizë e strukturës së punësimit dhe statusit të aktiviteteve të personave të punësuar tregon se 23,5 për qind e grave punojnë në familje, ndërsa përqindja e burrave që punojnë në familje është shumë më e ulët, 13.2 për qind. Përpos kësaj, sektori karakterizohet nga një sasi e konsiderueshme pune të papaguar të grave.[92] Në punësimin informal, përqindja e grave që kontribuojnë si punëtore në familje është pothuaj dy herë më e madhe se e burrave (54 për qind kundrejt 28 për qind).[93] […] Megjithëse gratë mbajnë mbi shpatulla një pjesë të konsiderueshme të barrës së punës në bujqësi, kontributi i tyre mbetet në një shkallë të lartë i pavlerësuar nga pikëpamja ekonomike.[94] […][95]

Stereotipat gjinorë dhe praktikat diskriminuese kufizojnë aksesin e grave në burimet thelbësore të prodhimit bujqësor bazë

Në themel të praktikave diskriminuese qëndron koncepti i rrënjosur thellë se puna e grave është plotësuese e punës së burrave, të cilët konsiderohen si fituesit kryesorë të jetesës në familjet shqiptare. Kështu, ndërkohë që kryefamiljarët meshkuj shpesh janë pronarë që zotërojnë dhe administrojnë pasuritë familjare dhe lëndët e para bujqësore (për shembull, farat, plehrat organike dhe kimike, makineritë bujqësore), gratë në të njëjtat familje shpesh nuk kanë lirinë t'i përdorin burimet ose të vendosin bashkërisht për varietetet e bimëve, llojet e plehrave dhe kimikateve që përdoren, ose kohën e përdorimit të tyre. Në këto raste, gratë nuk mund t'i vënë njohuritë dhe përvojat e tyre në shërbim të veprimtarive prodhuese. […] Pabarazitë gjinore në bujqësi shpesh vazhdojnë të ekzistojnë për shkak të kornizave administrative diskriminuese. Ndër to përfshihen praktika që: (i) i pengojnë gratë të jenë (bashkë-)pronare të tokës; (ii) i pengojnë gratë të fitojnë të ardhurat të vetat apo të kenë akses në shërbime mbështetëse (për shembull, duke u refuzuar përdorimin e numrit tatimor)[96]; (iii) kërkojnë nga gratë që të paraqesin "certifikatën e fermerit" si kriter për të marrë pjesë në programe trajnimi dhe për të përfituar shërbime këshillimore; dhe (iv) i lejojnë shoqatat e përdoruesve të ujit të përdorin pronësinë mbi tokën si kriter për anëtarësim në to.

Faktorë të tjerë pengues janë mungesa e transportit publik në zonat rurale dhe mundësitë e kufizuara të lëvizjes. Në Shqipëri, pjesa më e madhe e motoçikletave dhe automjeteve zotërohen dhe drejtohen nga burrat dhe në vend mbizotëron norma sociale se nuk është e përshtatshme që gratë të udhëtojnë të pashoqëruara. Mundësitë e kufizuara të lëvizjes e bëjnë të vështirë që gratë të kenë akses në tregje.[97] […][98]

Shërbimet këshillimore bujqësore janë kryesisht për burrat

Shërbimi Kombëtar i Ekstensionit Bujqësor (SHKEB) për këshillim bujqësor, një strukturë në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, operon nëpërmjet katër agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor (AREB) dhe, në nivel vendor, përmes qendrave të informacionit bujqësor. Shërbimi këshillimor publik përfshin gjithashtu pesë qendra të specializuara të transferimit të teknologjisë bujqësore. […] kapacitetet dhe aftësitë gjinore ende nuk janë pjesë e kualifikimeve të kërkuara për punonjësit dhe trajnimet në këtë drejtim mungojnë. Reagueshmëria e dobët gjinore e shërbimeve, së bashku me statusin social të grave dhe nivelet e ulëta të pronësisë së tyre mbi tokën, ka

92. INSTAT (2023). Tregu i punës, 2022. Gjendet në: https://www.instat.gov.al/en/publications/books/2023/labour-market-2022/

93. Përllogaritjet e ONP-së për vitin 2019 (ILOSTAT). Shih: ONP (2023). Women and Men in the Informal Economy: A Statistical Update (Gratë dhe burrat në ekonominë informale: përditësim statistikor). Gjendet në: https://www.ilo.org/publications/women-and-men-informal-economy-statistical-update

94. FAO (2016). Gender, Agriculture and Rural Development in Albania (Gjinia, Bujqësia dhe Zhvillimi Rural në Shqipëri). Shih: https://albania.un.org/sites/default/files/2020-05/no.52-%20Gender%2C%20agriculture%20and%20rural%20development%20in%20Albania.pdf

95. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

96. Sipas Udhëzimit nr.19, 'Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar', datë 3/9/2014, fermerët që i shesin prodhimet e tyre duhet të regjistrohen në zyrat tatimore dhe të kenë një numër unik identifikimi të personit të tatueshëm. Ky regjistrimi është i detyrueshëm që fermerët të përfitojnë nga skemat mbështetëse për fermerët në vend. Pjesa më e madhe e atyre që kanë numër identifikimi të personit të tatueshëm janë burra, megjithëse, në parim, bashkëregjistrimi është i lejueshëm/i mundshëm. Shih: https://www.tatime.gov.al/c/3/12/23/fermere

97. FAO dhe UN Women (në botim). *National Gender Profile of Agriculture and Rural Livelihoods Albania* (Profili gjinor kombëtar i bujqësisë dhe fitimit të jetesës në zonat rurale në Shqipëri).

98. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

bërë që gratë të kenë akses të kufizuar në shërbime mbështetëse.[99] Shërbimet këshillimore bujqësore kanë si grup të synuar dhe ndihmojnë burrat: ndër 70.000 fermerët që u kontaktuan dhe ndihmuan nga shërbimet këshillimore në zona të ndryshme të vendit në vitin 2016, u konstatua se vetëm rreth 11 për qind ishin gra.[100] Që prej atëherë, numri i grave përfituese të shërbimeve këshillimore është tkurrur më tej, duke arritur në vetëm 8 për qind në vitin 2023.[101] Si rezultat i aksesit të kufizuar në informacione bujqësore dhe për tregun, niveli i produktivitetit të grave mbetet i ulët. […][102]

Niveli i tanishëm i (bashkë-)regjistrimit të fermave kufizon aksesin e grave në mundësi ekonomike

Legjislacioni që garanton të drejta të barabarta të grave në pronësi dhe trashëgimi është përmirësuar ndjeshëm.[103] Megjithatë, ende nuk janë të disponueshme të dhëna në lidhje me (bashkë-)pronësinë e grave mbi tokën. Aktualisht, vetëm 10 për qind e titujve të pronësisë mbi tokën janë të regjistruar digjitalisht, 10 për qind nuk janë të regjistruar, ndërsa 80 për qind ekzistojnë të regjistruar vetëm në letër. […] Shumë gra nuk janë ende të regjistruara si (bashkë-) pronare të shtëpive, tokës dhe pasurive të tjera të tyre, që vazhdojnë të figurojnë të regjistruara më së shumti në emër të bashkëshortit ose të anëtarëve të tjerë meshkuj të familjes. Ndër gratë që zotërojnë pronë, pjesa më e madhe (afërsisht 76 për qind) e kanë emrin në një titull ose dokument pronësie për shtëpinë, por jo për tokën.[104] […]Kjo i ka penguar gratë fermere që, për shembull, të përfitojnë shërbime këshillimore bujqësore, mbështetje financiare, dhe kontrata formale të rregullta me tregtarët, gjë që ka ndikuar negativisht në produktivitetin e tyre.[105] Krahas kësaj, gratë ndeshin vështirësi për të pasur akses në kredi nga bankat komerciale, kryesisht për shkak të kolateralit të pamjaftueshëm, situatë që rëndohet edhe më për shkak se të drejtat pronësore *de facto* janë të dobëta ose inekzistente. Arritja e një barazie më të madhe në të drejtat pronësore mbi tokën dhe aksesin në kredi do të shtonte ndjeshëm pjesëmarrjen fitimprurëse të grave në ekonominë bujqësore. Mungesa e pronësisë mbi tokën ndikon gjithashtu edhe në mundësitë e anëtarësimit të grave në organizatat e fermerëve, si shoqatat e përdoruesve të ujit dhe të ujitjes dhe shoqatat e prodhuesve. Duke qenë se për t'u anëtarësuar në këto organizata shpesh duhet të jesh pronar i tokës ose kryefamiljar, gratë e kanë të vështirë të bëhen anëtare të tyre. Kur shërbimet këshillimore bujqësore u drejtohen vetëm fermerëve të regjistruar ose anëtarëve të shoqatave, gratë automatikisht përjashtohen për shkak të mospërmbushjes së kushteve të anëtarësimit dhe, rrjedhimisht, nuk përfitojnë nga këto shërbime. […][106]

99. FAO (2024). *Ensuring that rural advisory services are responsive to women: good practices from FAO experiences in Europe and Central Asia* (Sigurimi që shërbimet këshillimore rurale t'u përgjigjen nevojave të grave: praktika të mira nga përvojat e FAO-s në Evropë dhe Azinë Qendrore). Shih: https://openknowledge.fao.org/items/c69ef2a6-4381-4e16-b624-a090e94b5710

100. UNDP dhe UN Women (2016). Dosja Gjinore Shqipëri. Shih: https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2016/10/albania-gender-brief

101. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të dhëna të vitit 2024, cituar në: FAO dhe UN Women (së shpejti). *National Gender Profile of Agriculture and Rural Livelihoods Albania* (Profili gjinor kombëtar i bujqësisë dhe fitimit të jetesës në zonat rurale në Shqipëri).

102. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023.. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

103. Ligji nr.111/2018 për Kadastrën, miratuar më 02/02/2019. Gjendet në: https://www.ashk.gov.al/2021/04/16/2066/. (versioni në gjuhën angleze gjendet në): https://www.fao.org/faolex/results/details/en/c/LEX-FAOC220473/); dhe Ligji nr.110/2018 për Noterinë, miratuar më 20/12/2018. Gjendet në: http://www.nchb.al/wp-content/uploads/2021/04/Ligj-nr.-110-2018-Per-Noterine.pdf. (Një përkthim jozyrtar në anglishte gjendet në: https://euralius.eu/index.php/en/library/albanian-legislation?task=download.send&id=160&catid=25&m=0). Legjislacioni i ri synon të mbrojë gratë nga tjetërsimi, blerja dhe heqja dorë nga pronat e tyre të paluajtshme, përfshirë tokën. Ai parashikon zbatimin e një sistemi me një sportel, tek noteri publik, për transaksionet që lidhen me tokën si edhe krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës për sigurimin e lloga-ridhënies nga noterët.

104. INSTAT (2018). Studimi i Dytë Demografik dhe Shëndetësor Shqiptar (2017-2018). Shih: https://dhsprogram.com/pubs/pdf/FR348/FR348.pdf

105. UN Women (2016). Studim kombëtar: Diversifikimi ekonomik për gratë që jetojnë në zonat rurale në Shqipëri. Gjendet në: https://albania.un.org/en/46581-economic-diversification-women-living-albanian-rural-areas

106. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

Gratë kanë (bashkë-)pronësi të kufizuar në ferma dhe ndërmarrje bujqësore

Në vitin 2022, nga 84.369 fermerë të regjistruar zyrtarisht në zyrat tatimore në Shqipëri, vetëm 10,8 për qind ishin gra.[107] Pjesa më e madhe e kontributit të grave në sektorin bujqësor konsiston në punësim informal në familjen bujqësore.[108] Në këtë lloj aktiviteti bujqësor, burrat përgjithësisht identifikohen si drejtues dhe "kryefamiljarë" ndërsa gratë janë të regjistruara si "ndihmëse", nën kategorinë "punëtorë familjarë kontribues".[109] Zakonisht burrat janë ata që kanë nën kontroll asetet bujqësore, marrin vendime, administrojnë financat dhe kryejnë punët që kërkojnë lëvizshmëri, ndërsa gratë merren kryesisht me punë fizike bujqësore, si punët para dhe pas vjeljes/korrjes, përpunimet ushqimore dhe punët e shtëpisë. Kjo ndarje e pabarabartë e punës kufizon aksesin e grave në asete bujqësore.

Ndërmarrjet që operojnë në kuadër të kategorisë ekonomike "Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi" përfaqësojnë vetëm 1 për qind të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve aktive.[110] Në mbi 80 për qind të ndërmarrjeve bujqësore aktive, pronarët ose drejtuesit janë burra: në vitin 2022, gratë ishin (bashkë-)pronare të vetëm 18,5 për qind të ndërmarrjeve aktive në bujqësi, pylltari, dhe peshkim.[111] Që nga viti 2016, numri i përgjithshëm i grave pronare dhe drejtuese të bizneseve në Shqipëri është rritur. Megjithatë, niveli dhe ritmi i përfshirjes ekonomike të grave përmes zhvillimit të sektorit privat vazhdojnë të jenë të ulëta, sidomos për sa u përket grave në zonat rurale. Ndikimi i normave gjinore kufizuese që çojnë në diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të grave është i dukshëm në të gjitha nivelet e ekonomisë rurale […][112]

Gratë në zonat rurale kanë akses të kufizuar në burimet e nevojshme për t'u marrë me biznes

Shumë gra në Shqipëri përballen me vështirësi për të pasur akses në burime biznesi. Gratë që nuk kanë llogari bankare apo nuk zotërojnë tokë për ta ofruar si kolateral, kanë akses të kufizuar në shërbime financiare, gjë që ua bën të vështirë të krijojnë, menaxhojnë, ose zgjerojnë bizneset e tyre.

Për përfitimin e shërbimeve financiare zakonisht është kusht që të kesh llogari bankare. Megjithatë, ekziston një vijë e qartë ndarëse midis zonave rurale dhe urbane: në vitin 2017, vetëm 31 për qind e banorëve të zonave rurale raportuan se kishin llogari bankare, krahasuar me 52 për qind të banorëve në zona urbane.[113] Përveç kësaj, shihet qartë edhe një hendek i konsiderueshëm gjinor: në grupmoshën 15-45 vjeç, vetëm 17 për qind e grave dhe 25,9 për qind e burrave që jetonin në zona rurale raportuan se kishin llogari bankare, krahasuar me 44,7 për qind të grave dhe 48,2 për qind të burrave në zonat urbane.[114] Këto rezultate ilustrojnë disavantazhet për shkak të përkatësisë së shumëfishtë, si rezultat i karakteristikave gjinore (domethënë, të qenit grua) dhe atyre të vendbanimit (domethënë, banimi në zone rurale).

Krahas kësaj, gratë në zonat rurale kanë akses të kufizuar në trajnime që ofrojnë njohuri dhe aftësi biznesi, si ato për përpunimin dhe marketimin e produkteve. Për marketimin e duhur të biznesit, është e rëndësishme të merret në kohë informacion i saktë përmes telefonit celular, radios, apo përmes teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK). Zotërimi ose jo i këtyre mjeteve dhe burimeve nga gratë mund të ndikojë në suksesin e biznesit të tyre. Ndonëse përgjithësisht janë bërë përparime në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në marketim, gratë në zonat rurale kanë akses të kufizuar në internet dhe në TIK. Në përgjithësi, infrastruktura

107. INSTAT (2022). Regjistrat e biznesit, 2022. Gjendet në: https://www.instat.gov.al/en/publications/books/2023/business-registers-2022/

108. Po aty.

109. FAO (2016). *Gender, Agriculture, and Rural Development in Albania* (Gjinia, bujqësia dhe zhvillimi rural në Shqipëri). Shih: https://albania.un.org/sites/default/files/2020-05/no.52-%20Gender%2C%20agriculture%20and%20rural%20development%20in%20Albania.pdf

110. INSTAT (2022). Regjistrat e biznesit, 2022. Gjendet në: https://www.instat.gov.al/en/publications/books/2023/business-registers-2022/

111. Po aty.

112. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

113. INSTAT, Instituti i Shëndetit Publik, dhe ICF (2018). Studimi i Dytë Demografik dhe Shëndetësor Shqiptar (2017-2018). Gjendet në: http://www.instat.gov.al/media/5050/adhs-2017-18-pdf.pdf

114. Po aty.

e teknologjisë së informacionit është mjaft e zhvilluar në qendrat urbane. Kurse në zonat rurale, ku mbulimi me infrastrukturën e energjisë elektrike dhe internetit me bandë të gjerë nuk është aq i zhvilluar, kostot e këtyre shërbimeve janë të larta dhe depërtimi i ulët – dhe numri i personave që kanë akses në internet dhe që përdorin atë është më i vogël. Në zonat rurale, më pak se 10 për qind e familjeve kanë akses në internet dhe vetëm 28 për qind e tyre kanë kompjuter.[115] Mungesa e konektivitetit të zonave rurale në Shqipëri është evidentuari si një prej mangësive që pengon rritjen ekonomike në vend.[116] **Për më tepër, kur në familje ka vetëm një telefon celular, ai shpesh përdoret vetëm nga kryefamiljari, ndërsa gratë dhe vajzat në familje nuk mund ta përdorin atë lirisht. Aktualisht nuk ka studime mbi aksesin e grave në zonat rurale në internet dhe në TIK.**

Gratë fermere kanë përfaqësim të ulët në organizata, shoqata dhe organe vendimmarrëse në zonat rurale

Me gjithë rolin e rëndësishëm të grave të zonave rurale në prodhimin bujqësor në Shqipëri, pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje në nivel të familjes, komunitetit dhe administrativ është përgjithësisht e kufizuar. Gratë rrallë janë anëtare apo përfaqësohen në shoqata apo komitete zyrtare dhe ato vazhdojnë të jenë tejet të nënpërfaqësuara në poste vendimmarrëse dhe drejtuese.[117] Në nivel komuniteti, burrat janë drejtues të grupeve prodhuese dhe kooperativave, ndërsa gratë janë të përjashtuara, qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi, nga marrja e vendimeve. Në organizatat e fermerëve, numri i grave anëtare është zakonisht i ulët, sepse në ato organizata pranohen si anëtarë kryesisht kryefamiljarët. Rrjedhimisht, gratë rrallë janë të pranishme në diskutime dhe vendimet që merren në grup nuk pasqyrojnë njohuritë, pikëpamjet, nevojat dhe të drejtat e tyre. Shqetësim është gjithashtu mospjesëmarrja e grave në proceset e menaxhimit të burimeve natyrore, si menaxhimi i integruar i ujit, si dhe niveli i ulët i përfshirjes së grave rurale në nismat lidhur me ndryshimet klimatike dhe ruajtjen e biodiversitetit dhe të trashëgimisë kulturore.[118]

[…] Gjithashtu, gratë nuk kanë pushtet ekonomik, influencë politike, apo informacion mbi proceset e vendimmarrjes. Së fundi, për shkak të kufizimeve në mundësitë e lëvizjes, largësia fizike nga qendrat administrative ku merren vendimet i kufizon më tej mundësitë e pjesëmarrjes së grave. […][119]

Ofrimi i shërbimeve dhe infrastruktura rurale nuk plotësojnë nevojat e grave dhe vajzave

Në Shqipëri vazhdon të jetë shqetësim aksesi i kufizuar – sidomos i grave dhe vajzave - në shërbime bazë si shëndetësia, kujdesi shëndetësor seksual dhe riprodhues dhe mbrojtja sociale në zonat rurale dhe të thella.[120] Krahas kësaj, infrastruktura e dobët e furnizimit me ujë dhe mbledhjes së ujërave të zeza, mungesa e pajisjeve teknologjike që kursejnë kohë, ofrimi i pamjaftueshëm i shërbimeve të kujdesit për fëmijët e vegjël, infrastruktura e pasigurt e transportit dhe mungesa e transportit publik me kosto të përballueshme - që të gjitha ndikojnë negativisht në mundësitë e grave për t'i kushtuar kohë punës produktive dhe të paguar dhe për të pasur akses në tregje.

Formimi profesional bujqësor nuk mbështet perspektivat e grave dhe vajzave për të pasur karrierë në këtë sektor

Në kuadër të aspiratës së Shqipërisë për të hyrë në tregun e përbashkët të BE-së, të rinjtë e të rejat duhet të kenë nivele të reja të përgatitjes profesionale që të mund të angazhohen si punëtorë fermash, teknikë, sipërmarrës biznesesh bujqësore apo vendimmarrës në fushën e zhvillimit rural. Shkollat profesionale luajnë rol të rëndësishëm në krijimin e kapaciteteve njerëzore të kualifikuara dhe pajisjen e të rejave dhe të rinjve me njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që kërkon tregu. Por me gjithë veprimtaritë promovuese dhe mbështetjen për nxitjen e nxënësve nga

115. Po aty.

116. ITU (2022). *Albania – Digital Development Country Profile* (Shqipëria – Profili i zhvillimit digjital të vendit. Shih: https://www.itu.int/en/ITU-D/Regional-Presence/Europe/Documents/Publications/2022/Digital%20Development/Digital%20Development%20Country%20Profile_Albania_final_02.22.pdf

117. UN Women (2020). Dosja e Barazisë Gjinore, Shqipëri 2020. Shih: https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/12/country-gender-equality-brief-albania-2020-0

118. Po aty.

119. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

120. KEGJFDG E OKB-SË (2023). Vërejtje përmbyllëse të raportit të pestë periodik për Shqipërinë, 2023. Gjendet në: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=KEGJFDG%2FC%2FALB%2FCO%2F5&Lang=en

zonat rurale të Shqipërisë për të marrë pjesë në arsim dhe formim profesional (AFP), numri i nxënësve të regjistruar në shkollat e mesme profesionale ka rënë. Kjo rënie ka qenë veçanërisht e ndjeshme në regjistrimet nga radhët e grupeve vulnerabël (një rënie me 30 për qind).[121]
Në Shqipëri ka tetë shkolla të mesme bujqësore dhe nxënësit në to vazhdojnë të jenë pothuaj tërësisht djem. Numri i vajzave është i ulët (afërsisht 16 për qind) dhe pjesëmarrja e vajzave nga zonat rurale është pothuaj e papërfillshme. […][122]

Politikat, programet, buxhetet dhe skemat Kombëtare për mbështetjen e bujqësisë dhe blegtorisë nuk u përgjigjen mjaftueshëm nevojave të grave

Në përgjithësi, politikat, planet, programet dhe buxhetet në Shqipëri hartohen mbi bazën e premisës se të gjithë individët që merren me bujqësi dhe blegtori janë burra. Sikurse shihet edhe në Strategjinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021-2027,[123] **vëmendja e dokumenteve strategjike përqendrohet tek fermerët burra. Edhe zyrtarët dhe punonjësit e këshillimit bujqësor që shpërndajnë teknologji, politika, informacion dhe risi bujqësore ndër fermerët, janë kryesisht burra. Ndonëse në periudhën 2018-2023 numri i përgjithshëm i grave që përfituan nga skemat kombëtare të mbështetjes pati rritje në vlerë absolute, përqindja e grave në raport me numrin e gjithsejtë të përfituesve ra nga 22 për qind në vitin 2018 në 16 për qind në vitin 2023.[124] Për të nxitur pjesëmarrjen e grave, Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural** (FBZHR) u jep pikë shtesë ("bonus") grave që aplikojnë. Megjithatë, përqindja e grave që aplikojnë dhe përfitojnë nga programet e FBZHR-së mbetet jashtëzakonisht e ulët.[125] […]

Programi i Zhvillimit Rural në kuadër të Instrumentit të Asistencës Para Anëtarësimit (IPA) i Republikës së Shqipërisë 2021-2027 (IPA-ZHR III) përmend shprehimisht detyrimet dhe objektivat e barazisë gjinore.[126] Në të përmendet *Aide-Mémoire* e kornizës ndërkombëtare përkatëse[127] për përfshirjen e perspektivës gjinore në Planin e Veprimit për Reduktimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë të OKB-së, detyrimet në kuadër të Planit të Tretë të Veprimit Gjinor të BE-së[128], dhe aktivitetet dhe rezultatet e parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Barazisë Gjinore (2021-2030), Objektivi 3.1, "Fuqizimi ekonomik i grave në zonat rurale".[129] Qëllimi i përgjithshëm i IPA-ZHR III është rritja e punësimit dhe të ardhurave "të gjeneruara nga gratë dhe sipërmarrësit e rinj në zonat rurale". Në dokument jepen rregullat për aksesimin e fondeve të IPA-ZHR III, ku përfshihen:

121. Komisioni Evropian (2023). Raporti për Shqipërinë 2023. Shih: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/ea0a4b05-683f-4b9c-b7ff-4615a5fffd0b_en?filename=SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf

122. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

123. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (2022). Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021–2027, miratuar me Vendimin nr.460, datë 29 qershor 2022. Gjendet në: https://qbz.gov.al/eli/fz/2022/100/6dea9d2c-c264-48a8-a9e1-d041781a823c;q=strategjia%20e%20bujqesise%20dhe%20zhvillimit%20rural

124. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, të dhëna të vitit 2024, cituar në: FAO dhe UN Women (së shpejti). *National Gender Profile of Agriculture and Rural Livelihoods Albania* (Profili gjinor kombëtar i bujqësisë dhe fitimit të jetesës në zonat rurale në Shqipëri).

125. Në vitin 2018, në skemat kombëtare të mbështetjes në bujqësi aplikuan 779 gra, nga të cilat 627 i përfituan ato. Pesë gra përfituan "mbështetje për investime në agroturizëm", "inkubator për mbështetjen e prodhimeve vendore tradicionale" dhe "mbështetje për ndërtimin ose rindërtimin e mjediseve të akomodimit në turizmin rural me të paktën gjashtë deri në dhjetë dhoma". Në vitin 2019, përqindja e grave që aplikuan për subvencione nga AZHBR ishte 19 për qind. Burimi: Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, të dhëna të vitit 2019; dhe: Avokati i Popullit i Republikës së Shqipërisë (2020). Raport alternativ mbi zbatimin e Konventës KEGJFDG në Shqipëri 2016-2020. Gjendet në: https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/12/alternative-report-on-the-implementation-of-the-cedaw-convention-in-albania

126. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (2022). Shih: https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/09/Programi-IPARD-III_2021-2027_English.pdf

127. UN Women - *Women's Resilience to Disasters Knowledge Hub (2017). Aide-Memoire on integrating gender equality in the UN plan of action on disaster risk reduction for resilience* (Qendër e njohurive për përballimin e fatkeqësive nga gratë (2017). (Kujtesë për integrimin e barazisë gjinore në planin e veprimit të BE-së për reduktimin e rreziqeve nga fatkeqësitë dhe përballimin e situatave). Gjendet në: https://wrd.unwomen.org/practice/resources/aide-memoire-integrating-gender-equality-un-plan-action-disaster-risk-reduction

128. Komisioni Evropian dhe Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikat e Sigurisë (2020). *Objectives and Treguesis to Frame the Implementation of the Gender Action Plan III (2021-25)*(Objektiva dhe tregues për kornizën e zbatimit të Planit të Veprimit Gjinor III), f.27. Gjendet në: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020SC0284

129. Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore 2021-2030, botuar në Fletoren Zyrtare nr.112, datë 15/07/2021. Shih: https://qbz.gov.al/eli/fz/2021/112. Gjendet në: https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2022-02/WEB_Strategjia%20Kombetare%20-%20EN.pdf

- respektim i shprehur i standardeve të BE-së lidhur me kërkesat e barazisë gjinore, pra, integrim i perspektivës gjinore në të gjitha programet;
- kryerja e analizës gjinore;
- të dhëna të ndara sipas gjinisë;
- përdorimi dhe monitorimi i treguesve gjinorë;
- trajnimi për integrimin gjinor në strukturat operative;
- bashkëpunimi me organizatat/shoqatat e grave;
- pjesëmarrja e barabartë e grave në grupet dhe organet zyrtare (si Grupet e Veprimit Vendor);
- përfaqësimi i grave në poste udhëheqëse dhe vendimmarrëse;
- përfshirja e organeve qeveritare përgjegjëse për promovimin e barazisë gjinore;
- veprim afirmativ (kuotat, preferenca ndaj grave aplikante);
- raportim i rezultateve të barazisë gjinore.

Nuk ka informacion të disponueshëm për nivelin e përmbushjes dhe zbatimit të rregulloreve të barazisë gjinore gjatë zbatimit të IPA-ZHR III. Në vitin 2023, Komisioni Evropian pezulloi IPA-ZHR III dhe ajo vazhdon të jetë joaktive.

Rregullat e BE-së të përcaktuara në kuadër të programit IPA-ZHR III për adresimin dhe promovimin e barazisë gjinore në bujqësi shërbejnë si udhëzues i vlefshëm për harmonizimin me standardet e BE-së. Është e nevojshme që të reagohet me politika dhe rregullore kombëtare që rezultojnë në ngushtimin e hendekut gjinor dhe promovojnë një mjedis ku gratë kanë akses të barabartë në burime, në mënyrë që ato të mund të kontribuojnë në mënyrë efektive në prodhim bujqësor, konkurrencë, rritje ekonomike dhe zhvillim rural.

Boshllëqe në statistikat dhe të dhënaT gjinore për bujqësinë dhe zhvillimin rural

Të dhënat e ndara sipas gjinisë dhe statistikat gjinore janë shumë të rëndësishme për të kuptuar situatën me të cilën përballen gratë dhe burrat në sektorin BZHR në Shqipëri. Ato janë gjithashtu me rëndësi kyçe për kryerjen e analizave gjinore, hartimin e politikave reaguese gjinore dhe zhvillimin e masave për trajtimin e pabarazive dhe sfidave specifike gjinore. Megjithatë, mangësitë aktuale në të dhëna pengojnë hartimin dhe zbatimin e politikave, programeve dhe buxheteve që kanë lidhje me bujqësinë dhe zhvillimin rural të cilat u kundërvihen pabarazive, trajtojnë sfidat specifike gjinore, dhe monitorojnë siç duhet përparimin e bërë në ngushtimin e dallimeve gjinore.[130] [...][131]

130. KEGJFDG e OKB-së (2023). Vërejtje përmbyllëse të raportit të pestë periodik për Shqipërinë, 2023. Gjendet në: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=KEGJFDG%2FC%2FALB%2FCO%2F5&Lang=en]

131. Udhëzues për përfshirjen e perspektivës gjinore: Bujqësia dhe zhvillimi rural. UN Women. 2023. https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-05/ard_web_final.pdf

Figura 4. Gratë, burrat dhe bujqësia në Shqipëri



Burimi: INSTAT (2023). Tregu i punës, 2022; Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, të dhëna të vitit 2024, cituar në : FAO dhe UN Women (së shpejti). National Gender Profile of Agriculture and Rural Livelihoods Albania (Profili gjinor kombëtar i bujqësisë dhe fitimit të jetesës në zonat rurale në Shqipëri).

Fuqizim i Grave për Zhvillim Rural në Shqipërinë e Veriut

SHKODËR DIBËR MALËSI E MADHE BULQIZË

Ambasciata d'Italia
Tirana

AGENZIA ITALIANA
PER LA COOPERAZIONE
ALLO SVILUPPO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

UN WOMEN